



Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

Ligji- mundësi zhvillimi për gratë

**Revistë 6-mujore, botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare
Viti VIII i botimit, Nr.1 (18), mars 2008**

Botohet në dy gjuhë: Shqip-Anglisht

Financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Tiranë, 2008

Redaksia e Revistës:

1. Prof. Dr. Aurela Anastasi - Drejtore e Revistës
2. Prof. As. Marjana Semini
3. Arjana Fullani (master)
4. Gent Ibrahimimi (LL.M)
5. Emira Shkurti (LL.M)

Sekretare e Redaksisë: Aurela Bozo

© QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE - QNL
(ish-QENDRA AVOKATORE PËR GRATË)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Përkthimi: Petraq Pojani, Svjetllana Anastasi

Redaktimi shkencor: Prof. Dr. Aurela Anastasi

Nëse jeni të interesuar për këtë botim, mund të kontaktoni me ne, në adresën e mëposhtme:

“Qendra për nisma ligjore qytetare”-QNL,

Rr.Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1, Ap.2 Tiranë –Shqipëri

Tel: 003554259795, Fax: 003554241914

E-mail: avokatore@albmail.com,

Website: www.qag-al.org

Dizajn: universaldesign-al.com

Shtypi: Shtypshkronja Ekspres

PËRMBAJTJA

I. ARTIKUJ STUDIMORË

Prof. As. Dr. Arta Mandro (*studim*)

E ka mbushur Djalli

(*Armët dhe rreziku i tyre në situatat e Dhunës në Familje*) 7

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit

17

II. DREJTËSIA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Av. Besa Saraçi

Çështje të praktikës gjyqësore në gjykimet e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore

(*Të dhëna nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Krimave të Rënda për periudhën 2004-2006*) 32

Av. Aurela Bozo

Disa probleme të evidentuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave nga komuniteti Rom dhe ndërgjegjësimi i tij për zgjidhjen e tyre

41

Vera Lesko

Vështrim mbi disa tipare të reja të situatës aktuale të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri

49

III. STUDIME HISTORIKE DHE TË KRAHASUARA

Prof. Dr. Ana Lalaj

Ndarje të trishtuara (Mbi martesat e shqiptarëve me të huajt në vitet e sistemit monist)

54

Erinda Bllaca

Mbrojtja ligjore për shtresat në nevojë (*Vështrim i krahasuar*) **63**

IV. TË NJOHIM LEGJISLACIONIN EVROPIAN NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE

Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 5 Korrik 2006 “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit” (*ripunim*) **71**

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë
**Rasti Oumar Dabo Abdonlay dhe të tjerë versus
Ndërmarrjes Kombëtare të Uzinave Renault SHA** **100**

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese
Rasti i punës gjatë natës (*Gjermani*) **105**

V. ESEJA MË E MIRË E STUDENTIT

Jonida Lamaj
Jo vetëm fenomen, por edhe fakt **111**

VI. AKTIVITETE NË DITËT E AKTIVIZMIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS

Letër e hapur
**Drejtuar popullit shqiptar nga Kryetarja e Kuvendit të RSH-së,
Znj. Jozefina Topalli, me rastin e ditëve të aktivizmit ndërkombëtar** **118**

Refleksione mbi luftën kundër dhunës në familje në ditët e aktivizmit.
(*Fjala e Prof. Dr. Aurela Anastasit në seancën e posaçme
Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, dedikuar luftës kundër
dhunës në familje*) **120**

I dashur Lexues,

Në emër të Redaksisë, ju përshëndes dhe ju ftoj të lexoni punimet e botuara në numrin 18 të serisë së kësaj reviste!

Revista profesionale ligjore, **“Ligji-Mundësi zhvillimi për gratë”** botohet pas mëse dy vjetësh ndërprerjeje, prandaj shpresojmë të rigjejmë sërish mirëkuptimin dhe interesin tuaj. Këtë radhë, ajo i është dedikuar në mënyrë të veçantë çështjeve të ligjit e të drejtësisë lidhur ngushtë me problemet e trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës në familje, si dhe aspekteve të tjera të barazisë gjinore.

Duke lexuar artikujt studimorë dhe disa analiza të situatave ligjore të këtyre fenomeneve në Shqipëri, të cilat janë trajtuar në vështrim të krahasuar me përvojën e vendeve të tjera, kemi mundësi të bëjmë një përmbledhje e një ballafaqim të përvojave tona profesionale.

Mendojmë se është mjaft e rëndësishme për të gjithë punonjësit e organeve të drejtësisë të njihen me legjislacionin evropian dhe me praktikat gjyqësore të gjykatave ndërkombëtare e të vendeve demokratike më të përparuara. Prandaj një vend i rëndësishëm i është lënë kësaj rubrike, porë në lidhje me çështjet e barazisë gjinore.

Një hapësirë e posaçme i është dedikuar studimit me karakter historik, që në këtë numër reviste i dedikohet fatit të trishtuar të familjeve shqiptare me bashkëshortë të huaj gjatë viteve të sistemit komunist. Këto vite janë studiuar pak dhe kanë nevojë për hulumtime të këtij tipi, me qëllim që të nxjerrim mësimet e duhura për të ardhmen. Ndërkohë, ky studim është pjesë që i shtohet dhe plotëson formatin e studimeve të kryera nga Qendra jonë për këtë problem.

Në këtë kuadër, më lejoni të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët e revistës dhe në mënyrë të veçantë një falënderim të përzemërt t’ia drejtoj Komitetit Suedezi të Helsinkit, i cili bëri të mundur këtë botim.

Lexim të këndshëm!

Prof. Dr. Aurela Anastasi
Drejtore Ekzekutive

I. ARTIKUJ STUDIMORË

PROF. AS. DR. ARTA MANDRO

E KA MBUSHUR DJALLI

*(Armët dhe rreziku i tyre në
situatat e Dhunës në Familje)*

Vjehri vret me armë zjarri (kallashnikov) nusen në prani të nipit të vogël”; Shtypi italian dhe mas media nuk rreshti në dhënien disa herë të njoftimit mbi vrasjen në gjykatë ku “në një seancë gjyqësore zgjidhjeje martese burri godet për vdekje me pistoletë gruan, vëllanë e saj, etj në prani të dy vajzave të mitura”; “dy vëllezër u vranë për një gardh”, etj.

Është bërë thuaj e përditshme që në shtypin shqiptar të kemi tituj të situatave ekstreme të dhunës në familje të shoqëruara këto me përdorimin e armëve¹. Për efekt të një studimi, mu desh që përgjatë dy muajve të ndjek me vëmendje shtypin lidhur me rastet e dhunës në familje dhe përdorimin e armëve të lehta dhe të vogla. Nuk e kisha vënë re më parë se sa të shpeshta ishin këto incidente. Ndërkohë sa raste të tjera të kërcënimit me armë mbeten

1 Eglantina Gjermani dhe Majlinda Bregu, Monitorimi i mediave mbi dhunën në familje 2001&2002, Qendra e Gruas 2003. fq. 87

të pa denoncuara. Vetëm duke i lexuar këta artikuj përjeton trauma e ndihesh e viktimizuar e jo më të mendosh se çfarë pësojnë viktimat, fëmijët, familjarët dhe familja në tërësi. Duket se ligji ende do të mbetet një instrument i topitur nëse nuk veprohet paralelisht me mjete të tjera të cilat të gjitha së bashku do të reduktojnë dhunën në familje. Kur sheh informacione të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë ose monitorime të bëra nga organizata ndërkombëtare kupton qartë se ka një lidhje të ngushtë midis armëve dhe dhunës në familje.

Ajo çka dua të paraqes këtu në vazhdim, ka të bëjë me rrezikun që paraqesin armët e lehta dhe të vogla, të cilat gjenden në familjet tona, tek të afërmit tanë e më gjerë në shumicën e rasteve ilegalisht. Kjo nuk përjashton rastin e personave që i posedojnë ato në mënyrë të rregullt për shkak të profesionit ose edhe me leje si armë gjuetie. Janë pikërisht këta individë që i shndërrojnë këto armë në mjete presioni, kërcënimi, pushteti dhe dhune ndaj anëtarëve të familjes e shpesh herë duke marrë jetën e më të dashurve.

Ku ka strehë më të mirë dhe të sigurt për njeriun se sa familja? Por sa e frikshme bëhet ajo kur anëtarët e saj dalin jashtë normave të dashurisë, respektit, dhembshurisë, moralit, dinjitetit, traditës dhe të ligjit. Ka një lidhje të fortë midis shoqërisë dhe familjes. Një shoqëri e dhunshme nënkupton një familje të tillë gjithashtu. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se si më 1997, nga depot e armatimit u grabitën armë (rreth 500.000) dhe municione në një sasi të madhe. Për një periudhë shumë të shkurtër kohe, nga 1 Mars deri në 20 Shtator 1997, me këto armë u vranë 1311 persona nga të cilët 75 fëmijë dhe u plagosën 1450 persona nga të cilët 62 fëmijë. Gjithsesi kjo periudhë intensive rebelimi, dhune e humbjeje për të gjithë ku edhe dhunuesit, autorë të krimeve ishin humbës, duket se nuk mjaftoi për të nxjerrë mësimet e duhura. Shifra e armëve të grabitura në raport me popullsinë ishin të konsiderueshme. Me gjithë një sërë programesh dhe projektesh për dorëzimin vullnetar të armëve dhe municioneve, me gjithë politikat ligjore ndëshkimore dhe amnistitë e akorduara etj, etj, përsëri një pjesë e konsiderueshme e armëve të grabitura mbeten në duart e popullsisë civile. Janë këto armë që mbushin shtypin e përditshëm me raste dhune ekstreme si brenda familjes ashtu edhe jashtë saj. Ku e gjeti armën 65 vjeçari që vrau ditët e para të Vitit të Ri 2008 motër e vëlla në shenjë gjakmarrjeje? Pra, shqiptarëve nuk u mjaftoi dhjetëvjeçari që lanë pas për të kuptuar rrezikun që paraqesin armët.

Tashmë është e konfirmuar se gratë janë viktimat kryesore

të dhunës në familje dhe burrat janë dhunuesit, sikurse këta të fundit janë edhe shkaktarët e dhunës me armë. Në Shqipëri në 98% të rasteve shkaktarët e dhunës me armë janë përgjithësisht burrat, ndërsa gratë në shumicën e rasteve të dhunës në familje të shkaktoar me armë kanë vrarë ose plagosur bashkëshortin e tyre². Përgjithësisht rezulton se popullsia ka një informacion shumë rastësor, sporadik dhe jo zyrtar lidhur me rastet e dhunës në familje ose edhe jashtë saj të shkaktoar nga përdorimi i armëve. I gjithë informacioni mbetet shumë - shumë në ca titra ose tituj kryesorë të dhëna më shumë për arsye sensacionale se sa për të analizuar shkaqet e problemit. Nuk kam gjetur në shtypin shqiptar një analizë qoftë edhe formale statistikore. Viktima e sajte ishte ajo që u vra me kallashnikov, pistoletë etj? Ku e gjeti dhunuesi këtë armë? Pa dyshim të gjithë e dinë nëse në familjen e tyre ka një armë që mbahet ilegalisht, por heshtin duke u bërë në këtë mënyrë aleat me krimin, shpesh herë pa e ditur qartë këtë. Familja nuk është vendi i armiqve, ajo është vatra e njerëzve më të dashur e më të shtrenjtë. Atëherë nga cili armik do të të mbrojë arma që ke në familje? Një nënë nuk duhet të jetë e qetë për aq kohë sa kërshtëria e fëmijës mund ta çojë këtë drejt një ngjarjeje makabër. Historia e këtyre viteve nuk i ka kursyer rastet e tilla. Aksidentalisht... një ngjarje aksidentale... duke luajtur me armën e të atit fëmija... Çfarë të ardhme do të ketë një fëmijë që qoftë edhe “AKSIDENTALISHT” në një moshë jashtë çdo lloj përgjegjësie penale, morale e shoqërore ka kryer një vrasje. Çfarë kompensimi do të ketë për jetën e familjes një fëmijë i vet vrarë sepse në shtëpi gjenden armë ilegalisht ose të rriturit që i posedojnë këto qoftë edhe ligjërisht nuk dinë të respektojnë disa rregulla elementare. E mandej thuhet: e mbushi Djalli. Jeta është e shtrenjtë. Është detyrë e të rriturve që këtë t’ia përsërisin vetes së tyre pareshtur dhe tua edukojnë fëmijëve.

Për herë të parë, gjatë 2005-2007, Ministria e Brendshme ka ofruar të dhëna zyrtare lidhur me dhunën në familje, dhunën kundër grave në familje³. Nga intervistimet, gratë përgjithësisht janë të mendimit se një armë në familje i përkeqëson marrëdhëniet ndërsa burrat

2 Shih EUSAC Shqipëri Media Monitoring Reports (MMR) në <http://www.sssr.undp.org.al/?media> si edhe FAST FACTS on SALW in Albania, Maj 2007 në <http://www.undp.org.al/elib.php?elib,871>

3 Këto të dhëna përmbajnë informacion mbi gjininë, marrëdhëniet, edukimin, moshën, mjetet e kryerjes së veprës, etj të dhunuesit dhe të viktimës.

kanë edhe mendimin alternativ se arma shërben edhe për mbrojtje, e si e tillë duhet të jetë në “pajisjet” familjare. Për mbrojtje nga kush? A është familja një repart ushtarak e duhet patjetër edhe arma e municioni? Ndërkohë numri i akteve kriminale përmes përdorimit të armëve është rritur në mënyrë të ndjeshme: rreth 27 %. Ende sot grumbullimi i armëve mbetet një sfidë dhe prioritet për stabilitetin në vend. Ende statistikatat zyrtare llogarisin rreth 220,000 armë të grumbulluara dhe mbledhura përmes programeve të ndryshme, por llogaritja e atyre që kanë mbetur në duar të civilëve është e mbetet e konsiderueshme. Llogaritjet se rreth 208.000 armë mbahen ilegalisht. Ne i mbajmë ato!

Këtu më poshtë po paraqesim një statistikë marrë nga buletini statistikor i Ministrisë së Drejtësisë ku paraqitet situata e personave të dënuar gjyqësisht për armëmbajtje pa leje. Ndonëse statistika përfshin periudhën 2004-2007, pra nis pas gati më shumë se shtatë vjet pas grabitjes së depove të armatimit (1997), rezultojnë se numri i personave të dënuar me armëmbajtje pa leje është i lartë. Jo vetëm kaq por, nëse do të shohim totalin sipas viteve të numrit të personave të dënuar, ka një ruajtje konstante me tendencë rritjeje. Këtu duhet të kemi parasysh se në shumicën e tyre, konstatimi i armëmbajtjes pa leje është bërë pas kryerjes së ndonjë krimi tjetër me këtë armë.

Numri i personave të dënuar për armëmbajtje pa leje					
Neñet respektive të kodit Penal/ statistikatat sipas viteve	2004	2005	2006	2007-3	Total muajt
Neni 278/1 KP Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit (prodhimi i armëve luftarake dënohet nga tre deri në 10 vjet heqje lirie)	81	40	1	-	122
Neni 278/2 KP Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit (mbajtja e armëve .. dënohet me gjobë ose me 7 vjet heqje lirie)	277	327	426	92	1122*
Neni 278/4 KP Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit (në sasi të mëdha, bashkëpunim, më shumë se një herë ose kur sjell pasoja të rënda dënohet me burgim nga 5 në 15 vjet)	70	1	5	2	78
Neni 280 KP. Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive (dënohet me gjobë ose deri në 2 vjet heqje lirie)	37	34	47	2	120
Total	465	402	479	96	

Nuk gjenden në statistikat e Ministrisë së Drejtësisë të dhëna lidhur me dhunën në familje të shkaktuar nga përdorimi i armëve. Dëgjojmë lajmet dhe konkludojmë se rastet janë të përditshme. Edhe pse nuk ka një titull të tillë: viktima NUMËR X e dhunës në familje; ose viktima numër X e vrasjes a plagosjes me armë (ku X është një numër me 2 e më shumë shifra)- ne e kemi të qartë se bëhet fjalë për një amplitudë në rritje. Kushdo, çdo qytetar mund të raportojë në polici mbajtjen pa leje të armëve. Nuk ka dallim nëse dhuna me armë ndodh brenda familjes ose jashtë saj. Heshtja mund të kushtojë më shtrenjtë. Shpesh herë arma përdoret në momente krize, zhgënjimi e depresioni si mjeti për tu dhënë fund problemeve të jetës së përditshme. Rastet e vet vrasjeve me armë sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë rezultojnë sipas tabelës më poshtë:

Vetëvrasjet me armë sipas Drejtorisë së përgjithshme të policisë						
200			2006			Diferenca
Totali	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	
18	15	3	42	33	9	- (+) 6

Kushtetuta shqiptare parashikon mbrojtje të veçantë për familjen, fëmijët, gratë, martesën. Nën shembullin e saj ka ecur i gjithë legjislacioni. Gjithsesi edhe këtu ka ende vend për përmirësim. Kështu, në kodin tonë Penal dhuna në familje nuk parashikohet si një veprë penale më vete sikur nuk parashikohet edhe përdhunimi martesor. Rrethanat rënduese të parashikuara në këtë kod nuk janë të mjaftueshme për të zgjidhur problemin dhe për më tepër nuk zbatohen me rigorozitet si të tilla. Vet rrethana rënduese e veprave të kryera me përdorim të armëve, është relativisht një rrethanë e re, e shtuar në Kodin Penal me ligjin nr. 8733/24/01/2001 “mbi disa ndryshime në Kodin penal”. Ndërkohë një kontribut me vlerë janë edhe Kodi i Familjes dhe Ligji i ri për masa për mbrojtjen e nga dhuna të marrëdhënieve familjare⁴. Sipas nenit 10 të këtij ligji organet zbatuese urdhërohen që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojnë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij. Në vazhdim janë disa nene të Kodit Penal dhe ndëshkimet respektive në rast plagosjeje ose fataliteti si edhe mënyra e procedimit:

4 Ligji nr. 9669/18.12.2006 “Mbi masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”

Neni	Krimi/kundravajtja	Sanksioni për plagosje	Sanksioni për vdekje	Hetimi
76	vrasje	10 deri në 20 vjet heqje lirie		Ex officio
78	Tentativë vrasje	15 deri 25 vjet heqje lirie		Ex officio
87	Tortura me pasoja të rënda		10-20 vjet heqje lirie	Ex officio
88	Plagosja e rëndë më dashje ^e	3 deri 10 vjet heqje lirie	5 - 15 vjet heqje lirie	Ex officio
89	Plagosja e lehtë me dashje	Që rezulton në humbjen e përkohshme të aftësisë për punë dënohet me gjobë ose deri 2 vjet heqje lirie		Ankesë e Viktimës
90	Rrahja	Dënohet me gjobë. Nëse vepra shkakton paafësi të përkohshme për punë deri në 9 ditë, dënohet me gjobë ose deri në 6 muaj heqje lirie.		Kërkesë private
102	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura	3 to 10 vjet heqje lirie. Në varësi të pasojave edhe me 5 deri 15 vjet heqje lirie	Nëse gruaja vdes ose kryen vetëvrasje 10 deri 20 vjet heqje lirie	Ankesë e viktimës
104	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim për përdorim të armës	5 to 15 vjet heqje lirie		Ex officio

Vetëm ligji nuk është i mjaftueshëm. Shpesh herë në të nuk ka një qëndrim të prerë në rastet e ndëshkimit të veprave penale të kryera me përdorimin e armëve. Kështu ndodh që mbajtja e një arme dënohet më rëndë se sa kryerja e një kërcënimi me armë. Ndërkohë është me të vërtetë absurde se si ndëshkimi në rastin e vjedhjes me armë (neni 140 Kodit Penal) ndryshon nga ndëshkimi në rastet e kërcënimit me armë (neni 84 i kodit Penal). Në rastin e parë bëhet fjalë për dënimin me 10 deri në 20 vjet heqje lirie dhe në rastin e dytë bëhet fjalë për gjobë ose një vit heqje lirie!!!! Ndëshkimi është i bazuar në llojin e veprës së kryer nga dhunuesi. Kështu në rastin e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke kërcënuar viktimën me përdorimin e menjëhershëm të armës dhunuesi mund të dënohet nga 5 deri në 15 vjet heqje lirie (neni 104 KP). Nëse arma me të cilën kryhet kërcënim mbahet në mënyrë ilegale, autori duhet të mbajë përgjegjësi edhe për armëmbajtje pa leje (që nënkupton gjobë ose deri në 7 vjet heqje lirie).

Është e rëndësishme të nënvizojmë si rrezikun që vjen nga armëmbajtja pa leje ashtu edhe rastet e dhënies së lejes “pa kujdes”

individëve të cilët për shkak të detyrës duhet të mbajnë armë. Klinikat ligjore dhe qendrat e asistencës për gra dhe vajza të dhunuara evidentojnë një sërë rastesh të dhunës të ushtruar pikërisht nga këta individë. Nuk janë të rralla rastet e dhunës në familje me armët e gjahut. Në këto kushte merr një rëndësi të madhe verifikimi i kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për të hyrë në forca ushtarake ose policore apo në një detyrë të caktuar si edhe për marrjen e lejes së armës së gjahut. Shpesh herë prej personave që për shkak të detyrës posedojnë armë dhe madje i marrin këto në banesë, neglizhohen disa rregulla të karakterit elementar për administrimin e armës në shtëpi, të cilat bëhen burim rreziku prej të tretëve. Është për të ardhur keq që ndonjëherë edhe gjykata e konsideron si rrethanë lehtësuese faktin që autori është punonjës i policisë.⁵ (?)

Armët janë pronë e shtetit. Armët e gjetisë mund të jenë edhe pronë e shtetit edhe e personave fizik ose juridik. Ligji për Armët nr 7566/ 25.5.1992 (nenet 5 dhe 7) dhe ligji për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake nr. 8388/05.08.1998 (neni 16) si edhe një sërë aktesh nënligjore rregullojnë çështje të blerjes dhe posedimit të armëve.

Armët posedohen ligjërisht vetëm prej individëve, autoriteteve të përcaktuara në ligj. Ligji për armët e ka të përcaktuar në mënyrë rigoroz procedurën dhe kriteret që duhet të plotësohen për posedimin e armëve. Posedimi zgjat si rregull aq sa zgjat edhe detyra e punonjësit të sigurisë, policisë, forcave të armatosura, etj. Civilët mund të jenë pronarë vetëm të armëve të gjahut. Për të pasur leje për mbajtjen dhe përdorimin e armëve duhet që individit të jetë 22 vjeç, i shëndoshë mendërisht dhe fizikisht, i pa dënuar penalisht. Ka një komision të posaçëm pranë komisarariatit të policisë i cili jep ose heq të drejtën e mbajtjes së armëve. Ka një sërë dokumentesh që paraqiten pranë këtij komisioni ku ndër të tjera edhe dëshmia e penalitetit ose vërtetimi nga gjykata ose prokuroria që i interesuari nuk është në proces hetimi. Inspektori i zonës dhe inspektori i policisë kriminale e kanë për detyrë që të bëjnë të gjitha investigimet lidhur me personalitetin ose sjelljet e aplikuesit në komunitet dhe në familje. Përgjithësisht rezulton se nuk ka raste që këta të pyesin anëtarët e familjes lidhur me personalitetin e aplikantit për posedim arme. Ndërkohë rezulton se edhe komuniteti reflekton një qëndrim indiferent. Kjo bën që në raste të veçanta arma të posedohet nga persona

5 Mari-Ann Roos, Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, OSBE, 2006 p.139.

të dhunshëm ose armët e gjahut të bëhen pronë e individëve që më shumë se për gjueti i kërkojnë që të realizojnë qëllime të tjera. Ligji parashikon një sërë situatash që kanë të bëjnë me heqjen e lejes së mbajtjes së armëve dhe për rrjedhojë konfiskimin e tyre. Si të tilla përmendim rastet e shpërdorimit të rregullave mbi përdorimin e tyre, kur ka rrezik që ato të përdoren për aktivitet kriminal, kur personi që e posedon armën ua jep atë të tjerëve për përdorim, kur armët e zjarrit përdoren për gjueti, etj. Ligji nuk parashikon situatat e dhunës në familje si kriter, por kjo nuk e pengon inspektorin të bëjë të gjitha hulumtimet lidhur me sjellje të tilla të aplikuesit, sikurse për këtë kërkohet që edhe anëtarët e familjes nëse vërtet e duan familjen dhe vlerat që ajo mbart, të mos lejojnë posedimin e armëve prej personave të ushtrojnë dhunë. Kuptohet që qëndrueshmëria e inspektorëve të policisë në një zonë, ose mbajtja e rekordeve të plota e të qarta nga ana e tyre dhe transferimi tek pasardhësit në detyrë e shmang më mirë posedimin e armëve prej individëve violent.

Në këto kushte zbatimi i një sistemi të mbajtjes së të dhënave në nivel mbarë kombëtar është më se i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Madje këtu luan rol edhe transferimi i këtyre të dhënave jashtë shtetit nisur nga fakti që shqiptarët gjithnjë e më shumë lëvizin jashtë shteti martohen e krijojnë familje jashtë shtetit ashtu sikurse edhe të huajt.

Ka dy arsye thelbësore që e detyrojnë gjykatën të urdhërojë dhe ekzekutojë konfiskimin e armës: së pari sepse arma është provë e faktit dhe në këtë mënyrë ajo sekuestrohet me cilësinë e provës materiale (neni 208 KPP) dhe së dyti që të parandalohen vepra të tjera penale (neni 274 KPP). Është detyrë e policisë që kur merr informacion për një rast dhune të marrë të dhëna lidhur me ekzistencën e armës ose përdorimin e saj nga dhunuesi ose viktimja. Ndonjëherë vet prezenca e armëve bëhet burim rreziku i shtuar dhe veprimet e të gjithë pjesëmarrësve qoftë edhe aksidentale mund të sjellin pasoja fatale. Sipas ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (neni 10/4), gjykata mban parasysht:

- a. Nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrit të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata.
- b. Nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjykata, njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Në të dyja rastet është fjala për armë që mbahen me leje nëse është fjala për armëmbajtje pa leje nuk mund të bëhet fjalë për kthim të një gjëje të paligjshme.

Kur rastet e dhunës në familje paraqiten në spital për trajtim mjekësor, konstatohet se këtu ende dhuna në familje vazhdon të konsiderohet një çështje private ose mekanizmat e raportimit të një dhune ekstreme siç është ajo e kryer përmes armëve nuk gjejnë vendin e duhur në mënyrat e raportimit. Pra, është e rëndësishme që dhuna të konsiderohet si çështje e shëndetit publik. Në Kodin e Deontologjisë Mjekësore ndër detyrat e përgjithshme të mjekut, ndër Detyrat ndaj të Sëmurëve, në nenin 43 citohet “Kur gjatë vizitës konstaton se fëmija është keqtrajtuar, ai duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Këtë ai duhet ta kryejë me kujdes e maturi, por nëse e gjykon të arsyeshme sidomos për fëmijët nën moshën 15 vjeç, ai duhet të njoftojë autoritetet kompetente”. Në këtë Kod nuk parashikohet si detyrë e mjekut trajtimi i veçantë i pacientëve /viktima të dhunës në familje. Edhe në rastin e sipërpërmendur të keqtrajtimit të fëmijëve *nuk specifikohet keqtrajtimi nga anëtarët e familjes e për më tepër, mbetet “në dorën/ gjykimin e mjekut” e nuk shihet si detyrim raportimi i viktimave në autoritet kompetente*. Akoma më shumë, nuk përcaktohen qartë “autoritetet kompetente”. Një zgjidhje e duhur është parashikuar në Ligjin e masave kundër dhunës në familje ku qendrat shëndetësore kanë prova shkre-sore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të mos lëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative. Ato kanë për detyrë të evidentojnë rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; të pajisin edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës; të referojnë dhe orientojnë viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Parandalimi i dhunës në familje është një çështje shumë komplekse dhe këtu një rol të veçantë luan edhe dorëzimi i arëve që mbahen ilegalisht si edhe përgatitja e procedurave sa më rigorozë për rekrutimin e personelit që mban armë dhe për mënyrat e posedimit të tyre. Strategjia Kombëtare e barazisë gjinore dhe e zhdukjes së dhunës në familje pa diskutim që përmban një sërë masash me karakter të tillë të cilat shtrihen në pesë drejtime kryesore: Edukim, sistemin e drejtësisë,

sistemin shëndetësor, sektorin e shërbimit social, ndërgjegjësim.

Çfarë duhet të bëjmë? Shumë duhet bërë në drejtim të legjislationit dhe të veprimtarisë praktike. Mendoj se prindërit dhe kryesisht grua ja si nënë ka një rol të pazëvendësueshëm. Nuk ka gjë në familje që ajo të mos e dijë ose të mos e ndjejë për shkak të mëmësisë. Pa diskutim që shtetit i dalin detyrat e veta. Por shoqëria civile duket se në këtë drejtim është në avangardë dhe përdor shpesh herë instrumente më efikas në realizimin e rezultateve pozitive.

Ka shumë mënyra për të mbrojtur familjen nga dhuna dhe armët. Përfshirja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në komisionet e dhënies ose heqjes së lejes për armë është një sugjerim sikurse edhe bashkëpunimi i shoqërisë civile me policinë gjithashtu; rekorde të qarta të policisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore janë të domosdoshme- ndonjëherë armë kërkohet për hakmarrje; rezulton se gjithnjë e më shumë kafshët e egra dhe pyjet po pakësohen, ndonëse ky nuk është një argument për refuzimin e lejes për armë gjuetie ndoshta edhe një lloj studimi lidhur me mundësinë e përdorimit të tyre në kushtet tona mund të ketë efikasitet; ndërgjegjësimi mbetet gjithnjë pjesë e masave parandaluese të domosdoshme; kontrolli i vazhdueshëm mbi sjelljen e individit që mban armë; kritere më strikte në rekrutimet në polici, mbrojtje, etj.

Armët janë një çështje që nuk mund të neglizhohen dhe kur këto e shtrijnë efektin e tyre deri në gjirin e familjes, ca më shumë.

PROF. DR. AURELA ANASTASI

**LEKSIONE PËR
SHQIPËRINË NGA NJË
ANALIZË E KRAHASUAR
MBI TË DREJTËN PËR
KOMPENSIM TË
VIKTIMAVE TË
TRAFIKIMIT⁶**

⁶ Draft- background paper “Compensation for trafficked and exploited persons in the osce region”, përgatitur nga OSCE-ODHIR, Barcelona, Dhjetor 2007

Duke lexuar draft-raportin studimor me titull **“Kompensimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”**, përgatitur nga OSCE-ODHIR, jo vetëm u nxita, por e ndjeva për detyrë të shkruaj, me shpresën se do të ndihmoj sado pak në përmirësimin e përvojës shqiptare në këtë fushë. E vërteta e zbuluar përmes raportit (analizon në mënyrë të krahasuar përvojën e 8 shteteve), na ndërgjegjëson për faktin se Shqipëria paraqitet tejet e varfër në mundësitë e krijuara për kompensimin e viktimave të trafikimit e të shfrytëzimit. Prandaj, jam përpjekur të vë në dukje disa aspekte kryesore, të cilat na ndihmojnë për të kuptuar më mirë mësimet që dalin nga ky raport, për Shqipërinë.

1. E drejta për Kompensim. Kuptimi dhe standardet e reja ndërkombëtare.

Zhvillimi i legjislacionit dhe i praktikave për mbrojtjen e viktimave, si dhe përmirësimi i meka-

nizmave për kompensimin e tyre, është shtruar sot si një nga aspektet më të rëndësishme të rritjes së aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë.

Në Shqipëri, çështja e rehabilitimit dhe e zhdëmtimit të viktimave është sanksionuar si një e drejtë kushtetuese vetëm në rastet e dëmtimeve të pësuarra për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore (neni 44 i Kushtetutës). Ky sanksionim ka forcuar mjaft aksesin e viktimave të dhunës së ushtruar nga persona të veshur me funksion shtetëror, sidomos të policisë. Ligji Nr.9381, dt.28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, është miratuar në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës. Që nga viti i miratimit të tij, praktika gjyqësore ka dëshmuar rritjen e rasteve të zhdëmtimit që i kërkojnë gjykatës për sjellje të paligjshme të organeve të policisë, ose për burgim të padrejtë. Në praktikën gjyqësore janë evidentuar disa raste të spikatura në zbatim të këtij ligji⁷.

Megjithatë, ligjërisht, e drejta për kompensimin e viktimave të dhunës ka një kuptim më të gjerë, përveç sa në kuptimin kushtetues. Ajo mund të ekzistojë në shumë forma të cilat janë parashikuar në aktet ndërkom-bëtare dhe në ligjet e brendshme të vendit. Gjithashtu, legjislacioni procedural civil e penal ka krijuar instrumentet e duhura.

Për sa më sipër, në këtë artikull, kam për qëllim të trajtoj disa aspekte të legjislacionit shqiptar mbi të drejtën për kompensimin e viktimave të trafikimit, si dhe probleme të zbatimit të tij.

Kompensimi ka ekzistuar gjithmonë si një institut i së drejtës që mundëson shpërblimin e dëmit të ardhur nga kryerja e veprës penale. Në këtë kuptim, ky institut ka karakteristika të përbashkëta për të gjitha shtetet, por mekanizmat e parashikuar prej tyre në legjislacionin kombëtar janë të ndryshme. Shtrohet çështja se sa efikase janë këto mekanizma për të garantuar zbatimin në praktikë të së drejtës për kompensim.

7 Shih: Vendimi Nr. 17, dt. 23.1.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë, Mirditë. Në këtë rast, gjykata ka pranuar kërkesën e nënës së viktimës E.C., vdekur në ambientet e Komisarariatit të policisë dhe ka vendosur detyrimin e Komisarariatit të policisë së rrethit, të dëmshpërblejë paditësen në shumën 2.301.750 lekë. Ky vendim është dhënë i bazuar drejtpërdrejtë në nenin 44 të Kushtetutës së R Sh-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut.

Në këtë kuadër, ka një evolucion të padiskutueshëm të legjislacionit në nivelin ndërkombëtar, zhvillimi i të cilit ka ndikuar për të vendosur standarde të reja mbrojtjeje edhe në legjislacionet e brendshme të shteteve. Si rezultat i përqasjes me këto standarde edhe në Shqipëri është bërë i mundur përmirësimi i statusit të viktimës së trafikimit në procesin penal. Jo shumë kohë më parë, viktimat konsiderohej si bashkautorë në veprën penale dhe dënohej. Ky fakt, e përjashtonte mundësinë e saj për të kërkuar kompensimin e dëmit në rrugë gjyqësore. Sot, teorikisht, viktimat e trafikimit gëzojnë të drejtën për të kërkuar kompensim dhe është njohur parimi sipas të cilit, përfitimet e marra prej trafikantëve përmes aktiviteteve të tyre shfrytëzuese, duhet të përdoren në të mirë të personave të trafikuar, si individualisht, ashtu edhe kolektivisht. Megjithatë, duhet theksuar se ka probleme në zbatimin e legjislacionit, të cilat e kanë shndërruar atë në akt të pazbatueshëm në praktikë. Shkaqet e këtij fenomeni janë komplekse, por kryesori lidhet me mentalitetin e punonjësve të shtetit, të cilët aktivitetin e ushtruar nga viktimat e konsiderojnë si aktivitet të paligjshëm, i cili nuk meriton dëmshpërblim.

Në legjislacionet e vendeve të ndryshme, mundësia e viktimave për të kërkuar kompensimin nga një trafikant ose shfrytëzues, ekziston kryesisht në formën e veprimeve civile, por këto kërkesa mund të ndiqen edhe brenda procesit penal, përmes padisë civile në procesin penal. Padi të tilla mund të ndiqen në procesin civil edhe në mënyrë të pavarur nga ai penal, p.sh., kur çështja penale është pushuar. SHBA janë vendi i vetëm ku një padi kompensimi për viktimën, e njohur si restitutio, është automatikisht pjesë e procedimeve penale në çështjet e trafikimit. SHBA, Ukraina dhe Moldavia kanë një numër të konsiderueshëm rastesh në të cilat kompensimi i është dhënë personave të trafikuar duke përdorur padinë civile brenda procesit penal. Në Mbretërinë e Bashkuar, ka mundësi për urdhrin kompensues që jep gjykata brenda procedurave penale, si pjesë e ndëshkimit të dhënë ndaj një të dënuari. Shuma e kompensimit nuk është fikse, por ndryshon në vende të ndryshme. Megjithatë, në të gjitha vendet, ekzistojnë probleme për ekzekutimin e kompensimeve të caktuara nga gjykatat, duke bërë që personi i trafikuar të kërkojë procedura të tjera që e detyrojnë trafikantin të paguajë dëmin. Këto veprime shpesh janë të pasuksesshme, duke bërë që në praktikë, personat e shfrytëzuar që e marrin kompensimin, të jenë të rrallë. Sidoqoftë, në Shqipëri deri më sot, nuk ka pasur ndonjë rast të kompensimit të personit të trafikuar. Për më keq, për personat e shfrytëzuar në punë,

kjo mundësi nuk ekziston fare, për shkak të mungesës së sanksioneve në legjislacionin e punës.

Në botë, e drejta për kompensim e personave të trafikuar është forcuar si rezultat i sanksionimeve të saj në konventat dhe aktet ndërkombëtare që janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kështu, shtetet palë të *konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC) dhe Protokollit kundër trafikimit (2003)*, kanë detyrimin të sigurojnë ekzistencën e së paku njëres prej procedurave ligjore, me qëllim që personat e trafikuar të kenë akses për kompensimin e tyre. Ato gjithashtu duhet të sigurojnë për viktimën mekanizmin e informimit të saj në lidhje me këtë të drejtë. Sipas kësaj konvente, aksesit për kompensim duhet të njihet edhe jashtë kufijve.

Konventa e Këshillit të Evropës *“Për veprimin kundër trafikimit të qenieve Njerëzore”*, parashikon të drejtën për të kërkuar kompensim nga trafikanti, si për dëmin material ashtu edhe për dëmin moral. Kjo Konventë, përcakton gjithashtu, të drejtën për akses të viktimës ndaj një fondi kompensimi shtetëror, një prej modeleve të të cilave u sanksionua në Konventën evropiane *“Për kompensimin e viktimave nga krimet e dhunshme”* (ECCVVC).

“Konventa evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” (ratifikuar me ligjin nr.9265, dt. 29.07.2004), e kufizon kompensimin nga shteti vetëm në dëmet materiale në rastet kur vepra penale ka qenë një krim i qëllimshëm dhune me pasoja fizike ose mendore për shëndetin. Ka gjithashtu, kufizime në përzgjedhjen e viktimës, e cila përfshin nevojën për të qenë një viktimë e tipave specifike të krimeve të dhunës, apo tipave të dëmit. E drejta për kompensim nga shteti është e kufizuar. Faktorë të ndryshëm, mund ta bëjnë personin e trafikuar, jo përfitues të kësaj skeme kompensimi. Standardet ndërkombëtare në përgjithësi, dhe ato të BE-së në veçanti, kufizojnë të drejtën e kompensimit nga Shteti, vetëm për krimet që shkaktojnë dëme serioze dhe krimet e dhunshme respektive.

E drejta për kompensim është mbështetur edhe nga disa marrëveshje politike (ose “e drejta e butë”), midis të cilave më e rëndësishme paraqitet *“Deklarata e parimeve bazë të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit”*, si dhe e drejta e Bashkimit evropian, siç

është Direktiva e Këshillit të BE-së “*Për kompensimin e viktimave të krimit*”.

Në përfundim, duhet thënë se, aktet ndërkombëtare kanë bërë të mundur të sanksionojnë të drejtën për kompensim të viktimave të trafikut, si një të drejtë të realizueshme jo vetëm përmes pagesës së dëmit nga trafikantët, por edhe përmes skemës shtetërore. Standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar parimin sipas të cilit përfitimet e nxjerra nga trafikantët përmes shfrytëzimit prej tyre të aktiviteteve, duhet të përdoren për të dëmshpërblyer personat e trafikuar, individualisht, ose kolektivisht. Këto standarde kanë nënvizuar në mënyrë të veçantë interesat e fëmijëve dhe të grave.

Një vëmendje e madhe i është kushtuar edhe të drejtave ndihmëse, të cilat e bëjnë kompensimin një mundësi efektive dhe praktike, sikurse është p.sh., *ndihma ligjore falas*.

Shqipëria ka ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare të rëndësishme, si rezultat i të cilave ka bërë disa përmirësime në korpusin e veprave penale të lidhura më trafikimin e qenieve njerëzore, por deri më tani nuk ka ndryshuar dispozitat procedurale që lidhen me kërkesën për kompensim.

Mekanizmi i parashikuar nga Kushtetuta për pranimin e akteve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm juridik, e lejon plotësisht gjyqtarin që të vendosë në lidhje me kërkesat për kompensim/zhdëmtim, duke iu referuar drejtpërdrejt konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Por, shtrohet çështja e ndërgjegjësimit të mëtejshëm të gjyqtarëve dhe të gjithë punonjësve të drejtësisë për zbatimin e drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare, duke mënjанuar mentalitetin tradicionalist, që i lidh ata ngushtësisht vetëm me ligjin e brendshëm. Ato duhet të gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë jo vetëm kur në legjislacionin e brendshëm ka zbrazëti, por edhe në rastet kur lihet shkas për ekuivok midis legjislacionit shqiptar dhe atij të brendshëm.

2. Mekanizmat e parashikuara nga ligji shqiptar për kompensimin e viktimave të trafikimit

Legjislacioni procedural shqiptar parashikon mundësinë për kompensimin e viktimave përmes dy procedurave: padisë civile në procesin penal dhe padisë në procesin civil. Dallimi kryesor midis këtyre është fakti se, kodi i Procedurës Penale nuk e parashikon mundësinë për të kërkuar “dëmin moral”, gjë që mund të kërkohej në bazë të kodit të Procedurës Civile, në procesin civil⁸.

2.1. Kodi i Procedurës Penale. Padia civile në procesin Penal.

Viktima e dëmtuar nga vepra penale, mund të kërkojë dëmin material brenda procesit penal (nenet 58-68 të kodit të Procedurës Penale). Ai i njeh të drejtën personit të dëmtuar, të kërkojë shpërblimin e dëmit të ardhur nga vepra penale.

Kërkimi i dëmit material

Personi i dëmtuar nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të kërkojnë vetëm dëmin material përmes padisë civile në procesin penal, kundër të pandehurit (të paditurit civil). Për të përcaktuar kuptimin e dëmit material (pasuror), edhe pse nuk ka ndonjë praktikë gjyqësore në procesin penal, mund t’i referohemi kodit Civil.

E vetmja formë e kompensimit për dëmin moral që mund të jepet nga gjykata penale, është publikimi i vendimit për të riparuar dëmin jopasuror. Në këtë rast, gjykata penale, me kërkesë të paditësit civil, urdhëron publikimin e vendimit të dënimit, si mënyrë e riparimit të dëmit jopasuror të rrjedhur nga vepra penale. Kodi jep mundësi që, nëse publikimi nuk kryhet brenda afatit të caktuar, paditësi civil mund të veprojë vetë për të kërkuar shpenzimet nga i dënuari.

Legjitimimi i paditësit civil

Legjitimimi i paditësit civil në procesin penal, mund të bëhet nga organi procedues derisa të mos ketë filluar procedimi gjyqësor. Ky afat nuk mund të zgjatet në asnjë rast.

⁸ Sipas nenit 58 dhe 61 të kodit të Procedurës Penale

Gjykata penale është e lejuar plotësisht që të veçojë padinë civile nga procesi penal dhe ta dërgojë atë për gjykim në procesin civil. Kjo mund të ndodhë jo vetëm me kërkesë të palëve, por edhe kryesisht, nëse gjykimi i padisë civile vështirëson ose zvarrit procesin penal⁹. Lejimi i veçimit të padisë civile në procesin penal, bëhet shkas për zvarritjen e gjykimit të saj, e cila i nënshtrohet procedurave civile. Praktika shqiptare, ka vërtetuar se ka qenë gati e pamundur të bëhet gjykimi i saj në procesin civil, pa përfunduar më parë procesi penal. Gjithashtu, është e vështirë të konceptohet ndjekja e një procesi të tillë kompensimi vetëm në kuadrin civil pavarësisht nga ai penal, pasi në praktikë, procesi civil mbështetet në vendimet penale dhe provat e servitura prej tyre. Faktet tregojnë se raste të kërimit të dëmit të kryer nga një vepër penale, si në procesin penal, edhe në atë civil, janë shumë të rralla.

Sigurimi i Padisë civile në procesin penal

Kodit i Procedurës Penale (neni 63), parashikon sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil, mbi bazën e kërkesës së paditësit civil dhe me vendim të organit procedues. Masa e sekuestrimit të pasurisë qëndron deri në përfundimin e çështjes. Natyrisht, fakti që paditë civile në procesin penal janë të rralla, kanë bërë që sekuestrimi paraprak i pasurisë si masë sigurimi, të mos vijë në zbatim të këtij neni. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë pati hyrja në fuqi e ligjit nr. 9284, dt. 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Ky ligj, vendosi standarde të reja në çështjen e sekuestrimit, si masë paraprake nga gjykata .

E drejta për t’u përfaqësuar me avokat

I dëmtuari akuzues, paditësi civil dhe i padituri civil, të cilët konsiderohen palë private, kanë të drejtë të përfaqësohen në procedim, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, ose përmes një përfaqësuesi të pajisur me prokurë. Ky i fundit, në rast pengese dhe për aq kohë sa zgjat ajo, me pëlqimin e të përfaqësuarit, mund të caktojë një zëvendësues.

⁹ Sa më sipër, është vendosur me një shtojcë, që kodit të Procedurës Penale i është bërë në vitin 2002 (Ligj nr. 8813, dt. 13.6.2002).

Pra, viktima paditëse civile në procesin penal, ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat. Por, mendojmë se, mungesa e një avokati kryesisht (ex officio), ka dobësuar aksesin e saj për të kërkuar dëmshpërblimin. Mungesa e një avokati falas ka dobësuar punën edhe për informimin e saj në lidhje me të drejtat për të kërkuar shpërblimin e dëmit, krahas procedimit të fajtorit.¹⁰

Disponimet për padinë civile në procesin penal

Gjykata penale sipas rastit, mund të vendosë pranimin e padisë, pranimin e pjesshëm të saj ose, rrëzimin e padisë. Në rastin e fundit, kjo padi nuk mund të ngrihet sërish në gjykatën civile, gjë që për mendimin tonë nuk përjashton mundësinë që të kemi një padi civile për të kërkuar dëmin moral.

Padia civile lihet e pashqyrtuar në procesin penal kur jepet vendimi i pafajësisë ndaj të pandehurit a të paditurit civil, ose kur vendoset pushimi i çështjes. Në këto raste, krijohet mundësia që kjo padi të ridrejtohet në procesin civil, gjë që në praktikën shqiptare bëhet gati e pamundur, për shkak të lidhjes së ngushtë që gjykatat civile në praktikën e tyre, i kanë bërë këtyre çështjeve me procesin penal. Në raste të tilla, ka ndodhur shpesh në praktikë që gjykata penale të dërgojë padinë civile për gjykim në gjykatën civile, ndërsa kjo e fundit, të pezullojë gjykimin deri në përfundimin e çështjes penale.

Praktikat gjyqësore në lidhje me kompensimin e viktimave të trafikimit

Praktika gjyqësore në lidhje me kompensimin e viktimave të trafikimit është krejt e pakët. Nga monitorimi i vendimeve të gjykatave për periudhën 2000-2006, është evidentuar vetëm një rast, ku gjykata penale ka gjykuar edhe padinë civile në procesin penal me objekt *shfrytëzim i prostitucionit*.

Rasti i A.V versus E.Z¹¹

Në këtë rast, gjykata ka pranuar kërkesën e avokatit të

10 Më gjerë shih: Ardit Mustafaj, “Produktet e veprës penale nga këndvështrimi juridiko-penal dhe i politikës kriminale”, Tiranë, 2007

11 Vendimi i Gjykatës së Shkallës I-rë, Tiranë, Nr. 163, Dt. 23/02/2004

viktimës (e cila në procesin penal kishte vetëm statusin e dëshmitares), për padinë civile në procesin penal. Tre gjyqtarët e trupit gjykues kanë arsyetuar drejt, pavarësisht se nuk kishte pasur më parë ndonjë rast të ngjashëm. Ata e kanë pranuar faktin se puna e paditëses për llogari të të akuzuarit, pavarësisht se ka qenë një punë e paligjshme, duhet çmuar. Më tej vendimi thekson se pavarësisht se kjo punë në Shqipëri nuk ka një çmim, mund të shihen çmimet e tjera. Sidoqoftë nuk del qartë në vendim se si është vendosur shuma 2 milion lekë (afërsisht 165000 euro), pasi nuk ka asnjë referim. Sidoqoftë, ky vendim është një hap pozitiv në praktikat e mira të gjykatës. Vendimi në fjalë është ankimuar nga i padituri, por u la në fuqi edhe nga gjykatat më të larta, por ende nuk është vënë në ekzekutim.

Një praktikë krejt tjetër ka ndjekur Gjykata e Shkallës së Parë të krimeve të rënda në rastin D.S versus A. A¹².

Në këtë rast, Gjyqtari i vetëm i kësaj gjykate ka marrë vendim për lënien e çështjes pa veprime, me qëllim plotësimin e padisë civile në procesin penal, duke i lënë kohë paditëses të paguajë taksën mbi aktet. Në këtë mënyrë, gjyqtari i është referuar procedurave civile, pa marrë parasysh faktin që jemi përpara një viktime nga një vepër e dhunshme penale.

2. 2. Kompensimi në procesin civil.

Kodi Civil parashikon kërkesën për kompensim në procesin civil, në rastin kur një person është dëmtuar nga një vepër penale¹³. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës civile u njihet edhe të huajve¹⁴. Kodi Civil parashikon mundësinë për të kërkuar si dëmin material¹⁵, ashtu edhe

12 Vendim i Gjykatës së Shkallës I-rë për krime të rënda,

Nr. 65 Akti, dt. 14.02.2008

13 Art.608

14 Art.3

15 E drejta për të kërkuar dëmin material (pasuror) është e lidhur ngushtë me kërkesat e mëposhtme: :

- a) Kërkohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga humbja e pësuar, si dhe nga fitimi i munguar.
- b) Shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin.
- c) Shpenzimet e nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit.
- d) Shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore (neni 640 i K.C).
- e) Shpërblimi i dëmit shëndetësor, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë

dëmin moral¹⁶. Problemi që ngrihet këtu, është se kërkesa për dëmin moral nuk mund të ngrihet në rastin e dëmtimit të ardhur nga një vepër penale. Por, në praktikë, pjesa më e madhe e dëmit për viktimën është një dëm moral, gjë që kërkon të ndiqet patjetër në një proces civil, të shkëputur nga ai penal, dhe që sjell probleme në çështjen e të provuarit. Fakti që dëmet morale nuk janë të kërkueshme në procesin penal, përfaqëson një pengesë serioze për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, duke pasur parasysh se në shumë raste, kërkesat e tyre duhet të jenë për dëmin moral. Për këtë, mund t'i drejtohen vetëm gjykatës civile dhe të përballojnë problemet që lidhen me të (shpenzime, kohë e gjatë dhe pasiguri për përfundimin e çështjes gjyqësore). Kjo ndikon në faktin që, në praktikën gjyqësore shqiptare, kërkesa të tilla janë pothuaj inekzistente. Sidoqoftë, ky nuk është faktori i vetëm, pasi për mendimin tonë, mungon një kulturë tërësore për kërkimin e dëmit.

Një aspekt i praktikës gjyqësore në këtë proces, lidhet me kohën dhe afatet e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim në procesin civil. Vendimi unifikues i Kolegejeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (nr. 284, dt. 15. 09. 2000), ka vendosur se, “*...padia civile nuk mund të paraqitet në një fazë procedimi që nuk e parashikon Kodi i procedurës Civile. Ky procedim nuk mund të fillojë në Gjykatën e Shkallës së dytë, siç ka vepruar Gjykata e Apelit, pasi do të ndodheshim para cenimit të parimit të respektimit të shkallëve të gjykimit civil, të parashikuar në*

për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar. Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo të rëndimit të shëndetit ose të shtimit ose pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit (neni 641-642 i K. C)

f) Parashikohet dëmshpërblimi për rastin e shkaktimit të vdekjes, i cili konsiston në shpenzimet për ushqim dhe jetesë të fëmijëve të mitur, të bashkëshortes dhe të prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit (plotësisht ose pjesërisht), si dhe personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit; shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit.

g) Parashikohet shpërblimi i dëmit duke pasur parasysh edhe përfitimin që ka pasur personi që ka kryer veprimin ose mosveprimin e paligjshëm, duke llogaritur këtë përfitim në shpërblimin e dëmit, tërësisht ose pjesërisht (Neni 644).

16 E drejta për të kërkuar dëmin moral (jopasuror) ekziston në rastet si më poshtë:

a. Kur personi ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij.

b. Është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga

bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes (ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e II-të).

nenin 135 të Kushtetutës dhe të përshkruar hollësisht në ligjin procedural”.

3. Statusi i viktimës dhe ndihma ligjore.

Shërbimet këshillimore për personat e trafikuar janë një element shumë i rëndësishëm për të realizuar të drejtën e kompensimit nga viktimat. Por, në legjislacionin shqiptar nuk është parashikuar ndonjë detyrim për policinë, prokurorët apo gjyqtarët, që të informojnë viktimat e një krimi për të drejtat e tyre në procesin gjyqësor. Viktima është pjesë e procesit penal vetëm kur ajo paraqitet si një paditëse civile në të, për të kërkuar dëmshpërblimin. Ajo mund të përfaqësohet nga një avokat, por nuk parashikohet ndihmë ligjore nga shteti përmes avokatit kryesisht. Duhet përmendur fakti se nuk ka ndalesa për organizatat e shoqërisë civile, të cilat mund të asistojnë në mënyrë vullnetare viktimën, por nuk ka as ndonjë legjislacion të veçantë për të ndihmuar organizatat në këto raste, ndërkohë që ato duhet të licencohen për shërbimet që japin, pranë organeve kompetente¹⁷.

Masa të tjera duhet të merren gjithashtu, për të garantuar sigurinë fizike dhe paprekshmërinë e personave përgjatë procedurës për kërkimin e kompensimit. Kjo do të thotë që, një shtëpi e përshtatshme, ndihma sociale, këshillimet ligjore, ndihma mjekësore dhe leja e qëndrimit, janë thelbësore për të ndihmuar të drejtat përmes të cilave krijohet mundësia që të kërkohet kompensimi. Kjo ndihmë duhet të jetë e asaj shkalle sa të lejojë që një person të jetë i mbështetur mjaftueshëm, që të jetë i aftë për të paraqitur provat që mbështesin kërkesën e tij.

Përse viktimat e trafikimit nuk kërkojnë kompensimin e dëmit të tyre?

Numri i padive civile në procesin penal në periudhën 2000-2006 është i papërfillshëm, kurse në procesin civil nuk ka asnjë kërkesë.

17 Ja si e vlerëson raporti i OSBE-ODHIR-it (Barcelonë 2007) për Shqipërinë këtë ndihmë të ofruar nga OJF-të: “Së paku një OJF, CLCI, ofron këshillime ligjore për viktimat e trafikimit, por kjo gjë nuk duket të jetë pjesë e mekanizmave të referimit në shtet. IOM ofron asistencë ligjore falas për Qendrën shtetërore të pritjes dhe NGI menaxhon një strehëz, “Diferent and Equal”. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si CLCI dhe Klinikën ligjore për të miturit. Cilësia e shërbimeve të ofruara prej tyre ka një reputacion të mirë si eksperte në këshillimet ligjore...”

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon një status të përshtatshëm për viktimën, lidhur me veprat e trafikimit dhe të shfrytëzimit të prostitucionit. Ajo mund të marrë pjesë në gjykim vetëm si dëshmitare dhe nuk mund të mbrohet nga një avokat, falas, të cilët ofrohen kryesisht nga shteti për të pandehurit.

Pamundësia që krijon fakti i mësipërm, si dhe fakti që viktima nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit moral, ka penguar aksesin në drejtësi për kompensim të viktimave të trafikimit. Por, përveç sa më sipër, ekzistojnë edhe arsye të tjera si, ndërgjegjësimi i pakët i viktimave për mundësitë e tyre në proces, pasiguria e gjendjes në të cilën ndodhen, si dhe pamundësia institucionale për të dhënë mbrojtjen e duhur nga kërcënimet e trafikantëve e nga riciklimi i tyre. Një arsye më e përgjithshme lidhet me mentalitetin shqiptar dhe ndërgjegjësimin e ulët të popullsisë, në të cilën mbizotëron ende mendimi *“Nderi dhe jeta nuk mund të blihen me para”*.

Mosanksionimi në mënyrë të shprehur në ligj i detyrimit të organeve kompetente për ta informuar viktimën, në lidhje me të drejtat që ajo ka për dëmshpërblim, ka ndikuar në zhvillimin e ulët të praktikave gjyqësore në këtë fushë. Prandaj, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe zbatimi i drejtpërdrejtë nga gjykata i akteve ndërkombëtare për këtë qëllim, mbetet një detyrë shumë e rëndësishme.

4. Skema shtetërore e kompensimit të viktimave të trafikimit.

Ligji Nr.9284, datë 30.09.2004 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”*

Ky ligj ka sanksionuar ngritjen e strukturave të posaçme për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar. Është e vërtetë se ai përbën një arritje të rëndësishme për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, duke parashikuar krijimin e një Fondi të posaçëm për kompensimin e viktimave, në përjasje me aktet ndërkombëtare¹⁸. Por, nuk duhet harruar fakti se në këtë ligj zë vend vetëm kompensimi dhe mbështetja kolektive e tyre, pa i kushtuar ndonjë rëndësi kompensimit individual.

18 Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, neni 15, pika 3,4

Krijimi i Agjencisë për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara të krimit të organizuar, si një strukturë pranë Ministrisë së Financave, është gjithashtu, një hap i rëndësishëm. Duhet pranuar se ky ligj, parashikoi për herë të parë institute të reja të legjisllacionit penal, të cilat përmbysin ato tradicionale dhe penguese (p.sh., konfiskimi parandalues i produkteve të veprave penale”).

“Nuk mund të mohohet fakti se miratimi i këtij ligji ishte rrjedhojë edhe e dështimit deri në atë kohë të legjisllacionit të të zakonshëm penal për të arritur rezultate të ndjeshme kundër fuqisë ekonomike të krimit të organizuar.”¹⁹

Zbatimi në praktikë në disa pika të ligjit, është bërë i vështirë. Kështu p.sh., janë evidentuar paqartësi në përcaktimin e kompetencave të strukturave përgjegjëse administrative, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të sekuestrimit apo konfiskimit të pasurive të krimit të organizuar. Për pasurinë e administruar, ligji nuk përcakton raportin e pasurisë që do të shkojë në administrim të organeve të drejtësisë dhe të pushtetit vendor, me pasurinë që do të shkojë për rehabilitimin dhe kompensimin e viktimave të trafikimit.

Mediat shpesh kanë ngritur problemin se pasuritë e konfiskuara qëndrojnë në vendet e caktuara për një kohë të gjatë pa ndonjë përkujdesje, duke u shkatërruar. Ato kanë denoncuar edhe raste kur punonjës të ngarkuar me ruajtjen e tyre kanë abuzuar me to²⁰. Pra, nuk ka pasur ndonjë rast kur ato të jenë përdorur për dëmshpërblimin e viktimave. Ministria e Financave ka qenë joaktive dhe nuk ka menaxhuar fondin e veçantë, qoftë edhe për aktivitet në favor të viktimave, apo të luftës kundër trafikut. Agjencia për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara pranë kësaj ministrie pothuaj nuk funksionon, për shkak të boshllëqeve ligjore për organizimin dhe kompetencat e saj, si dhe për shkak të mungesës së akteve nënligjore.

Hartimi i një kuadri të plotë ligjor në këtë aspekt, do të bënte të mundur që Gjykata e Krimeve të Renda të vendoste edhe në lidhje me administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të konfiskuara në bazë të këtij ligji, gjë që nuk ka ndodhur. Nga monitorimi i Qendrës për nisma

¹⁹ Ardit Mustafaj, po aty.

²⁰ Sipas medias elektronike “Top Chanel”, emisioni “Fiks Fare”

ligjore Qytetare²¹, është konstatuar se në asnjë vendim, kjo gjykatë nuk është shprehur në lidhje me destinacionin e pasurive të konfiskuara në bazë të këtij ligji, pasi baza ligjore është e paqartë.

Vështirësitë e zbatimit në praktikë të ligjit Nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, tregojnë gjithashtu, nevojën e hartimit të akteve nënligjore që do të rregullonin më qartë skemën e kompensimit dhe do të garantonin të drejtën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për kompensim.

Aktualisht, Zyra e Koordinatorës Kombëtare, me ndihmën e ekspertizës ndërkombëtare po përgatit ndryshimet ligjore të nevojshme, si dhe aktet përkatëse nënligjore. Mbetet ende për të parë se si ky sistem do të punojë dhe se si assetet e konfiskuara do t’i shpërndahen viktimave të trafikimit. Deri tani është krejt e paqartë se sa ka qenë shuma që ka kaluar në favor të viktimave të trafikimit, kolektivisht. Duhet theksuar gjithashtu, që kjo skemë nuk i mbivihet detyrimeve që Shqipëria ka në bazë të ECCVVC dhe shteti mund të vendosë skema të tilla për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme.

21 Shih Raportin Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, mjet në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

II. DREJTËSIA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

BESA SARAÇI

Avokate pranë Qendrës për
Nisma Ligjore Qytetare

ÇËSHTJE TË PRAKTIKËS GJYQËSORE NË GJYKIMET E VEPRAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

*(Të dhëna nga monitorimi i
vendimeve gjyqësore të Gjykatës
së Krimeve të Rënda për
periudhën 2004-2006)*

Në kuadër të projektit “*Edukimi ligjor dhe Mbrojtja e të Drejtave. Aksesimi në Drejtësi i personave të trafikuar dhe grupeve në rrezik për t’u trafikuar*”, Qendra për Nisma Ligjore monitoroi vendimet gjyqësore mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe disa seanca gjyqësore në lidhje me këto çështje. Nga monitorimi rezultuan disa të dhëna të cilat na krijojnë ide të qarta mbi problemet me të cilat ndeshet praktika gjyqësore për zbatimin e ligjit në këtë fushë.

*(1. Çështje penale të gjykuara
në periudhën 2004-2006)*

Të dhënat në tabelën e mëposhtme paraqesin një tablo të përgjithshme të çështjeve penale të gjykuara nga Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë në tre vite objekt monitorimi, 2004, 2005 dhe 2006.

Tabela nr.1 Çështjet penale të trafikimit të qenieve njerëzore të gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Viti	Numri i çështjeve
2004	9
2005	6
2006	7
Totali	22

Për vitet 2004-2006, janë gjykuar gjithsej 22 çështje. Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë periudhës objekt monitorimi rezulton se gjatë vitit 2004 numri i çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore të gjykuara nga kjo gjykatë zë 40.9% të çështjeve, gjatë vitit 2005 numri i çështjeve të gjykuara zë 27.2% të çështjeve dhe gjatë vitit 2006, numri i çështjeve zë 31.8 % të çështjeve.


Në vitin 2005, 2006 vihet re një rënie e numrit të çështjeve të gjykuara nga kjo gjykatë, në krahasim me vitin 2004.

Megjithëse nga tabela e mësipërme rezulton se ka një rënie të numrit të çështjeve të gjykuara për vitet 2005-2006, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2007 janë monitoruar 10 procese gjyqësore lidhur me veprën penale të trafikimit. Pra, nga krahasimi i numrit të çështjeve të gjykuara në këto periudha, rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve gjyqësore për veprën penale të trafikimit.

2. Numri i të gjykuarve në çështjet penale të trafikimit, të gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në periudhën objekt monitorimi.

Tabela nr.2:

Viti	Numri i çështjeve
2004	15
2005	17
2006	9
Totali	41



Në lidhje me numrin e të gjykuarve, nga monitorimi i vendimeve gjyqësore, rezultojnë si më poshtë vijon:

- Gjatë vitit 2004, numri i të gjykuarve përbën 36.5% të numrit të përgjithshëm të tyre, gjatë të tria viteve objekt monitorimi.
- Gjatë vitit 2005, numri i të gjykuarve përbën 41.4 % të të gjykuarve
- Gjatë vitit 2006, numri i të gjykuarve përbën 21.9% të tyre.

Sikurse mund të shihet lehtë, gjatë vitit 2006 numri i të gjykuarve ka pësuar rënie në krahasim me numrin e të gjykuarve gjatë vitit 2004 dhe 2005. Gjatë vitit 2005 ka një rritje të numrit të tyre në krahasim me vitin 2004.

3. Probleme të të provuarit dhe të trajtimit të viktimës

3.1 Të dhëna në lidhje me viktimën, e dëmtuar nga veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë monitorimit nuk rezultoi asnjë padi civile në procesin penal, e ngritur nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Në lidhje me deklarinë e viktimës kanë rezultuar këto të dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3: Deklarimi i viktimës, për veprat objekt monitorimi

Viti	Në sallë	Me letër porosi	Sigurim prove	Pa të dhëna
2004	3	-	5	3
2005	2	-	4	-
2006	1	1	5	3
Totali	6	1	14	6

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare nëpërmjet monitorimit të kryer të

vendimeve gjyqësore penale për periudhën 2004-2006 dhe monitorimit të seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda gjatë vitit 2007, ka konstatuar se, pothuajse në çdo rast të gjykimit të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore, dëshmia e viktimës së trafikimit është realizuar në bazë të nenit 316 e vijues të Kodit të Pr.Penale me sigurim prove, si dhe bazuar në nenin 361/7, me pyetje në distancë.

Nga tabela rezulton se kemi një numër të ulët të viktimave të trafikimit që deklarojnë dëshminë e tyre edhe në proceset gjyqësore. Parë në këtë këndvështrim, si dhe në kuadër të detyrimeve për unifikimin e legjislacionit dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, organet e drejtësisë e kane konsideruar si një prioritet sigurinë dhe mirëqenien e viktimës.

3.2 Bashkëpunimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me organet e drejtësisë vlerësohet si mjaft i rëndësishëm për ndjekjen penale të autorëve, për shkak të elementëve të këtyre veprave dhe mënyrave se si kryhet trafikimi i qenieve njerëzore.

Me qëllim zbehjen e bashkëpunimit të viktimave me organet e drejtësisë, trafikantët ushtrojnë presione në formën e kërcënimeve për jetën e viktimave dhe të familjarëve të tyre. Në këto kushte ato hezitojnë të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, edhe gjatë proceseve gjyqësore. Mbrojtja e viktimave, ruajtja e anonimatit, dhe garantimi i sigurisë së viktimave përbën një domosdoshmëri, për ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave²². Në ndonjë rast, nga organet e drejtësisë nuk është ofruar siguria dhe mjedisi i përshtatshëm me qëllim që viktima të bashkëpunojë me këto organe. Ky qëndrim ka sjellë dhe raste të gjykimit dhe dënimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me akuzën e “dëshmisë së rreme”, neni 306/1 i Kodit Penal²³.

22 Përmbyshja e kësaj domosdoshmërie përbën një detyrim që buron nga neni 25/1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, i cili kërkon që shteti shqiptar të marrë masat e duhura për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, veçanërisht në rastet e kërcënimit për hakmarrje ose terrorizimin e tyre. Ky detyrim përforcohet edhe nga Rekomandimet e Komitetit CEDAW, në janar të vitit 2003, i cili i kërkon Palës Shtetërore të sigurojë që gratë dhe vajzat e trafikuar kanë mbrojtjen dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë që t'i mundësojë të dëshmojnë kundër trafikantëve.

23 Vendimi nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Qëndrime të pakujdesshme, madje në ndonjë rast të veçantë edhe veprime në kundërshtim me ligin të organit të akuzës, kanë krijuar mundësi për ritrafikimin e viktimës. Kështu, në vendimin nr.3, datë 17.01.2006 të Gjykatës së Krimeve të rënda, arsyetohet se: *“E dëmtuara, e mashtruar si dhe nën presionin edhe të prindërve të saj, ka tërhequr kallëzimin dhe prokuroria e rrethit Bulqizë, ndonëse vepra penale që rezulton nga materiali kallëzues nuk përfshihet në ato të parashikuara nga neni 284 të K.Pr.Penale, ka vendosur mos fillimin e çështjes penale ndaj të pandehurit A!!!”* Në vijim të këtij qëndrimi, e dëmtuara A, u ritrafikua.

Rekomandohet që viktimat e trafikimit duhet të gëzojnë të drejtën për të vetëvendosur në lidhje me bashkëpunimin me organet e drejtësisë dhe parashikimi dhe gëzimi i kësaj të drejte, shtron nevojën e ndryshimeve të mëtejshme të legjislacionit procedural penal shqiptar.

3.3 Format e ndjekura nga trafikantët për tërheqjen e viktimës në trafik

Tabela nr. 4: Format e përdorura nga trafikantët .

Viti	Mashtrim për punë	Mashtrim për martesë
2004	4	5
2005	0	6
2006	2	5
Totali	6	16

-Gjatë vitit 2004, në 5 raste, të akuzuarit kanë përdorur formën e mashtrimit për martesë dhe në 4 raste mashtrimin për punë.

-Gjatë vitit 2005, në 6 raste është përdorur forma e mashtrimit për martesë.

-Gjatë vitit 2006, në 5 raste është përdorur mashtrimi për martesë dhe në dy raste mashtrimi për punë.

3.4 Problemet social ekonomike me të cilat është përballur viktimat.

-Në 15.3% të çështjeve të gjykuara në vitin 2004, kanë rezultuar probleme të mprehta ekonomike, në 30.7% të tyre kanë rezultuar probleme familjare, në 46.1 % të tyre është ushtruar dhunë dhe në 7.6% të tyre është ushtruar torturë mbi viktimën.

-Gjatë vitit 2005, në 66.6% të rasteve ka rezultuar dhunë e të gjitha

formave, në 22.2% të rasteve kanë rezultuar probleme ekonomike dhe familjare dhe në 11.1% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën. -Gjatë vitit 2006, në 25% të rasteve, problemet ekonomike dhe familjare janë prezent, në 62.5% të tyre dhuna është prezent dhe në 12.5% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën.

Disa forma të ashpra dhune me të cilat janë përballur viktimat e trafikimit janë detyrimi për ndërprerjen e shtatzënisë, tentativa për mbytje të viktimës, goditje me shkelma dhe grushte, etj²⁴.

Rekomandim: pavarësisht arritjeve në arsyetimet e vendimeve penale, mendojmë se duhet treguar më shumë kujdes në trajtimin e viktimës, problemeve të saj sociale dhe problemeve të tjera me të cilat ajo është përballur.

Konstatojmë se në disa raste, terminologjia e përdorur në lidhje me viktimën e trafikuar, fjala vjen, përdorimi i termave të tillë si “prostitutë”, “industri e qejfit”, nuk është në përputhje me standardet dhe e riviktimizon viktimën edhe nga profesionistët e sistemit të drejtësisë²⁵.

3.5 Njohja dhe zbatimi i drejtësisë restauruese, si dhe parimeve që në qendër të procesit vendosin viktimën.

Në mbështetjen dhe restaurimin e viktimës një rol të rëndësishëm luan edhe trajtimi psikologjik i saj. Mendojmë se ky trajtim, si aspekt i rëndësishëm i praktikës gjyqësore është problematik dhe meriton vëmendje të veçantë.

Gjatë monitorimit, kemi evidentuar pak raste të trajtimit psikologjik për viktimat e trafikimit, nga punonjësit socialë gjatë procesit hetimor e gjyqësor. Kështu, nga analiza e vendimeve të Gjykatës së Tiranës

24 Referuar vendimit nr.68, datë 15.12.2005, Vendimi nr.3, datë 28.04.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

25 Shih vendimin nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

për periudhën 2004-2006, në një rast²⁶ rezulton se gjykata ka kërkuar pjesëmarrjen e një eksperti psikolog për të asistuar viktimën e trafikimit. Ndërsa, në një rast tjetër²⁷ (nga pjesa arsyetuese e vendimit), rezulton se viktimja është pyetur nga një psikologe, për shkak të moshës së saj të mitur. Në qendrat ku mbahen ish-viktimat e trafikimit ofrohet një asistencë e tillë, por kjo asistencë duhet të jetë e vazhdueshme, si gjatë zhvillimit të procesit penal, ashtu edhe në mbarim të tij, me qëllim që viktimja të rehabilitohet nga këndvështrimi psikologjik dhe moral.

Rekomandim: mendojmë se asistenca me psikolog për viktimat e trafikimit nuk duhet të mbetet rastësore, por të krijohet një praktikë, jo vetëm në rastet kur viktimat e trafikimit janë të mitura, por në çdo rast tjetër gjykimi.

3.6 Zbatimi i akteve ndërkombëtare nga organet e procedimit dhe gjyqimit

Gjatë monitorimit u evidentuan disa raste të referimit të drejtpërdrejtë të gjyqtarëve në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Ka një rritje progresive të vendimeve gjyqësore²⁸ që janë bazuar drejtpërdrejtë në aktet ndërkombëtare.

Disa nga konventat dhe aktet e referuara kanë qenë:

-Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002;

-Protokolli “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar,

-Konventa për ndihmë të ndërsjellët juridike në fushën penale, etj.

Në tabelën nr. 5, mund të gjeni numrin e rasteve që janë referuar

26 Vendim i datës 12.11.2004 (Gjykim lidhur me nenin 101 të Kodit Penal)

27 Vendim i datës 09.05.2006 (Gjykim lidhur me nenin 101 të Kodit Penal)

28 Vendimi nr.21, datë 13.09.2004;Vendimi nr.3, datë 18.01.2005; Vendimi nr.8, datë 11.02.2005;Vendimi nr.43,datë 13.11.2006; Vendimi nr.3,datë 17.01.2006; Vendimi nr.39, datë 02.10.2006;

në aktet ndërkombëtare për dhënien e vendimit.

Tabela nr.5: Referimi në aktet ndërkombëtare

Viti	Numri i referimeve
2004	1 referim
2005	2 referime
2006	3 referime
Totali	6 referime

-Gjithashtu nga monitorimi rezultuan edhe raste të referimit në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në Strasburg²⁹.

Referimi në aktet ndërkombëtare u evidentua edhe në praktikat e prokurorisë së krimeve të rënda. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore mbanin parasysh këto akte në zbatimin e të drejtave të viktimës. P.sh., edhe pse ligji procedural shqiptar nuk është shprehur mbi detyrimin e organit për të informuar viktimën për të gjitha të drejtat, prokurorët e çështjes përpiqeshin ta bënin këtë gjë. Kjo, nuk mund të justifikojë mungesat në ligjin e brendshëm.

Rekomandim: është e nevojshme që standardet ndërkombëtare të pasqyrohen mirë në ligjet e brendshme. Sidoqoftë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe zbatohen drejtpërdrejt. Gjyqtarët mund t'u referohen atyre, njësoj sikurse u referohen ligjeve të brendshme. Ky referim bëhet i domosdoshëm në rastet kur në ligjin e brendshëm paraqiten boshllëqe, ose në rastet kur mungon ligji i brendshëm.

3.7 Çështje të një procesi të rregullt ligjor

Nga monitorimi i 19 seancave gjyqësore në Gjykatën e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2007, rezultuan disa probleme, të cilat po i paraqesim shkurtimisht, si më poshtë vijon:

-U konstatua shtyrje e seancave gjyqësore, për shkak se:

29 Shih vendimin Nr.3, datë 17.01.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

- Në 5 raste u evidentuan shtyrje të seancave gjyqësore, pasi nuk u formua trupi gjykues
- në 5 raste nuk ka pasur pjesëmarrje të avokatëve mbrojtës,
- në 3 raste nuk janë paraqitur dëshmitarët,
- në 3 raste nuk bëhet i ditur shkaku për shtyrjen e seancës
- në 1 rast të vetëm është vërejtur mosprezenca e të pandehurit

-Problem kryesor gjatë monitorimit shfaqet mosprezenca e viktimave, problem ky i evidentuar pothuajse në të gjitha seancat e monitoruara.

-Dëshmia nga ana e viktimave gjithnjë është bërë me letër-porosi ose me sigurim prove³⁰.

-Problem tjetër që rezulton nga monitorimi është vonesa procedurale lidhur me zhvillimin e seancave, për shkak se:

- 1 - zëvendësimi i avokatëve të mëparshëm me avoka të rinj
- 2 - veprimet procedurale për veçimin e çështjeve
- 3 - mosnjohja paraprake me dosjen, nga avokati
- 4 - mosformimi i trupit gjykues, për shkak të angazhimeve të gjyqtarëve në të njëjtën kohë në procese të tjera
- 5 - mosparaqitja e avokatëve pa shkaqe të arsyeshme
- 6 - mosparaqitja e dëshmitarëve dhe/ose viktimave

Nga të gjitha çështjet e monitoruara gjatë viti 2007, ka përfunduar vetëm njëra prej tyre dhe të tjerat janë ende në proces.

30 Kodi i Procedurës Penale, Kreu II - Letërporositë ndërkombëtare, Nenet 505-511

AURELA BOZO (master)

Avokate pranë Qendrës për
Nisma Ligjore Qytetare

**DISA PROBLEME NË
LIDHJE ME USHTRIMIN
E TË DREJTAVE NGA
KOMUNITETI ROM
DHE NDËRGJEGJËSIMI
I TIJ PËR ZGJIDHJEN E
TYRE**

**1 Problematika të evidentuara
nga përpunimi i të dhënave të
pyetësorëve. (Komuniteti Rom,
në Tiranë, Vlorë dhe Fier)**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e projektit “Njohja e të drejtave ligjore dhe sociale të komunitetit Rom-mjeti më i rëndësishëm në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore”, organizoi disa tryeza pune me pjesëmarrjen e komunitetit Rom³¹, në Levan (Fier), Llakatund (Vlorë) dhe Tiranë (Bregu i Lumit), me qëllim rritjen e nivelit të njohurive të qytetarëve të këtij komuniteti mbi të drejtat e tyre. Ne besojmë se njohja dhe gëzimi i të drejtave nga ky komunitet, do të reduktojë mundësinë për trafikimin e qenieve njerëzore në këtë komunitet, duke i bërë ata më rezistentë ndaj këtij fenomeni.

31 Në këto tryeza morën pjesë rreth 70 pjesëmarrës, gjithsej.

Përmes zhvillimit të këtyre aktiviteteve janë arritur disa rezultate të rëndësishme: *Së pari*, është rritur niveli i informacionit mbi të drejtat dhe liritë themelore të Njeriut tek ky komunitet. *Së dyti*, Ky komunitet ka marrë më shumë informacion mbi aktorët e shoqërisë civile dhe shërbimet që ata ofrojnë me qëllim përfitimin prej tyre. *Së treti*, janë këshilluar disa përfaqësues të këtij komuniteti, në lidhje me probleme të ndryshme familjare, të identifikuar gjatë organizimit të workshopeve. *Së katërti*, janë forcuar kapacitetet brenda komunitetit rom, nëpërmjet trajnimit të specializuar të dy përfaqësuesve të përzgjedhur nga ky komunitet, me qëllim vazhdimin e punës jo vetëm gjatë zbatimit të projektit, por edhe pas përfundimit të tij. *Së pesti*, janë evidentuar nga afër problemet e komunitetit Rom, gjë që do të na ndihmojë për të dizenuar fushat e ndërhyrjes në të ardhmen për përmbushjen e nevojave të këtij komuniteti, si dhe për bashkëpunimin me këtë komunitet.

Në tryezat e punës ne shpërndamë një pyetësor për t'u njohur me situatën faktike të komunitetit rom dhe mundësinë e tij për t'i rezistuar trafikimit të qenieve njerëzore.

Me qëllim matjen e disa treguesve mjaft të rëndësishëm të jetesës së komunitetit Rom, u përdor metoda e intervistimit individual të përfaqësuesve të këtij komuniteti nëpërmjet pyetësorëve dhe u evidentuan disa problematika, të cilat shtrajnë nevojën e përmirësimit të punës si për organet e pushtetit vendor dhe për të gjithë aktorët e shoqërisë.

- **E drejta për t'u arsimuar. Ushtrimi dhe gëzimi i saj nga komuniteti rom.**

Në Komunën Levan të Qarkut Fier, duke vlerësuar të drejtën për arsim si një të drejtë mjaft të rëndësishme, ne drejtuam pyetje në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte nga pjesëmarrësit dhe morëm këtë përgjigje: -47.6% e pjesëmarrësve rezultuan me arsim 8 vjeçar;

-19 % e tyre me arsim fillor

-19 % me arsim të mesëm.

Asnjë nga pjesëmarrësit nuk kishte përfunduar arsimin e lartë. 14.4% e pjesëmarrësve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.

Në aktivitetin e organizuar pranë komunitetit Rom në Tiranë pjesëmarrësit rezultuan me arsimin si më poshtë:

DISA PROBLEME NË LIDHJE ME USHTRIMIN E TË DREJTAVE

- 75 % e pjesëmarrësve kishin përfunduar arsimin tetëvjeçar,
- 10% e tyre kishin përfunduar arsimin fillor,
- 5% e pjesëmarrësve kishin përfunduar arsimin e mesëm
- 10% e tyre arsimin e lartë.

Në Komunën Llakatund, Qarku Vlorë:

- 63.1% e pjesëmarrësve rezultuan me arsim tetëvjeçar,
 - 10.5% me arsim të mesëm,
 - 10.5% me arsim fillor
- Nuk kishte pjesëmarrës me arsim të lartë.

Ne e konsideruam si një çështje mjaft të rëndësishme arsimimin e fëmijëve Rom, me qëllim që ata të mos jenë të dobët dhe të brishtë përballë fenomenit të trafikimit. Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve në lidhje me rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre, u realizua edhe nëpërmjet temave që u mbajtën në workshopet e organizuara, të cilat u zhvilluan nëpërmjet inskenimeve interesante, me qëllim bërjen e tyre sa më konkrete.

Në vijim të pyetjeve “A ndjekin shkollën fëmijët tuaj?”, si dhe “Nëse fëmijët tuaj nuk e ndjekin shkollën, cila është arsyeja?”, u bë e qartë gjendja e frekuentimit të shkollës nga fëmijët Rom, me qëllim që të evidentoheshin mundësitë për ndërhyrje. Qëllimi ynë ishte të identifikonim masat për realizimin e kësaj të drejte në Strategjinë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom. Kjo strategji ndër të tjera i përkushtohet “sensibilizimit të opinionit të komunitetit Rom për regjistrimin e nxënësve në shkolla, e cila do të bëhet vazhdimisht” dhe “duke intensifikuar punën me prindërit Rom për ndërgjegjësimin e tyre për një qëndrim dhe vlerësim sa më pozitiv ndaj shkollës”.

Në lidhje me sa më sipër morëm këto përgjigje:

19 % e pjesëmarrësve në Levan (Fier), 20% e pjesëmarrësve në zonën e Bregut të Lumit (Tiranë) dhe 55 % e pjesëmarrësve në Llakatund (Vlorë), u përgjigjën se fëmijët e tyre nuk e ndjekin shkollën.

18.5% e pjesëmarrësve në workshopin e Levanit shpjegojnë se fëmijët e tyre nuk e ndjekin shkollën sepse ata, si prindër kanë menduar se është më e vlefshme që fëmijët e tyre të punojnë. Natyrisht, në këtë

përgjigje ndikojnë edhe faktorë të tjerë si, niveli i varfërisë, lëvizjet e vazhdueshme të vendqëndrimit të këtij komuniteti, konceptet e prindërve për shkollën dhe rëndësinë e saj, të cilat padyshim janë të lidhura ngushtë edhe me nivelin e ulët të arsimimit të prindërve. -7.4 % e rasteve u përgjigjën se nuk i lejojnë fëmijët e tyre të ndjekin shkollën, sidomos vajzat.

-3.7 % e tyre kanë pohuar se fëmijët e tyre kanë provuar të fillojnë shkollën, por nuk janë ndjerë mirë.

Në Llakatund, zënë 10 % prindërit që nuk i kanë lejuar fëmijët e tyre të ndjekin shkollën si dhe ata që nuk kanë pranuar t'i regjistrojnë.

Në pjesëmarrësit e tryezës së organizuar në Tiranë, përqindjen më të lartë e zënë përgjigjet se fëmijët kanë provuar ta fillojnë shkollën por nuk janë ndjerë mirë, e ndjekur nga përgjigja tjetër se prindërit kanë menduar se është më e vlefshme që ata të punojnë.

Këto përgjigje, na bëjnë të ndërgjegjshëm se mbetet shumë për të bërë për regjistrimin e këtyre fëmijëve, për një qëndrim përfshirës ndaj tyre që ata të mos ndihen të përjashtuar nga shoqëria, si edhe për koordinimin e përpjekjeve të gjithë aktorëve për të bërë të mundur gëzimin e të drejtës për arsim, si një e drejtë shumë e rëndësishme për zhvillimin dhe integrimin e këtij komuniteti.

2. Problemet sociale dhe ligjore të komunitetit Rom, lidhur me martesat dhe regjistrimin e fëmijëve.

Këto çështje u trajtuan me mjaft kujdes gjatë këtyre takimeve.

Nga përgjigjet e pyetësorit përkatës rezultoi se:

-28.5 % e pjesëmarrësve në Levan janë martuar në moshën 12-18 vjeç.

-Në Llakatund, 40% të pjesëmarrësve ishin martuar në moshën 12-18 vjeç.

Duke e konsideruar dhunën në familje si një shkak që e bën më të dobët këtë komunitet ndaj trafikimit të qenieve njerëzore u përfshinë pyetje në lidhje me format e dhunës në familje, nga të cilat rezultoi një mungesë e theksuar informacioni në lidhje me to.

Këto rezultate diktojnë nevojën e një pune të vazhdueshme ndërgjegjësimi me këtë komunitet, në lidhje me martesat dhe problemet familjare.

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve, rezultoi se në 40 % të përgjigjeve, pjesëmarrësit kanë menduar se do të kryhet regjistrimi i popullsisë Rome nga shteti. Kjo alternativë është parashikuar e mbështetur në Strategjinë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, në të cilën parashikohet se, duke marrë në konsideratë problemet e këtij minoriteti për regjistrim në zyrat e gjendjes civile, Ministria përkatëse do të hartojë një program për regjistrimin e kësaj pjese të popullsisë duke siguruar mjetet e nevojshme njerëzore, monetare dhe materiale. Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve, në Levan, 6.6% e përgjigjeve ishin: “nuk kemi mundësi të paguajmë një avokat”;

-23.3% u përgjigjën se nuk kanë informacion se si t’i regjistrojnë. Ata nuk njihnin organizata jofitimprurëse që mund t’i ndihmonin;

- 3.3 % e përgjigjeve rezultojnë se nuk kanë informacion mbi regjistrimin, pra nuk njohin afatet, procedurat etj.

-Në totalin e përgjigjeve, vetëm 3.3 % janë përgjigjur se, nuk e kanë menduar si të nevojshëm regjistrimin e fëmijëve.

Në Llakatund, 20% e pjesëmarrësve japin si arsye kryesore të mos regjistrimit të fëmijëve të tyre, mungesën e informacionit në lidhje me regjistrimin dhe afatin e shkurtër.

Në workshopin e organizuar në Tiranë ata që mendojnë se regjistrimi i popullsisë rome do të kryhet me programe të veçanta nga shteti, përbënin 34.6% të pjesëmarrësve;

-15.3% e tyre nuk kanë informacion mbi OJF-të që e ofrojnë këtë shërbim falas.

-11.5% e pjesëmarrësve në këtë workshop, përgjigjen se nuk kanë mundësi të paguajnë një avokat.

Shtrohet nevoja e njohjes së ligjit të gjendjes civile dhe përmirësim-it të mëtejshëm të tij, në mënyrë të veçantë në lidhje me afatet kohore dhe mënyrën e kryerjes së regjistrimit të fëmijëve.

Ka një nivel më të lartë ndërgjegjësimi të komunitetit rom mbi pasojat e mos regjistrimit të fëmijëve në lidhje me rrezikun për t’u trafikuar. Më pak të ndërgjegjësuar qytetarët e komunitetit Rom paraqiteshin në lidhje me pasojat që ka mos regjistrimi i fëmijëve ndaj

përfitimit nga ndihmat sociale apo mundësitë për t'u punësuar.

Kështu, 85.7% e pjesëmarrësve u përgjigjen se janë të ndërgjegjshëm se, duke mos u regjistruar ata vetë ose fëmijët e tyre, mund të rrezikonin trafikimin.

Vetëm një përqindje e ulët e tyre nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë, gjë që shpjegohet ndër të tjera, me punën e mirë që është bërë nga aktorë të ndryshëm për shpjegimin e faktit se mos regjistrimi rrit rrezikun e fenomenit për t'u trafikuar.

71.4% e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Levan dhe 65 % e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Tiranë, kishin njohuri për faktin se, duke mos u regjistruar nuk përfitonin nga ndihmat sociale; 71.4 % e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Levan dhe 75% e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Tiranë, kishin njohuri se ky fakt, ul shanset e tyre për t'u punësuar.

3. Aksesi i komunitetit Rom në punë e shërbime.

E drejta për punësim. Në lidhje me gëzimin e kësaj të drejte nga ky komunitet, situata ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime. Një përqindje mjaft e ulët e pjesëmarrësve në këto workshope ishin të punësuar.

Zbatimi i programeve të posaçme të nxitjes së punësimit për komunitetin rom, përdorimi i politikave lehtësuese për ato kompani që punësojnë anëtarë të këtij komuniteti, si dhe mbështetja e komunave dhe bashkive për futjen e komunitetit rom në tregun e punës, mbeten sfida të vështira për tu përballur nga të gjithë aktorët.

Aksesi i Komunitetit Rom në Organet e Qeverisjes vendore.

Në komunën Levan, në lidhje me paraqitjen në zyrat e pushtetit lokal për të përfituar nga ndihmat sociale, 85.7% e pjesëmarrësve përgjigjen se nuk janë paraqitur.

Në lidhje me faktin nëse pushteti lokal ka ndihmuar për këtë komunitet për përmbushjen e nevojave për arsim, medikamente e nevoja shëndetësore, punësim e strehim, përgjigjet ishin të ndryshme. Në shifra të ulëta paraqiteshin në lidhje me përmbushjen e nevojave për punësim e strehim dhe relativisht më të larta për nevoja shëndetësore dhe arsim.

DISA PROBLEME NË LIDHJE ME USHTRIMIN E TË DREJTAVE

Kështu, përbënin 57.1% të pjesëmarrësve ata që mendojnë se pushteti lokal i ka ndihmuar për përmbushjen e nevojave shëndetësore dhe 23.8% e pjesëmarrësve u përgjigjen se pushteti lokal i ka ndihmuar në lidhje me përmbushjen e nevojave për arsim.

Përgjigjet në lidhje me pyetjen “A ju kanë informuar punonjësit e këtyre zyrave për shërbimet që ju mund të përfitoni dhe kushtet që duhet të plotësoni”, rezultoi se, 61.9% e pjesëmarrësve në Levan përgjigjen jo.

Në tërësi, mendojmë se mbetet shumë për të bërë në komunikimin dhe mbështetjen e komunitetit rom nga pushteti vendor.

Besimi i komunitetit Rom në organet e policisë dhe gjyqësorit.

Në lidhje me faktin nëse janë rrezikuar vetë pjesëmarrësit apo fëmijët e tyre të trafikohen rezultoi se ka pasur vetëm një rast në rrezik për tu trafikuar dhe asnjë rast të fëmijëve të rrezikuar për tu trafikuar. Vetëm në një përgjigje rezultoi se një nga pjesëmarrësit në rrezik trafikimi ka denoncuar në organet e policisë. Pjesëmarrësit, pavarësisht se i janë drejtuar organeve të policisë vetëm në një rast, mendojnë se qëndrimi i organeve të policisë ndaj këtij komuniteti nuk ka qenë korrekt dhe mbështetës.

Nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve rezultoi se vetëm në dy raste pjesëmarrësit i janë drejtuar gjykatës. Por, pavarësisht faktit se numri i pjesëmarrësve që i janë drejtuar gjykatës është i ulët, pjesëmarrësit në takimet e organizuara mendojnë se qëndrimi i gjykatës nuk ka qenë korrekt me ta.

Ndjeshmëria e qytetarëve romë ndaj ligjit dhe organizatave që japin ndihmë ligjore.

Në lidhje me njohjen e të drejtave ligjore ka rezultuar se 71.4% e pjesëmarrësve në Levan mendojnë se është e nevojshme njohja me të drejtat e tyre ligjore. Edhe në Tiranë dhe Llakatund, përgjigjet janë në shifra të larta në lidhje me këtë çështje. Kjo na bën të mendojmë se ka shumë nevojë për ndërhyrje dhe kontribut, në lidhje me njohjen dhe ndërgjegjësimin për gëzimin e këtyre të drejtave.

Në lidhje me informimin e këtij komuniteti për rolin e sektorit jofitimprurës, 90.4 % e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Levan, kishin dijeni se, janë disa organizata rome dhe jo rome që ofrojnë shërbime të ndryshme sociale dhe ligjore për komunitetin rom. Kjo falë punës së mirë që është bërë nga shoqëria civile gjatë viteve të fundit. 60% e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Tiranë dhe 80 % e pjesëmarrësve në workshopin e organizuar në Llakatund, kishin dijeni për këto organizata dhe shërbimet që ato ofrojnë 66.6% e pjesëmarrësve në Levan, 55 % e pjesëmarrësve në Tiranë dhe 40% e pjesëmarrësve në Llakatund kanë kontaktuar me organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për këtë komunitet.

Është pozitive që, 76.1% e pjesëmarrësve në Levan, 55 % e pjesëmarrësve në Tiranë dhe 70 % e pjesëmarrësve në Llakatund, mendonin se janë ndihmuar prej organizatave jofitimprurëse për të zgjidhur problemet e tyre.

Rekomandohet ndërmarrja e nismave sociale dhe ekonomike, për të konsideruar subjekte të asistencës sociale, kredive me kushte lehtësuese, strehimit, arsimimit, punësimit etj. me qëllim rehabilitimin e viktimave.

Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit të organizatave jofitimprurëse rome dhe jo rome si dhe aktorëve të tjerë që kontribuojnë në adresimin e këtij fenomeni.

VERA LESKO

(Drejtore Ekzekutive e Qendrës
VATRA)

**VËSHTRIM MBI DISA
TIPARE TË REJA TË
SITUATËS AKTUALE TË
FENOMENIT TË
TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE
NË SHQIPËRI**

Ndryshimet e vazhdueshme që Ministria e Brendshme ka bërë dhe po bën në strukturat e Policisë si mbyllja e zyrave Antitrafik në çdo Drejtori Policie Qarku, mbyllja e qendrës Kombëtare Antitrafik, riorganizimi i Policisë Kufitare, largimi i të gjithë specialistëve Antitrafik etj, ka sjellë që fenomeni i trafikimit njerëzor të mos trajtohet si problem kryesor dhe shqetësues, por si një fenomen që ka ardhur drejt zhdukjes. Është e vërtetë që trafikimi njerëzor krahasuar me vite më parë ka pësuar rënie, por gjithsesi mbështetur në të dhënat që vetë Ministria e Brendshme dha (122 viktima të trafikuar) në një takim me OJF-të, në muajin Nëntor 2007, flet qartë se ky fenomen jo vetëm ekziston, por ai vazhdon të zhvillohet normalisht veçanërisht në pikat kufitare tokësore që lidhin Shqipërinë me Greqinë, Maqedoninë dhe Kosovën.

Është fakt që çdo ditë në median e shkruar dhe atë vizive, jepen të dhëna për grupe njerëzish, të cilët

kapen nga Policia jonë, apo kthehen nga Policinë e shteteve të tjera, Greqia, Maqedonia, Kosova, Sllovenia, Kroacia; shtete këto që shërbejnë si pika hyrëse ose dalje të trafikimit njerëzor; tregon se ky fenomen këtë vit është ringjallur përsëri, për shkak të nivelit të ulët të jetesës si rezultat i papunësisë dhe varfërisë së madhe që ekziston në vendin tonë. Argumenti i asaj që thamë më sipër mbështetet gjithashtu në numrin e lartë të grave dhe vajzave të trafikuar, të cilat janë akomoduar në strehëzën tonë gjatë vitit 2007.

Gjatë këtij viti janë akomoduar në strehëz:

- o **44** gra dhe vajza të trafikuar të shfrytëzuara jashtë kufijve të Shqipërisë
- o **21** vajza të rrezikuara dhe të shfrytëzuara në vend
- o **26** gra dhe vajza klandestine

Siç shihet dhe nga shifrat e dhëna më lartë, duke pasur parasysh që Vatra gjatë këtij viti ka pasur vështirësi bashkëpunimi me disa Drejtori Policie Qarqesh (Vlorë, Gjirokastrë) të cilat nuk kanë referuar tek Vatra viktimat të trafikuar, gjë që ka ndikuar në një ulje fiktive të numrit të viktimave të referuara nga këto drejtore; sigurisht që do të kishim patur një tjetër pasqyrë të këtij fenomeni. Gjithsesi edhe shifrat e prezantuar deri tani, janë vetëm të dhënat e marra nga Vatra, të cilat japin një tablo të qartë të fenomenit që vazhdon të zhvillohet normalisht, në të dy kahet e tij.

Pra, nëse do të gruponim vajzat e trafikuar, të rrezikuara dhe ato klandestine, të kapura nga Policia jonë dhe Policinë e shteteve të KE-së, pra **89** gra dhe vajza konstatohet se rrjetet e trafikimit njerëzor funksionojnë në të dy anët e kufirit, duke vënë kështu në lëvizje të gjithë elementet përbërës të tij.

Shteti dhe qeveria e anashkalojnë këtë dukuri, edhe pse çdo ditë vetë Ministria e Brendshme raporton për trafikantë, sekserë apo shoqërues të kapur në kufijtë shqiptarë, të cilët organizojnë grupe njerëzish për të kaluar klandestinë në Greqi, Maqedoni etj

Një fenomen tjetër mjaft i rrezikshëm dhe që ka marrë zhvillim vitet e fundit në Shqipëri, është dhe trafikimi i brendshëm.

Trafikimi i brendshëm është një fenomen që shumë pak është analizuar apo trajtuar deri më sot. Si nga OJF-të dhe aq më pak nga shteti nuk ka një studim të mirëfilltë mbi numrin e grave dhe vajzave të përfshira në këtë fenomen, si zhvillohet, elementet përbërës, shkallën e shtrirjes, problemet që gjeneron etj. Trafikimi i brendshëm nga ana jonë është identifikuar me shfrytëzimin e grave dhe vajzave në prostitucion ditor. Dihet që prostitucioni në Shqipëri është i dënueshëm me ligj dhe pikërisht për këtë ai zhvillohet në mënyrë të fshehtë dhe shumë i mbrojtur. Edhe pse herë pas here në shtyp jepen të dhëna mbi aksionet që ndërmer Policia në disa Hotele dhe Motele të qyteteve të mëdha, kapen trafikantë, viktima apo klientë, prapë se prapë goditja e këtij fenomeni nuk është e fortë dhe shkatërrimtare, kjo për faktin se vetë këto aksione janë sporadike dhe jo të orientuara nga një plan veprimi strategjik. Nga analiza që i kemi bërë këtij fenomeni, është evidentuar fakti se numri i viktimave të këtij trafiku po vjen në rritje.

Gjatë intervistimit të viktimave të akomoduar në strehëzën Vatra, **44** vajza të trafikuar dhe të shfrytëzuara jashtë kufijve të Shqipërisë kanë pohuar se **20** prej tyre janë shfrytëzuar edhe në vend. Në qoftë se kësaj shifre do t'i shtonim edhe **21** gratë dhe vajzat e rrezikuara dhe të shfrytëzuara në vend, shohim se raporti i trafikimit të jashtëm me atë të brendshëm është i barabartë. Duke patur parasysh faktin që trafiku i brendshëm zhvillohet në mënyrë të fshehtë dhe nuk goditet sa e si duhet nga Policia, ky numër edhe pse i reduktuar në shifra, paraqet shqetësim për zhvillimin e tij. Mospranimi nga ana e qeverisë dhe mosmarrja e masave apo hartimit të një plani veprimi për ta goditur fenomenin, ka bërë që trafikantët jo vetëm ta zhvillojnë atë dhe të nxjerrin të ardhura të larta, por të rrisin në mënyrë të frikshme numrin e grave të cilat pranojnë të shfrytëzohen në prostitucion ditor. Për shkak të varfërisë së madhe gra dhe vajza të ardhura nga zonat rurale afër qyteteve të mëdha për të nxjerrë të ardhura me qëllim mbajtjen e familjes, gjenden sot rrugëve të këtyre qyteteve. Sekserë apo protektorë të ndryshëm i rekrutojnë ato duke përfutur nga situata e vështirë e tyre, kërkojnë dhe ju sigurojnë klientë, në shkëmbim të ndarjes së të ardhurave të fituara.

Nga analiza që i kemi bërë këtij fenomeni, viktimat e përfshira në trafikun e brendshëm do ti ndanim në katër lloje grupesh:

- Gra dhe vajza të trafikuar të riadhetësuar nga shtetet e KE-së
- Gra dhe vajza të martuara, të divorcuara ose me shumë fëmijë dhe

shumë të varfra, të cilat vijnë nga zonat rurale

- Vajza minorene të moshave 14 – 18 vjeç
- Studente konviktore të ardhura nga rrethe të tjera ose nga zonat rurale

Një dukuri tjetër që po vërehet këtë vit është dhe përfshirja e grave të dhunuara në rrjetet e trafikimit të brendshëm. Ky fenomen ka tërhequr vëmendjen tonë, për shak të të dhënave që janë grumbulluar nga stafi gjatë intervistimit të bërë me gratë e dhunuara të trajtuara nga ne, jashtë dhe brenda strehëzës. Edhe pse shifrat nuk janë të larta, për faktin se me këtë target grup nuk ka institucione të mirëfillta që të merren me të, është e rëndësishme të trajtohet si dukuri dhe të analizohet, me qëllim marrjen e masave për ta parandaluar.

Krimi në familje është prezent sot në shumë familje shqiptare, veçanërisht kjo e theksuar në zonat rurale. Shumë gra nga këto zona për shkak të dhunës që pësojnë nga bashkëshortët ose familjarët e tjerë, largohen nga shtëpitë dhe shpesh rrezikohen duke u përfshirë në rrjetet e trafikut njerëzor. Një numër gjithnjë në rritje asistohet nga Qendra jonë, ku një pjesë e tyre është akomoduar në strehëz apo referuar në strehëza të tjera.

Sensibilizimi i institucioneve shtetërore i shoqërisë civile dhe komunitetit në tërësi, për rrezikun që paraqet përshkallëzimi i dhunës në familje, merr një rëndësi të veçantë në këtë situatë, me qëllim goditjen që në hapat e para të çdo fenomeni negativ që gjenerohet nga dhuna në tërësi.

Nisur nga çka kemi analizuar më lartë, mendojmë që,

Shqipëria prezantohet aktualisht me këto forma të trafikimit njerëzor:

1. Trafikimi i grave dhe vajzave dhe shfrytëzimi i tyre jashtë kufijve të Shqipërisë.
2. Trafikimi i brendshëm

Nga sa analizuam më lartë, fenomeni i trafikimit të brendshëm nga mënyra se si ai po zhvillohet, si dhe nga mungesa e goditjes së shtetit, bënë që Shqipëria tashmë të konsiderohet edhe vend i destinacionit të këtij fenomeni.

III. STUDIME HISTORIKE DHE TË KRAHASUARA

PROF. DR. ANA LALAJ

(Akademia e Shkencave)

NDARJE TË TRISHTUARA

(Mbi martesat e shqiptarëve me të huajt në vitet e sistemit monist)

Kur flasim për familjen në gati 50 vitet e sistemit të kaluar në Shqipëri, kjo nuk mund të shihet e ndarë nga vetë ndërtimi e funksionimi i shoqërisë shqiptare në tërësi. Orientimi komunist që në krye të herës i shtetit dhe i kësaj shoqërie, në një farë mënyre kishte paracaktuar edhe orientimin e familjes. Një shoqëri e vënë nën kontroll nga partia-shtet do të thoshte se e tillë do të ishte, pra nën kontroll, edhe qeliza e saj, familja e deri individit. Ky ishte orientimi i përgjithshëm dhe në shërbim të tij janë ligjet, organizatat politike e shoqërore, gjithë sistemi i propagandës etj. Këtij radikalizmi i nënshtrohej jeta private e individit, sipas tij formatoheshin marrëdhëniet në çift, jeta intime, lidhjet martesore, përkatësia klasore në këto lidhje, divorcet etj. Këto tashmë janë të njohura, ndonëse jo të studiuara ende në mënyrë shteruese. Pjesë e kësaj dukurie ishin edhe marrëdhëniet e mundimshme në çift që u krijuan në periudhën që flasim midis shtetasve shqiptarë dhe shtetas të

huaj, kryesisht nga vendet e ish-bllokut komunist. Kjo çështje mendoj se do parë edhe në kuadër të legjislacionit të kohës, por edhe në kuadër të orientimeve politike dhe të praktikave ekstraligjore të strukturave partiake e shtetërore. Kjo e dyta nuk është më pak e rëndësishme, pasi shfaqet me shumë peshë në shoqëritë totalitare komuniste.

Për sa i përket legjislacionit për martesat me të huajt, do thënë se ai përgjithësisht ishte i ndërtuar në përshtatje me ligjet e vendeve të tjera komuniste. Si hapësirat ashtu dhe kufizimet janë të krahasueshme nga një vend në tjetrin. Ndërsa praktikat zbatuese kanë variuar në varësi të politikave që ka ndërtuar secili nga shtetet veçmas. Në këtë pikëpamje, praktikat e ndjekura nga organet e shtetit shqiptar meritojnë studim. Për të krijuar inteligjencën e re mbështetëse, qeveria komuniste çoi mjaft djem dhe vajza shqiptare në Bashkimit Sovjetik dhe në vendet e tjera të “kampit” për studime universitare. Djemve shqiptarë, që në pjesën më të madhe vinin nga lufta apo nga fshati, u jepeshin porosi standarde në komitetet e partisë dhe në Ministrinë e Arsimit se detyra e tyre ishte “mësimi dhe vetëm mësimi, se ata duhet të përgatiten si kuadro të aftë që t’i shërbejnë sa më mirë popullit e partisë”. Por për rrethana të kup-tueshme dhe krejt të natyrshme, u krijuan edhe marrëdhënie dashurie midis studentëve, mjaft prej të cilave ishin të qëndrueshme dhe shkonin drejt nevojës për lidhje martesore, duke u kthyer kështu në një preokupim për zgjidhje.

Fillimisht legjislacioni shqiptar e lejonte martesën e studentëve shqiptarë jashtë shtetit me shtetase të huaja duke marrë autorizim nga Ministria e Punëve të Jashtme* e RP Shqipërisë ose nga përfaqësuesi diplomatik shqiptar në shtetin në fjalë³². Në formë, ky ligj nuk ndryshonte shumë nga ai i paraluftës. Por në realitet as ambasadat shqiptare dhe as MPJ nuk jepnin leje për lidhjen e martesës. Shqetësimi i tyre qëndronte në faktin se “studenti mund të lidhë martesë me një shtetase të huaj që nuk ka konditat e duhura dhe hyrja e saj në Shqipëri si bashkëshorte e studentit shqiptar do të jetë e padëshirueshme”³³. Prandaj sapo mbërritën kërkesat e para në MPJ, kjo e fundit i kërkonte Ministrisë së Drejtësisë

32 Ligji mbi Martesën Nr. 601, dt. 18.V.1948, neni 23: “... Nëpunësit shqiptarë dhe studentët shqiptarë nuk mund të lidhin martesë jashtë shtetit me një shtetas të huaj pa autorizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme ose të përfaqësuesit diplomatik shqiptar jashtë shtetit.” *Ministria e Jashtme e Shqipërisë-më tej: MPJ. 33 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ). V. 1948, D. 266. Shkresë e MPJ e dt. 22 shkurt 1949.

amendimin e ligjit të Martesës, ku të caktoheshin edhe sanksionet kundra atyre që martoheshin pa marrë autorizimin e MPJ. Por përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ishte e dyzuar. Nga një anë ajo pranonte se neni 39 i Ligjit nuk lejonte anulimin e martesës edhe kur studenti nuk merrte autorizim nga MPJ³⁴ dhe, nga ana tjetër, në kundërshtim me ligjin, sugjeronte se “ndaj zyrtarit shqiptar që kishte celebruar martesën dhe ndaj studentit ose nëpunësit mund të merreshin masa administrative... tue ia prerë bursën dhe, kundra bashkëshortit të huaj tue ia ndalue hyrjen në Shqipëri... pasi rezulton person i padëshirueshëm”³⁵.

Megjithatë kishte dhe raste të rralla kur lejoheshin martesat me vajza të huaja. Kjo ndodhte kur studenti apo oficeri shqiptar jashtë shtetit i bënte disa herë kërkesë KQ PPSH dhe ky i fundit pas verifikimeve nga Ministria e Brendshme dhe ambasada shqiptare në shtetin përkatës, i drejtohej organeve shtetërore të atij vendi, duke i parashtruar të gjitha rastet që ai i gjente të arsyeshme. Fillimisht këto hapa u ndërmorën për oficerët e rinj shqiptarë që kishin shkuar për studime ose kualifikime në Moskë. Vit pas viti, numri i tyre u shtua dhe në një listë që KQ PPSH ia paraqiste KQ PKBS në prill 1950, radhiteshin 24 syresh³⁶.

Duke përdorur në këto raste vetëm kanalet partiake, legjislacioni i kohës nuk zbatohej fare. Si për të sanksionuar këtë realitet, në v. 1952 Presidiumi Kuvendit Popullor miratoi një dekret që ndalonte martesën e një shqiptari me një nënshtetase të huaj dhe anasjelltas³⁷. Ky qëndrim kategorik ndikoi negativisht sidomos tek emigrantët shqiptarë para 29 nëntorit 1944, të cilët, të ndodhur përpara dilemës ose të mos

34 Ligji mbi Martesën Nr. 601, dt. 18.V.1948, neni 39: “Martesa mund të anulohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligja”.

35 AMPJ. V. 1949, D. 266. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë e dt. 3 mars 1949.

36 Arkivi Qendror Partisë Punës Shqipërisë (më tej: AQPPSH). V. 1950, D. 30. Në letërën e KQ dërguar KQ PKBS midis të tjerash shkruhej: “Komiteti Qendror i PPSH duke marrë parasysh nga njëra anë dëshirën e madhe që ata kanë treguar në mënyrë të përsëritur për t’u martuar me qytetaret sovjetike dhe nga ana tjetër besnikërinë dhe dashurinë që ata kanë për Partinë e Punës së Shqipërisë dhe atdheun e tyre dhe për Partinë bolshevike, për Bashkimin Sovjetik e Stalinin e Madh, ia parashtron këtë çështje KQ PKBS me lutje që ta marrë në shqyrtim dhe t’i japë një zgjidhje të favorshme”.
37 Dekreti Nr. 1558, dt. 17 tetor 1952, neni 1: “Asnjë qytetar shqiptar nuk mund të lidhë martesë me qytetarë të huaj qoftë në Shqipëri qoftë jashtë Shqipërisë”.

martoheshin kurrë, ose të martoheshin vetëm me nënshtetase shqiptare, u detyruan të braktisnin nënshtetësinë e vet shqiptare. Mbeten për t'u vlerësuar arsyet e këtij kthimi prapa, së paku në pikëpamje formale të ligjit. Ndoshta se edhe vetë BS në legjislacionin e deriatëhershëm të tij e kishte të ndaluar martesën e qytetarëve sovjetikë me të huaj. Por siç del nga disa shpjegime të mëvonshme arsyetuese, duket se “në radhë të parë ishin arsye të sigurimit të shtetit.... Nëpërmjet studentëve që mar-tohen jashtë shtetit depërtojnë armiq në vendin tonë”³⁸. Është koha kur operacioni Rollback i Perëndimit për të përmbysur sistemin komunist në Shqipëri me anën e organizimit të emigracionit shqiptar jashtë ishte në kulmin e tij. Është interesante të vërehet se shkalla e rrezikut konsiderohej e ndryshme jo vetëm ndërmjet martesave që celebrheshin në Perëndim dhe atyre në Lindje, por edhe për martesat brenda vetë vendeve të Lindjes. Kështu rreziku vlerësohej “minimal” për martesat me vajzat e BS, kurse me vajzat nga Hungaria, Çekosllovakia dhe Polonia, rreziku konsiderohej “real ... dhe duhej një kontroll rigoroz”³⁹. Sipas udhëheqjes komuniste shqiptare, në këto vende ku qeveritë sapo kishin braktisur format organizative të koalicionit, mbeturinat e sistemit të vjetër borgjez ende ishin të fuqishme dhe brezi i ri ende nuk ishte çliruar plotësisht prej tyre.

Megjithatë, përballë kërkesave të shumta të emigrantëve në Perëndim dhe ndoshta edhe nga frika e ndonjë akuze ndërkombëtare për dhunim të të drejtave të njeriut, autoritetet shqiptare u lëkundën. Një vit më vonë, më 15 tetor 1953, një dekret i posaçëm e lejoi martesën vetëm për shqiptarët e kolonive, dmth shqiptarët që kishin emigruar për punë në vendet e huaja⁴⁰. Ky dekret nxiti studentët shqiptarë jashtë vendit të shtonin dhe ata trysninë e tyre. Në këto rrethana, Ministri i Drejtësisë Bilbil Klosi, do të sugjeronte një qëndrim ndryshe ndaj problemit në fjalë. Më 5 prill 1954, ai i shkruante KQ PPSH: “Avantazhet që do të kishim, po të lejonim martesën me leje të Presidiumit të Kuvendit Popullor janë:

38 AQPPSh. V 1954, D 16.

39 Ibid.

40 Dekreti Nr. 1746, dt. 15 tetor 1953, neni 1: “Asnjë qytetar shqiptar nuk mund të lidhi martesë me qytetarë të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, me përjashtim të qytetarëve shqiptarë që kanë emigruar në punë në vende të huaja”.

a.- nuk do të bënim përjashtim nga vendet e kampit tonë në legjislacionin e martesës.

b.- do të na vinin edhe specialiste, se zakonisht studentët martohen me studente”⁴¹. Madje, ai kishte përgatitur edhe një projekt-dekret në të cilin i rekomandohej Presidiumit të Kuvendit Popullor të lejoheshin martesat e nënshtetasve shqiptarë me të huaj, që ai të ishte më dorëlëshuar në lidhjen e martesave të nënshtetasve shqiptarë me nënshtetas sovjetikë, ndërsa me nënshtetas të demokracive popullore të lejohej martesa vetëm në raste të jashtëzakonshme. Martesa e nënshtetasve shqiptarë me nënshtetas të vendeve kapitaliste të ishte krejtësisht e ndaluar. Përpara se të vendoste për një martesë të këtij lloji, Presidiumit të Kuvendit Popullor i rekomandohej të merrte mendimin e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁴². Me sa duket, në atmosferën e “shkrirjes së akujve” që kishte filluar në bllokun komunist pas vdekjes së Stalinit, era e ndryshimeve kishte arritur edhe në Shqipëri. Ky propozim u bë thelbi i Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, i shpallur një muaj më vonë, në 5 korrik 1954, për martesat me nënshtetasit e huaj⁴³. Shqipëria po ndiqte kështu shembullin e BS, i cili një vit më parë me një dekret të Presidiumit të Sovjetit Suprem kishte lejuar martesat e qytetarëve sovjetikë me nënshtetas të huaj. Në këtë mënyrë qeveria shqiptare shmangte edhe situatën e faktit të kryer, kur disa studentë shqiptarë, pa marrë miratim nga organet përkatëse në Shqipëri ishin martuar me vajzat ruse, që ishin të lira për këtë veprim nga shteti i tyre. Në vitin 1956, këtij dekreti do t’i bëheshin përsëri disa rregullime⁴⁴. Pavarësisht nga ndryshimet pozitive që po ndodhnin në legjislacionin shqiptar lidhur me martesat me nënshtetasit e huaj, partia-shtet në Shqipëri edhe në këtë fushë po reflektonte me vështirësi dhe plot dyshime.

41 AQPPSh. V. 1954, D. 16.

42 Ibid.

43 Dekreti Nr. 1897, dt. 5.7.1954, neni 1: “Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të lidhë martesë me shtetas të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, pa marrë më parë autorizimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore së Shqipërisë. Shtetasit shqiptarë që kanë emigruar me punë në vendet e huaja lejohen të lidhin martesë me shtetasit e huaj”.

44 Dekreti Nr. 2228, dt. 5.3.1956, neni 1: “Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të lidhë martesë me një shtetas të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, pa marrë më parë autorizimin e MPJ kur të dy ose njeri prej personave që do të lidhin martesë banojnë jashtë shtetit dhe nga MPB kur të dy personat e sipërm banojnë në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë që kanë emigruar me punë në vendet e huaja lejohen të lidhin martesë me shtetasit e huaj”.

PPSh nuk e kishte pranuar plotësisht kthesën e Kongresit XX të PKBS për destalinizimin. Hapat që ajo kishte ndërmarrë ishin vetëm disa retushime të pjesshme dhe jothelbësore në vijën e saj të mëparshme politike. Po kështu, megjithëse në legjislacionin shqiptar u bënë një varg amendimesh që lejonin celebrimin e martesës të oficerëve ose studentëve shqiptarë që dëshironin të martoheshin me vajza të huaja, atyre vazhdohej t'u bëhej presion i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga eprorët që të mos këmbëngulnin për t'i sjellë gratë e reja në Shqipëri. Ambasadat apo legatat shqiptare vazhdonin të mos u jepnin leje qytetarëve shqiptarë për t'u martuar me shtetas të huaj, në përputhje me udhëzimet e marra⁴⁵. Megjithëse këto martesë ishin ekskluzivisht me vajza nga vendet e bllokut komunist dhe këto vende i kishin hequr kufizimet për martesat me të huajt, fakt është se në Shqipëri, deri atëherë vetëm KQ PPSH ishte de facto autoriteti që mund të lejonte martesat e kësaj natyre⁴⁶. Të brumosur me një psikologji sekreti, që impononte në çdo moment kompleksin e frikës dhe të mbylljes, udhëheqësit shqiptarë druanin se mos fenomeni i martesave me vajzat e huaja përhapej në shkallë të gjerë. E. Hoxha shprehej në një mbledhje të Byrosë Politike se “jo vetëm që kemi ligje, por edhe parimisht nuk është e drejtë të mos lejojmë martesën me të huajt. Por me gjithë këtë ne nuk duhet ta lëmë fare të lirë, por ta frenojmë”⁴⁷.

Sidoqoftë, në vitin 1959 pati një kthesë në procedurat praktike që miratonin martesat me nënshtetas të huaj. Në prill të atij viti Byroja Politike e KQ PKSh me një vendim të posaçëm lejoi që “studentët dhe kursantët civilë e ushtarakë që ishin dërguar nga partia e qeveria për studime jashtë shtetit, të ndiqnin procedurat standarde ligjore vetëm nëpërmjet MPJ të RP Shqipërisë dhe ambasadës shqiptare në shtetin ku ata studionin”. Ndër kushtet që duhet të plotësonin studentët shqiptarë, para se të martoheshin me vajza të huaja, më i rëndësishmi ishte kriteri politik. Vendimi i Byrosë Politike theksonte se “nuk do të lejoheshin martesë

45 AQPPSh. V. 1959, D. 11.

46 AQPPSh. V. 1959, D. 11. Madje jo rrallë herë edhe vetë vajzat ruse, polake, hungareze etj. kur shihnin se problemi i martesës së tyre nuk po zgjidhej, i drejtoheshin drejtpërdrejt KQ PPSH. Kështu në një letër të një studenteje sovjetike dërguar E. Hoxhës në v. 1959 shkruhej: “Jam vajzë e popullit sovjetik. Kam rënë në dashuri dhe rroj me një toger shqiptar, se ai është djalë i mirë, se e dua atë me gjithë shpirt dhe se pa atë jeta ime nuk ka kuptim. Unë e di se ligji juaj nuk lejon martesat me të huajt, unë e di se ai është anëtar partie dhe se ajo do ta dërgojë nesër atje ku të jetë nevoja. Për sa i përket konditave tua, ato i kam marrë parasysh. Por, shkruan ajo më në fund, tregohuni pak humanitar....”.

47 Ibid.

me vajza që mbajnë qëndrim të keq politik ose rrjedhin nga familje reaksionare”⁴⁸. Pas kësaj, kërkesat e studentëve shqiptarë vërsuan dhe 213 prej tyre arritën të martohen me vajza nga BS, Polonia, Hungaria, Bullgaria, Çekosllovakia, Rumania dhe t’i tërheqin ato në Shqipëri. Por në vitin 1961 kësaj pranvere të shkurtër i erdhi fundi dhe 65 studentëve të tjerë shqiptarë nuk iu miratua kërkesa për martesë⁴⁹.

Acarimi i marrëdhënieve ideologjike e politike me Bashkimin Sovjetik çoi në gjendje alarmi dhe lufte e shpallur nga partia-shtet, e cila iu imponua gjithë strukturave të shoqërisë shqiptare, madje deri në qelizën e saj, familjen. Në këtë situatë, ato që u ndjenë më të sfiduara ishin familjet e ish studentëve shqiptarë, tani personalitete ushtarake, shkencore dhe kulturore të martuar me gra të huaja. Politika ndërhyri dhunshëm në jetën e tyre private. Në një mbledhje të Byrosë Politike, kur sapo ishte marrë njoftimi i ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet BRSS dhe RP të Shqipërisë, E Hoxha shprehej: “Është edhe çështja e grave sovjetike që janë martuar me njerëzit tanë. Shqiptarëve të cilët kanë marrë gra sovjetike u duhet thënë që ato do të venë në BS, sepse këtu po zhvillojnë punë armiqësore në dëm të atdheut dhe se do të vihen në survejim, ose të marrin nënshtetësinë shqiptare. Kur të rregullohen marrëdhëniet tona me BS, atëherë mund të shikohet edhe çështja e tyre.”⁵⁰ Paskëtaj ndaj grave sovjetike, e më vonë atyre polake, hungareze, çekoslloake, rumune, gjermanolindore, bashkëshortëve të tyre shqiptarë dhe gjithë familjeve të tyre filluan përndjekjet, provokimet, akuzat, shantazhet deri te kalvari i dhimbshëm i ndarjes. Të ngritura mbi ndjenjën e një dashurie të pastër, një pjesë e tyre i rezistuan furtunës politike, ndërsa shumica u shpërbë, duke lënë pas lot dhe kujtime. Sipas një raporti të Ministrisë së Punëve të Brendshme, deri në nëntor 1963 ishin larguar në shtetin e tyre përgjithmonë 66 gra të huaja. Nuk mund të përjashtohet që në shkatërrimin e këtyre familjeve kishin ndikuar edhe motive të tjera të qëndrimit moral apo të mospërshtatjes me kushtet e vështira të jetesës në Shqipëri, kishte ndikuar edhe ambicia e ndonjë bashkëshorti shqiptar me pozitë në parti e në pushtet për të bërë karrierë, por gjithnjë faktori determinues mbetej ai politik.

Është e vërtetë se edhe për disa muaj pas ndarjes ndërmjet bashkëshort-

48 Ibid. V. 1959, D. 11. Vendim i Byrosë Politike të KQ PPSH. Nr. 129, dt. 2.4.1959.

49 Ministria e Punëve të Brendshme (më tej: MPB), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, D. 172.

50 AQPPSH. V. 1961, D. 47.

ëve u mbajt një korrespondencë me letra ose me telefona, korrespondencë e cila ishte gjithnjë eurveuar dhe e keqinterpretuar nga organet e Sigurimit. Politika shkoi deri atje sa edhe një bisedë telefonike ndërmjet prindit shqiptar dhe fëmijës së tij të larguar me t'ëmën në atdheun e kësaj të fundit konsiderohej si provokim. Konkluzioni që nxirrnin organet e Sigurimit të shtetit për këtë letërkëmbim njerëzor ishte se: "Përpjekjet për të mbajtur lidhje me çdo kusht të lenë dyshime për spiunazh dhe tregojnë se këta qëndrojnë në pozita armiqësore karshi vijës së partisë sonë"⁵¹. Mbi këto hamendësime u ngrit një sistem i tërë përndjekjesh ndaj bashkëshortëve shqiptarë të mbetur në Shqipëri, duke i konsideruar ata "një bazë (të BS dhe vendeve të bllokut komunist-A.L.) për të dëmtuar interesat e partisë dhe popullit tonë"⁵². Për rrjedhojë ata u vunë nën një regjim të rreptë përgjimi, kontrolloheshin se me kë i kalonin festat familjare, shoqërore dhe kolektive, çfarë bisedonin, sa herë shkonin në ambasadën e shtetit të huaj ku kishin studiuar etj. Konsiderohej negativ fakti që deri në v. 1963, vetëm 7 prej tyre ishin rimartuar me vajza shqiptare, ndërsa arratisja e 5 prej tyre për t'u ribashkuar me gratë e larguara dhe fëmijët e tyre quhej "tradhti ndaj atdheut".

Përndjekjet ishin akoma më të vrazhda ndaj grave të huaja që qëndruan në Shqipëri. Për të shpëtuar familjen, bashkëshortet e huaja hoqën dorë nga nënshtetësia e vet dhe morën nënshtetësinë shqiptare, si "shenjë besnikërie" ndaj partisë-shtet në Shqipëri. Kështu në muajt e parë të vitit 1962, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RP Shqipërisë me vendime të posaçme u dha nënshtetësinë shqiptare shumë grave sovjetike, bullgare e hungareze⁵³. Vizitat në ambasadat dhe letërkëmbimi me familjarët në vendlindje konsiderohej herezi dhe me kalimin e viteve këto lidhje u ndërpre. Një pjesë e këtyre grave vazhdoi të punojë në institucionet shqiptare duke iu nënshtruar regjimit komunist në vend. Disa të tjera megjithëse kishin mbaruar shkollat e larta u kthyen në shtëpiake, për të reduktuar kontaktet me njerëzit e për rrjedhojë dhe mundësinë e akuzave kundër tyre për spiunazh. Ndërsa pati dhe nga ato që vazhduan të jetojnë në Shqipëri, edhe kur burrat e tyre u burgosën për "spiunazh"

51 Ibid.

52 Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, D. 172.

53 Shih: Gazeta Zyrtare të RP Shqipërisë. V. 1962, Nr. 1, 2, 3, 4.

apo u internuan⁵⁴.

Ky makth 30 vjeçar përfundoi vetëm pas ndryshimeve demokratike në fillim të viteve '90, atëherë kur burrat dhe baballarët e zbardhur trokitën në portat e familjeve të reja të ish bashkëshorteve të dikurshme dhe fëmijëve të tyre. Por asgjë nuk mund të kthehej pas, përveçse kujtimeve.

54 Ndër gratë e huaja që kishin qëndruar në Shqipëri deri në vitin 1963, 8 ishin arsimtare, 12 nëpunëse, 14 inxhinierë, 2 zooteknike, 13 mjeke, 8 laborante, 1 farmacistë, 1 juriste, 3 rrobaqepëse, 4 artiste, 2 agronome, 1 hidraulike, dhe 58 shtëpiake. Ndër to kishin marrë nënshtetësinë shqiptare 32 gra.

ERINDA BLLACA

(master in Law)

**MBROJTJA LIGJORE PËR
SHTRESAT NË NEVOJË**

(Vështrim i krahasuar)

Mbrojtja ligjore përmbledh koncepte të ndryshme të praktikave juridike botërore: së pari përcaktohet si një ndihmë e kualifikuar për personat që nuk kanë mundësi të caktojnë përfaqësuesin e tyre ligjor (avokatin) dhe përjashtimin e tyre nga taksat gjyqësore, së dyti, si një sistem kompleks dhe grupim organizatash joqeveritare dhe agjencish të njohura me emërtimin “organizata të ligjit në të mirë publike”, dhe së treti, si një doktrinë e zhvilluar, sidomos pas viteve ’70 në ShBA, dhe e zhvilluar në një sërë vendesh në mbarë botën.

Në Shqipëri koncepti i mbrojtjes ligjore garantohet për çështjet penale, duke lënë evazive dhe të pambuluara çështjet civile apo administrative për personat “në nevojë”, edhe pse rastet e shkeljeve të të drejtave themelore janë të shumta. Sipas nenit 31 të Kushtetutës, (paragrafi 1, germa

d) thuhet se gjatë çështjeve penale kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme”.

Miratimi i ligjit të ri kundër dhunës në marrëdhëniet familjare⁵⁵ ishte një hap pozitiv, jo vetëm lidhur me objektin kryesor të rregullimit, por edhe pse i hapi rrugë një përvoje, që aktualisht ekziston në shumë vende të botës, ndihmës juridike falas për personat e dhunuar, për pjesëtarët e familjeve, të cilët bien viktimë të dhunës, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve. Megjithatë, çështja e zgjerimit të mundësive për mbrojtjen ligjore falas për shtresat në nevojë, si dhe realizimi i kësaj mbrojtje me efikasitet e cilësi, mbeten ende sfida për legjislacionin shqiptar.

1. Mbrojtja ligjore dhe kushtet e përfitimit të saj sipas praktikave botërore

Sikurse u citua më lart, në shumë vende të Evropës Lindore dhe Qendrore, kushtetutat e reja kanë njohur të drejtën e përfaqësimit ligjor të individit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative. Por këto dispozita detyrojnë autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese të përfaqësimit ligjor, sesa përcaktojnë detyrimin për të siguruar përfaqësim ligjor për personat në nevojë, kur është e domosdoshme.

Përcaktimi i mbrojtjes ligjore në çështjet civile në pothuaj të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore rregullohet nga ligjet apo rregulloret specifike të dhomave të avokatëve në çdo shtet. Përgjithësisht, individëve që nuk kanë mundësi për të paguar një avokat, u caktohet një i tillë nga listat e depozituara në dhomat e avokatisë mbi bazë vullnetare. Por kuadri ligjor nuk përcakton shprehimisht kërkesat dhe procedurat për caktimin e avokatit (përfaqësuesit ligjor) dhe si rezultat procedurat keqinterpretohen dhe anashkalohen. Për më tej, buxheti i dhomave të avokatisë nuk përcakton fonde të veçanta për shpërblimin e avokatëve për punët e bëra në mënyrë vullnetare. Përderisa këto lloj shkeljesh procedurale nuk konsiderohen zyrtare si p.sh., në rrëzimin e një vendimi të formës së prerë, këto ligje ose rregullore kanë më pak influencë se

⁵⁵ Ligj Nr. 9669, dt. 13.12.06, “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”.

sa vetë kodet e procedurave penale dhe civile. Në këtë mënyrë, edhe

cilësia juridike e këtyre procedurave në dhënien e ndihmës ligjore falas, lë shume për të dëshiruar. Një qëndrim tjetër pro mbrojtjes ligjore në çështjet civile është shmangia e individëve në nevojë nga taksat gjyqësore për disa kategori të caktuara çështjesh si p. sh., ndihma sociale për fëmijët e mitur, gjyqet me konflikt pune, dhe çështjet që kanë të bëjnë me çështje të familjes. Vendimmarrja përfundimtare për taksat gjyqësore në këtë rast i lihet gjykatave.

Bullgaria⁵⁶

Në Bullgari, ligji i ri për mbrojtjen ligjore u miratua në tetor 2005. Ky ligj ka si qëllim të promovojë drejtësi në procesin gjyqësor, të garantojë standarde të larta në ofrimin e ndihmës ligjore falas, dhe të mundësojë vënien në dispozicion të një përfaqësuesi ligjor pa efekte financiare.

Ky ligj aplikohet për të gjitha kategoritë e çështjeve civile dhe administrative. Ky ligj ka ngritur standardet e përfaqësimit dhe të ndihmës ligjore në Bullgari. Ngritja e një Byroje Kombëtare për Ndhimën Ligjore do të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin e strategjive dhe do të shërbejë si vlerësuese për punën e përfaqësuesve ligjore. Kjo Byro, sipas ligjit, është përcaktuar si autoritet publik i pavarur.

Hartimi i një ligji të tillë, edhe pse i iniciuar në formën specifike për dhunën ndaj familjes, mund të merret në konsideratë edhe për rastin e Shqipërisë: historitë e dy shteteve janë pothuajse të ngjashme, më shumë se katër dekada sistem unipartiak i formës sociale, regjime të ngurta, ekonomi të centralizuara, shoqëri të mbyllura dhe pavarësi të cenuar. Në të dyja shtetet, reforma ligjore dhe ajo në gjyqësor kanë qene pjesë e procesit të integritimit evropian. Ligji bullgar mbi ndihmën ligjore reflekton angazhimin e qeverisë, OJQ-ve dhe aktorëve të tjerë të influencës dhe është në përputhje të plotë me standardet evropiane.

Modeli bullgar në këtë rast është një përvojë e mirë për mënyrën e procedimit në lidhje me vendim marrësin.

56 Raporti i Forumit të Dytë European mbi të drejtën për mbrojtjen ligjore, gusht 2005, OSI http://www.soros.org/resources/articles_publications/publicationsaccessrep_20050809

Një formë tjetër që mund të përfshihet në praktikën shqiptare është ngritja e arsimimit ligjor dhe përfshirja e zhvillimit të klinikave ligjore pranë universiteteve ligjore. Përgatitja dhe angazhimi i juristëve të rinj në këtë proces për dhënien e ndihmës juridike për kategori të caktuara njerëzish në nevojë do të edukojë dhe do ta ngrejë këtë shërbim mbi baza më të gjera ligjore. Në Bullgari, klinikat ligjore firmosën Standardet Akademike për organizimin dhe veprimtaritë e klinikave ligjore me fakultetet juridike bullgare. Madje praktika bullgare ka vazhduar edhe më tej duke rekomanduar ndryshime ligjore në ligjin për arsimin.

Hungaria

Ligji i ri mbi mbrojtjen ligjore, miratuar më 2003, ose i ashtuquajturi ligji i “Avokatit të Popullit” përmirëson sistemin ligjor ekzistues në procedurat e gjyqit, sanksionon ndihmën ligjore në më shumë fusha, dhe reformon kuadrin institucional duke ngritur Shërbimin e Ndhmës Ligjore, nëpërmjet zyrave kombëtare dhe rajonale. Arritja më e madhe e këtij ligji është përcaktimi i mbrojtjes ligjore si një shërbim shtetëror që operon në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fushat ligjore.

Ligji adreson ndihmën juridike në tre fusha kryesore. Së pari, ai paraqet një sistem të ri të ndihmës ligjore të natyrës informative. Ky shërbim ofron informacion lidhur me procedurat që duhet të ndiqen, cilës agjenci duhet t’i drejtohesh, cilat janë hapat që duhen ndërmarrë deri në zgjidhjen e problemit etj. Së dyti, fusha e reformës përfshin rastet e konflikteve civile, dhe konsiston kryesisht në uljen e detyrimeve financiare ndaj gjykatës dhe garanton përfaqësim ligjor të paguar nga shteti. Së treti, ligji bën ndryshime në fushën penale duke reformuar elemente të ndryshme të sistemit të mëparshëm të përfaqësimit. Të dy reformat e mbrojtjes ligjore në fushën civile dhe penale kanë hyrë në fuqi në vitin 2006.

Sipas këtij ligji, ndihma ligjore në çështjet civile i ofrohet grupeve të pambrojtura të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj. Disa grupe të caktuara (si të pastrehët, apo azilkërkuesit) përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndihmë ligjore, të mbuluar financiarisht nga shteti (për atë kategori personash që kanë të ardhura mbi nivelin minimal të pensioneve por më të vogël se paga minimale).

Efektet e këtyre reformave do të ndikojnë drejtpërdrejtë në shtimin e

numrit të personave që përfitojnë ndihmë ligjore si dhe në mbulimin e një game më të gjerë çështjesh. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, qeveria hungareze ka ndërmarrë hapa konkretë për zbutjen e pabarazisë sociale në shoqëri. Këto reforma komentohen nga burimet qeveritare jo vetëm s një hap pozitiv për garantimin e të drejtave themelore por edhe si një përmirësim i imazhit të gjyqësorit dhe shërbimeve që ofrohen prej tij.

Ky model është një zgjidhje e mirë për ndihmën ligjore falas si për çështjet penale, civile dhe administrative, dhe përfshin të gjitha palët e interesuar në proces. Përfshirja e qeverisë shqiptare në përcaktimin e fondeve të veçanta në Buxhetin e shtetit si dhe zbatimi i një strategjie të qartë në përdorimin e fondeve publike, do të rriste numrin e individëve që do të përfitonin nga ndihma ligjore falas.

Lituania

Që prej vitit 1990 Lituania është angazhuar me procesin e përjasjes së legjislacionit, në kuadër të integritit evropian, për të arritur rezultate konkrete në përmirësimin e shërbimeve ligjore për personat në nevojë. Në vazhdim, janë një sërë hapash të ndërmarrë për këtë qëllim si p.sh., Ligji për Ndihmën ligjore (2000), i cili u përgatit për të përmbushur detyrimet e Kushtetutës së vitit 1992 dhe të gjitha dokumenteve të tjera të Këshillit të Evropës, nëpërmjet ngritjes së zyrave të mbrojtjes publike në qytete të ndryshme të vendit. Sidoqoftë, këto përpjekje provuan nevojën për vazhdimin e mëtejshëm të këtij procesi për përmirësimin e efektivitetit të shërbimeve, sidomos të cilësisë së ndihmës ligjore ex officio, e cila u konsiderua e ulët dhe e shoqëruar me mungesë burimesh njerëzore dhe financiare që shteti duhet të garantonte për dhënien e ndihmës ligjore.

Mungesa e fondeve nga ana e shtetit e vuri në pamundësi faktike në përmbushjen e detyrimeve për funksionimin normal të zyrave publike, dhe si rezultat e kufizoi ofrimin e ndihmës ligjore nëpërmjet projekteve private si, qendrat e mbrojtjes ligjore ose klinikat ligjore të ngritura dhe të mbështetura financiarisht nga fonde të huaja⁵⁷, ndërmjet të tjerash,

57 Open Society Fund-Lithuania, <http://www.osf.lt/eng/main.htm> 9. Koncepti për përmirësimin e ndihmës ligjore të garantuar nga shteti. Dokumenti i paraqitur në Grupin e Punës mbi projektin konceptin për përmirësimin e sistemit të ndihmës ligjore të garantuar nga shteti, përgatitur nga Ministria e Drejtësisë e Lituaniës, në 24 korrik, 2003, fq. 6.

përmendet puna e Universitetit të Drejtësisë, që hapi e para qendrën e parë të ndihmës ligjore në qytetin e Viliniusit, i ndjekur më pas nga Universiteti i Viliniusit i cili hapi klinikën ligjore e cila ofron këshillime, përgatitje dokumentacioni për përfaqësim. Në vazhdim, këto projekte janë konsideruar të rëndësishëm për faktin se kanë shërbyer si një shkollë e dytë për studentët e ligjit. Projekte të ngjashme janë zbatuar edhe nga kolegjet e avokatëve. Këto iniciativa kanë qenë të përhapura në shoqërinë civile dhe kanë bërë jehonë. Ato kanë shërbyer për të sensibilizuar qeverinë dhe parlamentin nëpërmjet letër-ankesave për cilësinë e ulët të shërbimeve ligjore të ofruara nga shteti, për çështjet penale dhe civile. Edhe pse ligji i ri ka sjellë ndryshime pozitive, për momentin, përveç angazhimit konkret të shtetit për mbështetjen e këtyre qendrave, ana financiare dhe kapacitetet vepruese nuk janë shumë të qarta për t'u analizuar .

Pas përmirësimeve të ligjit aktual, ligji i ri i janarit 2005 parashikon ndihmën ligjore parësore dhe dytësore të ofruar nga shteti. Çdo qytetar mund të përfitojë një orë falas ndihmë ligjore parësore dhe dytësore, kur ai plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji për të ardhurat financiare. Në vazhdim ligji ngre një sistem të tërë zyrash të shërbimeve ligjore publike dhe përcakton funksionimin e Këshillit për Koordinimin e Ndihmës Ligjore të garantuar nga Shteti, si pikë kontakti për përgatitjen e projektligjeve dhe këshillave mbi çështje që synojnë në përmirësimin e politikave të shtetit për ofrimin e ndihmës ligjore falas.

Çfarë mund të përdoret nga rasti i Lituanisë është që mungesa e financimit nga ana e shtetit, i jep një rëndësi parësore shërbimeve ligjore falas të ofruara nga shoqëria civile. Në këtë proces, shoqëria civile shërben si një mjet për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik lidhur me nevojat kryesore dhe rrugët e zgjidhjes. Njëkohësisht, dëshira e mirë dhe mbështetja nga ana e qeverisë për përgatitjen e kuadrit ligjor, është faktor kryesor për suksesin.

2. Praktika të tjera të rëndësishme nga kontinenti amerikan

Shtetet e Bashkuara

Në kontrast me pjesën evropiane dhe vendeve të tjera të zhvilluara, Shtetet e Bashkuara nuk ofrojnë ndihmë ligjore në pjesën më të madhe të çështjeve civile. Në rastin tonë, SHBA ka të "përbashkët" me Shq-

ipërinë mungesën e fondeve shtetërore për ndihmën ligjore. Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve ligjore në SHBA ofrohet nga organizatat joqeveritare. Këta mekanizma tradicionalë mbështeten nga shkollat juridike, shoqatat e avokatëve, avokatë të veçantë ose firma ligjore nëpërmjet të ashtuquajturave shërbime vullnetare në interes publik “pro-bono”. Shumë programe të financuara nga qeveria dhe OJQ-të kanë përshtatur një qëndrim të përbashkët për dhënien e ndihmës ligjore, këshillimit, mbrojtjes në gjyq dhe forma të tjera nëpërmjet përfshirjes së punonjësve socialë dhe ndihmësve të tjerë. Në zbatim të nevojës për një reformë në fushën e ndihmës juridike në të mirë publike, shtetet po zbatojnë programe të ndryshme që kanë si qëllim të përfshijnë palët e interesuara, nga gjykatat deri tek dhomat e avokatisë dhe avokatët privatë. Qëllimi kryesor i këtyre veprimtarive është gjithëpërfshirja në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, dhe zbatimin e planit të përbashkët për ngritjen e një sistemi sa me efektiv mbrojtjeje. Të rejtat si p. sh., përdorimi i linjave të veçanta të emergjencës, dhe e internetit kanë ndryshuar mënyrën e shpërndarjes së ndihmës ligjore. Këto forma të teknologjisë janë përdorur për të fuqizuar rrjetin e bashkëpunimit për këshillimet dhe nga ana tjetër kanë përmirësuar nivelin e shërbimeve të ofruara. Shumë studime tregojnë se ata klientë që kanë marrë telefonata pas përfundimit të çështjeve gjyqësore zakonisht kanë treguar shkallë të lartë suksesi. Për më tepër, përdorimi i teknologjisë ka zgjeruar sensibilizimin e popullatës për të drejtat e tyre dhe mënyrat e mbrojtjes së këtyre të drejtave. Një formë tjetër e bashkëpunimit ka qenë ngritja dhe zhvillimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave për çdo çështje gjyqësore, i cili në vetvete lehtëson komunikimin dhe transferimin e dosjeve sipas kompetencave.

IV. TË NJOHIM LEGJISLACIONIN EVROPIAN NË FUSHËN E BARAZISË GJINORE

**DIREKTIVË 2006/54 KE E
PARLAMENTIT EUROPIAN
DHE E KËSHILLIT, e datës 5
Korrik 2006⁵⁸**

**“Mbi zbatimin e parimit të
mundësive të barabarta dhe
trajtimit të barabartë të
burrave dhe grave në çështjet
e punësimit dhe profesionit”
(i ndryshuar)**

58 Marrë nga Interneti, fq. www.eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2006/l_204/l_20420060726en00230036.pdf, Vizituar për herë të fundit më 17.03.08

PARLAMENTI EUROPIAN
DHE KËSHILLI I BASH-
KIMIT EUROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin që
përcakton Komunitetin

Evropian dhe në veçanti Nenin
141(3) të saj,

Duke pasur parasysh propozimin
nga Komisioni,

Duke pasur parasysh opinionin e
Komisionit Ekonomik dhe Social
Evropian⁵⁹

Duke vepruar në pajtim me proce-
durën e përcaktuar në Nenin 251
të Traktatit⁶⁰

Duke pasur parasysh se;

(1) Direktiva e Këshillit 76/207/, e
datës 9 Shkurt 1976 mbi zbatimin
e parimit të trajtimit të barabartë
të burrave dhe grave në lidhje me
punësimin, formimin profesional

59 OJ C 157, 28.06.2005, f. 83

60 Opinion i Parlamentit Evropian i
datës 6 Korrik 2005 (i pabotuar në Fle-
toren Zyrtare) Pikëpamja e Zakonshme
e Këshillit e datës 10 Mars 2006 (OJ C
126 E, 30.5.2006, fq 33) dhe Pikëpamja
e Parlamentit Evropian e datës 1 Qershor
(akoma e pabotuar në Fletoren Zyrtare).

dhe ngritjen në detyrë, si dhe kushtet e punës⁶¹, Direktiva e Këshillit 86/378/EEC e 24 korrikut 1986 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në skemat e sigurimeve shoqërore⁶², është ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme⁶³; Direktiva e Këshillit 75/117/ e datës 10 Shkurt 1975 mbi përjasjen e ligjeve të vendeve anëtare lidhur me aplikimin e parimit të pagesës së barabartë për burrat dhe gratë (⁶⁴) dhe Direktiva e Këshillit 97/80/EC e datës 15 Dhjetor 1997 mbi barrën e provës në rastet e diskriminimit sipas gjinisë (⁶⁵) gjithashtu, përmbajnë parashikime që kanë si qëllim hyrjen në fuqi të parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave. Tani që tek Direktivat e sipërpërmendura, janë bërë ndryshime të reja, është e dëshirueshme që për arsye qartësie, të rishikohen duke i sjellë ato së bashku në një tekst të vetëm, me parashikimet kryesore që ekzistojnë në këtë fushë si dhe me disa zhvillime të evidentuara si rezultat i precedentëve të Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane (tani referohet si Gjykata).

(2) Barazia midis burrave dhe grave është një parim kryesor në ligjin e Komunitetit, në Nenin 2 dhe Nenin 3 (2) të Traktatit dhe precedentëve të Gjykatës. Këto klauzola të Traktatit e deklarojnë barazinë midis burrave dhe grave si një “detyrë” dhe një “qëllim” të Komunitetit dhe ngarkojnë një detyrim pozitiv për ta nxitur atë në të gjitha aktivitetet.

(3) Gjykata mendon se, qëllimi i parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë nuk mund të kufizohet me ndalimin e diskriminimit të bazuar në faktin që, një person i përket një gjinie apo një tjetre. Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e së drejtës që duhet të mbrohet, ajo aplikohet gjithashtu, edhe tek diskriminimi që ndodh nga ricaktimi i gjinisë së një personi.

(4) Neni 141(3) i Traktatit tani përcakton një bazë të veçantë ligjore për adoptimin e masave të Komunitetit për të siguruar aplikimin e pa

61 OJ L 39, 14.2.1976, f.40. Direktivë siç është përmirësuar nga Direktiva 2002/73/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (OJ I. 269. 5.10.2002, f.15)

62 OJ L 225, 12.8.1986 f.40 Direktivë siç është përmirësuar nga Direktiva 96/97/EC (OJ L 46, 17.2.1997, f. 20)

63 Shih Shtojcën I pjesa A

64 OJ L 45, 19.2.1975, f.19

65 OJ L 14, 20.1.1998, f.6 Direktivë siç është përmirësuar nga Direktiva 98/52/EC (OJ L 205, 22.7.1998, f.66)

riminim të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë në çështjet e punësimit dhe të profesionit, duke përfshirë parimin e pagesës së barabartë të punës apo të punës me të njëjtën vlerë.

(5) Nenet 21 dhe 23 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian gjithashtu, ndalojnë çdo lloj diskriminimi për arsye të gjinisë dhe mbrojnë të drejtën e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në të gjitha fushat, përfshirë punësimin, punën dhe pagesën.

(6) Shqetësimet dhe ngacmimet seksuale janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave dhe përbëjnë diskriminim për arsye të gjinisë për qëllimet e kësaj Direktive. Këto forma diskriminimi shfaqen jo vetëm në vendin e punës, por edhe në kontekstin e aksesit për punësim, formimit profesional dhe ngritjes në detyrë. Ato duhet të ndalohen dhe duhet të jenë subjekt i dënimeve të efektshme, proporcionale dhe bindëse.

(7) Në këtë kontekst, punëdhënësit dhe personat përgjegjës për formimin profesional duhet të inkurajohen të marrin masa për të luftuar të gjitha format e diskriminimit për arsye të gjinisë dhe në veçanti, të marrin masa parandaluese kundër shqetësimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës dhe gjatë pranimit në punë, formimit profesional dhe ngritjes në detyrë, në përputhje me ligjin e vendit dhe praktikën e tij.

(8) Parimi i pagesës së barabartë për punë të barabartë apo punë me vlerë të barabartë, siç është sanksionuar në Nenin 141 të Traktatit dhe në mënyrë të vazhdueshme i miratuar në precedentët e Gjykatës, përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave, si dhe një pjesë të rëndësishme e të domosdoshme të *acquis communautaire*, duke përfshirë precedentin e Gjykatës përsa i përket diskriminimit për arsye të gjinisë. Kështu, është me vend të bëhen parashikime të mëtijshme për zbatimin e tij.

(9) Në përputhje me precedentin e pandryshueshëm të Gjykatës, me qëllim vlerësimin nëse punëtorët po kryejnë të njëjtën punë apo punë të së njëjtës vlerë, duhet të përcaktohet nëse punëtorët mund të konsiderohen se janë në situata të barabarta, duke pasur parasysh një sërë faktorësh, përfshirë natyrën e punës dhe kushtet e trajnimit e të punës.

(10) Gjykata ka vendosur që në rrethana të veçanta, parimi i pagesës së barabartë nuk është i kufizuar vetëm në situatat kur burri dhe gruaja punojnë për të njëjtin punëdhënës.

(11) Vendet anëtare, në bashkëpunim me partnerët sociale, duhet të vazhdojnë ta orientojnë problemin e diferencimit të pagës në bazë të gjinisë, dhe të theksojnë veçimin gjinor në tregun e punës me mënyra të tilla si: përshtatjen e orarit të punës që të bëjë të mundur për të dy palët, burrat dhe gratë, të kombinojnë me sukses detyrimet familjare dhe ato të punës. Këtu mund të përfshihen gjithashtu angazhime për të përfituar të ardhurën e lindjes secili prind, si edhe parashikime të lehtësive të mundshme dhe të përballeshme të kujdesit për fëmijën dhe personat në ngarkim.

(12) Masa të veçanta duhet të miratohen për të siguruar zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë në skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin, dhe të përcaktohet qëllimi i këtij parimi në mënyrë më të qartë.

(13) Në vendimin e tij të datës 17 Maj 1990, në rastin C-262/88⁶⁶, Gjykata përcaktoi që të gjitha format e pensionit të bazuara në punësim, përbëjnë një element page sipas kuptimit të Nenit 141 të Traktatit.

(14) Megjithatë koncepti i pagës brenda kuptimit të Nenit 141 të Traktatit nuk i përfshin përfitimet e sigurimit shoqëror, është vendosur qartësisht që të përfshihet një skemë pensioni për nëpunësit publik në kuadër të parimit të pagesës së barabartë, nëse përfitimet e pagueshme sipas kësaj skeme, i paguhen punëtorit për arsye të marrëdhënieve të punës me punëdhënësin publik, pavarësisht nga fakti që një skemë e tillë përbën pjesë të skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore. Sipas vendimeve të Gjykatës në rastet C-7/93 (⁶⁷) dhe C-351/00 (⁶⁸), ky kusht do të plotësohet nëse skema e pensionit i përket një kategorie punëtorësh dhe përfitimet janë të lidhura drejtpërdrejt me periudhën e shërbimit si dhe të llogaritura në baze të pagës së fundit të punon-

66 C-262/88; Barber kundër Guardian Royal Exchange Assurance Group (1990 ECR I-1889)

67 C-7/93; Bestuur van het Algemeen Burgerlijk Pensioenfonds v G.A. Beune (1994 ECR I-4471).

68 C-351/00; Pirkko Niemi (2002 ECR I-7007).

jësit publik. Për qartësi, është e nevojshme që të bëhen parashikime të veçanta.

(15) Gjykata ka vendosur që, ndërsa kontributet e punëtorëve femra e meshkuj në një skemë pensioni me përfitime të përcaktuara, mbulohen nga Nenin 141 të Traktatit, çdo pabarazi në kontributet e punëdhënësve në skemën e pensionit me përfitime të përcaktuara, e cila ekziston për arsye të përdorimit të faktorëve aktuarial që ndryshojnë në varësi të gjinisë, nuk do të vlerësohet se është nën të njëjtin rregullim të kësaj dispozite.

(16) Duke marrë shembullin e skemës së pensionit me përfitime të përcaktuara, disa elementë si, shndërrimi i formës së pagesës nga një shumë kapitale në një pension periodik me këste, transferimi i të drejtave të pensionit, pagimi i një pensioni të rikthyeshëm ndaj një personi në ngarkim në këmbim të dorëzimit të një pjese të pensionit, apo pensioni i reduktuar ku punëtori zgjedh të marrë pension të parakohshëm, mund të jenë të pabarabarte dhe ku pabarazia e masës së pensionit rezulton nga efektet e përdorimit të faktorëve aktuarial që ndryshojnë në varësi të gjinisë, në kohën kur është vënë në zbatim financimi i skemës.

(17) Është vendosur që të ardhurat e pagueshme sipas skemave të sigurimeve shoqërore me baze punësimin nuk do të konsiderohen si pagesë, për aq kohë sa ato i janë atribuuar periudhave të punësimit para 17 Majit 1990, me përjashtim të rastit të punonjësve apo atyre që pretendojnë si ata, të cilët kanë ndërmarrë veprime ligjore apo kanë ngritur një pretendim të njëjtë sipas ligjit të aplikueshëm të vendit, përpara kësaj date. Është gjithashtu e nevojshme të kufizohet hyrja në fuqi e parimit të trajtimit të barabartë.

(18) Gjykata ka vendosur vazhdimisht që Protokollin i Berberit⁶⁹ të mos ndikojë tek e drejta për t'u bashkuar me skemën e sigurimeve shoqërore me baze punësimin, si dhe që kufizimi i ndikimeve në kohë në gjykimin e Rastit C-262/88 të mos aplikohet tek e drejta për t'iu bashkuar një skeme sigurimi shoqëror me baze punësimin. Gjykata gjithashtu vendosi që rregullat kombëtare për sa i përket kufijve kohorë për të kryer vep

69 Protokoll 17 për sa i përket Nenit 141 të Traktatit që ka krijuar Komunitetin Evropian (1992)

rime sipas ligjit vendas mund të shtrihen edhe përkundrejt punëtorëve të cilët pohojnë të drejtën e tyre për t'iu bashkuar një skeme të sigurimeve shoqërore me baze punësimin, me kusht që ata të mos jenë më pak të favorizuar për atë lloj veprimi sesa për veprime të një natyre vendase (te brendshme) dhe që nuk paraqesin ushtrimin e të drejtave të diskutuara nga Ligji i Komunitetit i pamundur në praktikë. Gjykata ka nxjerrë në pah gjithashtu, faktin që një punëtor mund të pretendojë me prapaveprim për t'u përfshirë në skemën e të sigurimeve shoqërore me baze punësimin, duke mos e lejuar punëtorin ti shmanget pagesës së kontributeve për sa i përket periudhës së anëtarësimit në fjalë.

(19) Sigurimi i aksesit të barabartë për zënieën me punë dhe formimin profesional që të orientojnë në këto gje, është shumë i rëndësishëm në aplikimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe zënies me punë. Çdo përjashtim i këtij parimi duhet të jetë i kufizuar për ato aktivitete të punës tek të cilat është i domosdoshëm punësimi i një personi të një gjinie të veçantë për shkak të natyrës së punës apo kontekstit në të cilin kryhet, duke pasur parasysh që objektivi është i ligjshëm dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

(20) Kjo Direktivë nuk cenon lirinë e anëtarësimit në shoqata duke përfshirë të drejtën e krijimit të sindikatave me të tjerët, si dhe të bashkimit me sindikatat e tjera për të mbrojtur interesat e secilit. Masat, në kuptimin e Nenit 141 (4) të Traktatit mund të përfshijnë anëtarësinë apo vazhdimësinë e aktivitetit të organizatave apo sindikatave, objektivi kryesor i të cilave është mbështetja në praktikë, e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave.

(21) Ndalimi i diskriminimit duhet të behet pa paragjykime lidhur me marrjen apo miratimin e masave, që kanë për qëllim parandalimin apo kompensimin e disavantazheve që ka pasur një grup njerëzish të së njëjtës gjinie. Të tilla masa lejojnë organizimet e personave të njëjës gjinie, me objektiv kryesor mbështetjen e nevojave të veçanta të tyre dhe mbështetjen e barazisë midis burrave dhe grave.

(22) Në përputhje me nenin 141 (4) të Traktatit, me synimin për të siguruar barazi të plotë midis burrave dhe grave në punë, parimi i trajtimit të barabartë nuk ndalon Vendet Anëtare, që të marrin apo miratojnë masa për avantazhe të veçanta me qëllim që të jetë më e lehtë për sek-

sin e nënpërfaqësuar të ndjekë një aktivitet formimi profesional, apo të parandalohen ose kompensohen disavantazhet në karrierat e tij profesionale. Duke dhënë situatën më të fundit dhe duke pasur parasysh Deklaratën Nr. 28 të Traktatit të Amsterdimit, Vendet Anëtare duhet, në momentin e parë, të synojnë në përmirësimin e gjendjes së grave në vendin e punës.

(23) Është e qartë nga precedentë të Gjykatës që trajtimi i papërshtatshëm i një gruaje gjatë shtatzënisë apo lindjes, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për arsye të gjinisë. Një trajtim i tillë duhet të përfshihet qartë në këtë Direktivë.

(24) Gjykata ka njohur vazhdimisht ligjshmërinë, për sa i përket trajtimit të barabartë, të mbrojtjes së gjendjes biologjike të gruas gjatë shtatzënisë dhe lindjes, duke vendosur masa mbrojtëse lindjeje si mjet për të arritur barazinë thelbësore. Kjo Direktivë nuk duhet të jetë në kundërshtim me Direktivën e Këshillit 92/85/EEC të 19 Nëntorit 1992 mbi prezantimin e masave për të inkurajuar përmirësimet për sigurinë në punë për gratë shtatzëna dhe ato që kanë lindur apo kanë fëmijë në gji⁷⁰. Kjo direktive nuk duhet të dëmtojë Direktivën e Këshillit e 96/34/EC të 3 Qershorit 1996 mbi sistemin e marrëveshjes për lejen e prindit, vendosur nga UNICEF; CEEP dhe ETUC⁷¹.

(25) Për arsye qartësie, është gjithashtu me vend, të bëhen parashikime urgjente për mbrojtjen e të drejtave të punës të grave mbi lejen e shtatzënisë dhe në veçanti, mbi të drejtat e tyre për t'u rikthyer në të njëjtin apo ekuivalent vend pune; të mos vuajnë asnjë dëmtim në marrëdhëniet e punës dhe gjendjen e tij, si rezultat i marrjes së lejes dhe të përfitojnë nga çdo përmirësim në kushtet e punës që mund të ketë ndodhur gjatë mungesës së tyre.

(26) Me vendim të Këshillit dhe Ministrave për politikat Sociale dhe të Punësimit, në lidhje me Këshillin e 29 Qershorit 2000 mbi pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe të burrave në familje dhe në punë⁷², Vendet Anëtare morën në konsideratë ekzaminimin e qëllimit të siste-

70 OJ L 348, 28.11.1992, f. 1.

71 OJ L 145, 19.6.1996, f. 4 Direktivë e përmirësuar nga Direktiva 97/75/EC (OJ L 10, 16.1.1998, f.24)

72 OJ C 218, 31.7.2000, f.5

meve respektive ligjore, për t'u dhuruar burrave në punë një të drejtë individuale dhe të patransferueshme për leje atësie, ndërkohë që ruajnë të drejtat e tyre në punë.

(27) Konsiderata të ngjashme janë aplikuar nga Vendet Anëtare tek burrat dhe gratë për një të drejtë individuale dhe jo të transferueshme për sa i përket birësimit të një fëmije. Vendet Anëtare përcaktojnë nëse duhet dhënë apo jo një e drejtë e tillë për lejen e atësisë apo të birësimit dhe kushtet përkatëse, përveç shkarkimit dhe rikthimit në punë, të cilat janë jashtë qëllimit të kësaj Direktive.

(28) Zbatimi efikas i parimit të trajtimit të barabartë kërkon procedura të përshtatshme që të hyjnë në fuqi nga Vendet Anëtare.

(29) Parashikimi i procedurave të përshtatshme juridike dhe administrative për zbatimin e detyrimeve të ngarkuara nga kjo Direktivë, është themelor për zbatimin sa më efikas të parimit të trajtimit të barabartë.

(30) Miratimi i rregullave mbi barrën e së vërtetës luan një rol të rëndësishëm në garantimin e hyrjes në fuqi në mënyrë efikase të parimi i trajtimit të barabartë. Siç e ka miratuar Gjykata, parashikimi duhet bërë për të siguruar që barra e të vërtetës të kalojë tek padituri kur ka një rast diskriminimi *prima facie*, me përjashtim të seancave në të cilat është gjyqi apo një trup tjetër, kompetent për të hetuar faktet. Megjithatë, është e rëndësishme të qartësohet që vlerësimi i fakteve nga të cilat mund të supozohet se ka qenë diskriminim i drejtpërdrejtë ose jo, mbetet një çështje për organin kombëtar përkatës në përputhje me ligjin e vendit apo me praktikën. Për më tej, është detyrë e Vendeve Anëtare të prezantojnë në çdo hap të përshtatshëm të procedurave, rregullat e dëshmisë të cilat janë më të favorshme për paditësin.

(31) Duke pasur parasysh përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të mbrojtjes së ofruar nga kjo Direktivë, shoqata, organizata dhe njësi të tjera ligjore duhet të autorizohen për tu përfshirë në këto procedura, Vendet Anëtare përcaktojnë, në emër të apo mbështetjes së një paditësi, pa cenuar e rregullat e vendit e të procedurës për sa i përket prezantimit dhe mbrojtjes.

(32) Duke pasur parasysh natyrën themelore të së drejtës për mbrojtje

ligjore efikase, duhet të sigurohet që punëtorët të vazhdojnë të gëzojnë një mbrojtje të tillë edhe pasi marrëdhënia që ka sjellë një prishje të pretenduar të parimit të trajtimit të barabartë, të ketë marrë fund. Një punonjësi që mbrohet në gjyq apo jep prova në emër të një personi të mbrojtur nga kjo Direktivë, duhet t'i jepet e njëjta mbrojtje.

(33) Është vendosur qartësisht nga Gjykata se, me qëllim që të jetë sa më efikas, parimi i trajtimit të barabartë përfshin që, edhe kompensimi i dhënë për çdo prishje kontrate, duhet të jetë mjaftueshëm në lidhje me dëmin e pandërprerë. Kështu, duhet të përjashtohet rregullimi i çdo kufiri të lartë për kompensime të tilla, përveçse kur punëdhënësi mund të provojë që i vetmi dëm i vuajtur nga kërkuesi si rezultat i diskriminimit brenda kuptimit të kësaj Direktive, ishte refuzimi nga ana e tij, për të marrë në konsiderate aplikimin e tij/saj për punë.

(34) Me qëllim rritjen e efikasitetit të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, Vendet Anëtare duhet të përkrahin dialogun midis partnerëve socialë dhe brenda kornizës së praktikave të vendit, me organizatat jo-qeveritare.

(35) Vendet Anëtare duhet të japin gjobat efikase, proporcionale dhe bindëse për prishjen e detyrimeve të kësaj Direktivë.

(36) Për aq kohë sa objektivat e kësaj Direktive nuk mund të realizohen mjaftueshëm nga Vendet Anëtare dhe mund të realizohen më mirë në nivel Komuniteti, Komuniteti mund të adoptojë masa në përputhje me parimin e ndihmesës siç është vendosur në Nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç është vendosur në këtë Nen, kjo Direktive nuk tejkalon atë që është e domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave.

(37) Për një kuptim sa më të mirë të trajtimit të ndryshëm të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe zënies me pune, duhet të zhvillohen statistika të krahasueshme për gjinitë e ndryshme, të analizohen dhe të bëhen të disponueshme në nivelet e përshtatshme.

(38) Trajtimi i barabartë midis burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe zënies me pune, nuk mund të kufizohet nga masat legjislative. Në vend të kësaj, Bashkimi Evropian dhe Vendet Anëtare duhet të vazh-

dojnë të përkrahin rritjen e vetëdijes publike sa më shumë që të jetë e mundur, duke përfshirë të gjitha palët që i përkasin niveleve publike e private. Dialogu midis partnerëve socialë mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces.

(39) Detyrimi për të zhvendosur rregullat e kësaj Direktive në një ligj kombëtar duhet të kufizohet tek ato parashikime të cilat paraqesin ndryshime thelbësore krahasuar me Direktivat e mëparshme. Detyrimi për të zhvendosur parashikimet që janë thelbësisht të pandryshueshme, lind nga Direktivat e mëparshme.

(40) Kjo Direktivë nuk duhet të paragjykojë Vendet Anëtare për sa i përket limiteve të kohore për shndërrim në ligj kombëtar dhe zbatim të rregullave të Direktivave të vendosura në Aneksin I, Pjesa B.

(41) Në përputhje me paragrafin 34 të marrëveshjes ndërinstitucionale në ligjbërje më të mirë⁷³, Vendet Anëtare inkurajohen për të ndërtuar, për veten e tyre dhe për interesat të Komunitetit, tabelat e tyre, të cilat do të ilustrojnë sa më shumë që të jetë e mundur lidhjen reciproke midis kësaj Direktive dhe masave të shndërrimit, duke i bërë ato publike.

73 Oj C 321, 31.12.2003, f.1

ADOPTUAN KËTË DIREKTIVË.

TITULLI 1

PARASHIKIMET E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Direktive është të sigurojë zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe zënies me pune.

Duke pasur këtë parasysh, ajo përmban parashikimet për të zbatuar parimin e trajtimit të barabartë për sa i përket:

- (a) Aksesit për punë, duke përfshirë ngritjen në detyrë dhe formimin profesional;
- (b) Kushtet e punës, duke përfshirë pagesën;
- (c) Skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin.

Gjithashtu, përmban dispozita për të siguruar që ky zbatim të bëhet më efikas duke vendosur procedura të përshtatshme.

Neni 2

Përcaktimet

1. Për qëllimet e kësaj Direktive, duhet të aplikohen për caktimet e mëposhtme:

- (a) ‘diskriminimi i drejtpërdrejtë’: kur një person është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme mbi bazën e gjinisë se sa një tjetër që është, ka qenë apo do të trajtohet në një situatë të krahasueshme;
- (b) “diskriminimi jo i drejtpërdrejtë”: kur një parashikim, kriter apo praktikë në dukje neutrale do të vendosnin personat e të njëjtës gjini në

një disavantazh, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, me përjashtim të rasteve kur ai parashikim, kriter apo praktikë është i justifikuar objektivisht nga një qëllim logjik, dhe mjetet e arritjes së këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

(c) ‘ngacmimet’: kur sjellja e padëshiruar për sa i përket gjinisë së personit shfaqet me qëllimin apo ndi-kimin e cenimit të dinjitetit të personit, dhe me krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fyes;

(d) ‘ngacmimi seksual’: kur çdo formë e sjelljes së padëshirueshme verbale apo jo verbale apo fizike e natyrës seksuale, shfaqet me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi, në veçanti, kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fyes;

(e) ‘pagesa’: pagesa apo rroga e zakonshme bazë apo minimale dhe çdo shpërblim tjetër me para në dorë ose në mall, të cilat punëtori i merr drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, në lidhje me punën e tij apo të saj, nga punëdhënësi i tij apo i saj.

(f) “Skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin” skema jo të rregulluara nga Direktiva e Këshillit 79/7/EEC të 19 dhjetor 1978, në zbatimin e progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë, në çështjet e sigurimit shoqëror⁷⁴, ku qëllimi është të sigurohen punëtorët, nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar në një sipërmarrje apo një grup sipërmarrjesh, zone aktiviteti ekonomik, sektor profesional apo grup sektorësh, me të ardhura që kanë qëllim të plotësojnë të ardhurat e përfutuara nga skemat e sigurimeve të detyrueshme shoqërore të parashikuara në ligj, apo ti zëvendësojnë ato, nëse anëtarësia në skema të tilla është e detyrueshme apo vullnetare.

2. Për qëllimet e kësaj Direktive, diskriminimi përfshin;

(a) Shqetësimet dhe ngacmimet seksuale, si dhe ndonjë trajtim të papëlqyer të bazuar në mospranimin e personit apo mosnënshtrimin e kësaj sjellje;

(b) udhëzimet për të diskriminuar personat në bazë të gjinisë;

(c) çdo trajtim jo të favorshëm të një gruaje lidhur me lejen e shtatzënisë apo lindjes brenda kuptimit të Direktivës 92/85/EEC

⁷⁴ OJ L 6, 10.1.1979, f.24

Neni 3
Veprimi pozitiv

Vendet Anëtare mund të mbajnë apo adoptojnë masa brenda kuptimit të Nenit 141 (4) të Traktatit me synimin për të siguruar barazi të plotë midis burrave dhe grave në punë.

Titulli II
Parashikime të veçanta

Kapitulli I
Pagesa e barabartë

Neni 4
Ndalimi i diskriminimit

Për të njëjtën punë apo për punë në të cilën është dhënë e njëjta vlerë, diskriminimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë për arsye të gjinisë përsa i përket të gjitha aspekteve dhe kushteve, duhet të përjashtohet. Në veçanti, kur përdoret një sistem klasifikimi punësh për të përcaktuar pagesën, duhet të bazohet në të njëjtat kriterë të hartuara për burrat dhe gratë si dhe të përjashtohet çdo diskriminim për arsye të gjinisë.

Kapitulli 2
Trajtim i barabartë në skemat e sigurimeve shoqërore

Neni 5
Ndalimi i diskriminimit

Pa cenuar Nenin 4, nuk duhet të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë për arsye të gjinisë në skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin, veçanërisht për sa i përket:

- (a) qëllimit të skemave të tilla dhe kushteve të hyrjes në to;
- (b) detyrimit të kontributit dhe llogaritjes së kontributeve;

(c) llogaritjes se përfitimeve, duke përfshirë përfitimet suplementare të mjaftueshme për sa i përket bashkëshortit apo personave ne ngarkim, dhe kushteve që përcaktojnë kohëzgjatjen dhe ruajtjen e të drejtës për të përfituar.

Neni 6

Fusha personale e zbatimit

Ky kapitull aplikohet tek anëtarë të fuqisë punëtore, duke përfshirë personat e vetë-punësuar, personat aktiviteti i të cilëve është ndërprerë për arsye sëmundjeje, lindjeje, aksidenti, apo papunësie të padëshiruar dhe personat që kërkojnë punë dhe tek punëtorët e dalë në pension apo të cilët nuk janë të aftë për të punuar, dhe tek ata që kërkojnë të përfitojnë prej tyre, në përputhje me ligjin e vendit apo /ose praktikën.

Neni 7

Fusha materiale e zbatimit

1. Ky kapitull aplikohet tek,

(a) skemat e sigurimit shoqëror me baze punësimin të cilat ofrojnë mbrojtje ndaj risqeve të mëposhtme:

- (i) sëmundjet,
- (ii) invaliditetin,
- (iii) pleqërinë, duke përfshirë pensionin e parakohshëm të pleqërisë,
- (iv) aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale
- (v) papunësinë;

(b) skemat e sigurimit shoqëror me baze punësimit të cilat sigurojnë përfitime të tjera sociale, në para apo në natyrë dhe në veçanti për pensionet familjare dhe përfitimet financiare familjare, nëse përfitime të tilla përbëjnë pagesë të dhëna nga punëdhënësi për punëtorin për shkak të punësimit të tij të fundit.

2. Ky kapitull aplikohet gjithashtu, në skemat e pensionit për një kategori të veçantë punonjësish si p.sh.

nëpunësit publikë nëse përfitimet e paguara sipas skeme janë paguar për arsye të marrëdhënies të punës me punëdhënësin publik. Fakti që një skemë e tillë mund të jete pjesë të një skeme të detyrueshme, do të vlerësohet pa paragjykimë në këtë aspekt.

Neni 8

Përfshirje nga qëllimi material

1. Ky kapitull nuk aplikohet në,

- (a) kontratat individuale për personat e vetëpunësuar;
- (b) skema me përfshirje individuale, për personat e vetëpunësuar
- (c) kontrata sigurimesh tek të cilat punëdhënësi nuk është palë, në rastin e punëtorëve;
- (d) parashikime opsionale të skemave të sigurimeve shoqërore me baze punësimin, ofruar pjesëmarrësve individualisht, për ti garantuar ata;
- (i) përfitime të tjera shtesë
- (ii) apo një datë në të cilën do të fillojnë përfitimet normale për personat e vetëpunësuar, apo një zgjedhje midis disa lloje përfitimesh;
- (e) skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin, për aq kohë sa përfitimet janë financuar nga kontributet e paguara nga punëtorët mbi baza vullnetare.

2. Ky Kapitull nuk pengon punëdhënësin t'u japë një pension shtese personave kur arrijnë moshën e pensionit, të përcaktuar nga një skemë e sigurimit shoqëror me baze punësimin, por që nuk e kanë rritur akoma moshën e pensionit për të marrë një pension nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, qëllimi i të cilit është të bëjë të barabartë apo afërsisht të barabartë, për këta persona shumë e plotë të përfitimit të paguar, me përfitimin e paguar për të njëjtën situatë tek personat e seksit tjetër kur këta të fundit kanë arritur moshën e pensionit të përcaktuar me ligj, derisa personat që kanë përfituar shtesën, të arrijnë moshën e pensionit të përcaktuar me ligj.

Neni 9

Shembujt e diskriminimit

1. Parashikime të ndryshme nga parimi i trajtimit të barabartë do të

përfshijnë ato të bazuara në gjini, të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta për:

(a) Përcaktimin e personave që mund të marrin pjesë në një skemë sigurimesh shoqërore me baze punësimin;

(b) Rregullimin e natyrës së detyrueshme apo vullnetare të pjesëmarrjes në një skemë sigurimesh shoqërore me baze punësimin;

(c) Vendosjen e rregullave të ndryshme përsa i përket moshës së hyrjes në një skemë apo periudhës minimale të punësimit ose anëtarësisë në skemën që kërkon të përftojë përfitimet;

(d) Vendosjen e rregullave të ndryshme, përveç atyre të dhëna në pikat (h) dhe (j) për rimbursimin e kontributeve kur një punonjës lë një skemë pa plotësuar kushtet, që e garantojnë për të marre një përfitim afatgjatë.

(e) Vendosja e kushteve të ndryshme për të dhënë përfitimet apo kufizimi i të tilla përfitimeve për punëtorët e njërës apo tjetrës gjini;

(f) Përcaktimi i moshave të ndryshme të daljes në pension;

(g) Pezullimi apo fitimi i të drejtave gjatë periudhave të lejes së lindjes apo lejes për arsye familjare të cilat janë dhënë me ligj apo me marrëveshje dhe, janë paguar nga punëdhënësi;

(h) Vendosja e niveleve të ndryshme të përfitimit, duke përjashtuar për aq kohë sa mund të jetë e nevojshme, për të marrë në konsideratë faktorët actuarial të llogaritjes të cilët ndryshojnë sipas gjinisë në rastin e skemave të kontributit të përcaktuar; në rastin e skemave të financuara me përfitime të përcaktuara, disa elementë mund të jenë jo të barabartë, ku pabarazia e shumave vjen nga efektet e faktorëve actuarial të cilët ndryshojnë sipas gjinisë, në kohën kur financimi i skemës zbatohet;

(i) vendosja e niveleve të ndryshme për kontributet e punëtorëve;

(j) vendosja e niveleve të ndryshme për kontributet e punëdhënësve, përveç;

- (i) në rastin e skemave të kontributit të përcaktuar nëse qëllimi është, të barazohet masa e përfitimeve përfundimtare apo të bëhen ato afërsisht të barabarta për të dyja gjinitë,
- (ii) në rastin e skemave me përfitime të përcaktuara, ku kontributet e punëdhënësit kanë qëllim të sigurojnë financimin e nevojshëm për të mbuluar koston e përfitimeve, të përcaktuar;
- (k) të vendosin standarde të ndryshme apo standarde të aplikueshme vetëm tek punonjësit e një gjinie të specifikuar, përveç atyre të përcaktuar në pikat (h) dhe (j), për sa i përket garancisë apo ruajtjen e te drejtave për të marrë përfitime të vonuara, kur një punonjës largohet nga një skemë.

2. Kur dhënia e përfitimeve brenda qëllimit të këtij Kapitulli është lënë në gjykimin e organeve të menaxhimit të skemës, ky i fundit duhet të veprojë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë.

Neni 10

Zbatimi për sa i përket personave të vetëpunësuar

1. Vendet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dispozitat e skemës së sigurimeve shoqërore me baze punësimin për personat e vetëpunësuar, të cilat janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, janë rishikuar dhe janë në fuqi prej 1 Janarit 1993 apo për Vendet Anëtare tek të cilat pranimi u bë pas asaj date, në datën që ajo Direktivë 86/378/EEC u bë e aplikueshme në territorin e tyre.

2. Ky kapitull nuk do të përjashtojë të drejtat dhe detyrimet që i përka-sin një periudhe anëtarësie në skemën e sigurimeve shoqërore me baze punësimi, për personat e vetëpunësuar, përpara periudhës së rishikimit të asaj , si rrjedhojë e qenies subjekt i skemës gjatë periudhës që ajo ishte në fuqi.

Neni 11

Mundësitë e vonësës për personat e vetëpunësuar

Për sa i përket skemave të sigurimeve shoqërore me baze punësimi, për personat e vetëpunësuar, Vendet Anëtare mund të shtyjnë aplikimin e detyrueshëm të parimit të trajtimit të barabartë duke pasur parasysh ;

(a) përcaktimin e moshës së pensionit për dhënien e pensionit të pleqërisë apo daljes në pension, dhe implikimet e mundshme për përfitimet tjera;

(i) deri në datën në të cilën është arritur kjo barazi në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore,

(ii) apo, tek e fundit, derisa një barazi e tillë të përshkruhet nga kjo Direktivë

(b) pensionet familjare, derisa ligji i Komunitetit vendos parimin e trajtimit të barabartë në skemat e sigurimit të detyrueshëm shoqëror të përcaktuara me ligj;

(c) aplikimi i Nenit 9(1)(i) në lidhje me përdorimin e faktorëve llogaritës aktuarialë, deri në 1 Janar 1999 apo për Vendet Anëtare, pranimi i të cilave u bë pas asaj date, deri në datën që DIREKTIVA 86/378/EEC u bë e aplikueshme në territorin e tyre.

Neni 12

Efekti prapaveprues

1. Çdo masë që zbatohet në këtë kapitull, për sa i përket punëtorëve, do të mbulojë të gjitha përfitimet nën skemat e sigurimeve shoqërore me baze punësimin, të rrjedhura nga periudhat e punës pas 17 Maj 1990 dhe do të aplikohen në mënyrë prapavepruese në atë datë, pa cenuar punëtorët apo ata që pretendojnë meqenëse janë në ngarkim të tyre, të cilët kanë filluar veprime ligjore para asaj date, apo kanë ngritur një pretendim të ngjashëm sipas ligjit të vendit. Në atë rast, masat zbatuese do të aplikohen në mënyrë prapavepruese në 8 Prill 1976 dhe do të mbulojnë të gjitha përfitimet që rrjedhin nga periudhat e punësimit pas asaj date. Për vendet Anëtare të cilat hynë në Komunitet pas 8 prillit 1976 dhe përpara 17 Majit 1990, ajo datë do të zëvendësohet nga data në të cilin u bë i aplikueshëm Neni 141 i traktatit në territorin e tyre.

2. Fjalja e dyte e paragrafit 1 nuk do të ndalojë rregullat kombëtare, për sa i përket limiteve kohore për të ndërmarrë masa në sistemin ligjor vendas, për të qenë i besueshëm, apo kundër punëtorëve (apo atyre që kërkojnë për ta), të cilët kanë filluar procedurat ligjore, apo kanë ngritur pretendime të ngjashme sipas ligjit të vendit përpara 17 Majit 1990,

duke treguar se ato nuk janë me pak te favorshme për atë lloj veprimi, sesa ato që janë te ngjashme dhe të një natyre të brendshme, dhe te cilat nuk japin të drejtën e dhënë nga ligji i Komunitetit, i pamundur në praktike.

3. Për Vendet Anëtare, pranimi i të cilëve u bë pas 17 Majit 1990 dhe që ishin në 1 Janar 1994, Palët Kontraktuese në Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane, data 17 Maj 1990 në fjalinë e parë të paragrafit 1 duhet të zëvendësohet me 1 Janar 1994.

4. Për Vendet Anëtare pranimi i të cilëve u bë pas 17 Majit 1990 në paragrafin 1 dhe 2 do të zëvendësohet me datën në të cilën u bë i aplikueshëm Neni 141 i Traktatit.

Neni 13

Mosha e ndryshueshme e pensionit

Kur burrat dhe gratë mund të kërkojnë një moshë pensioni fleksibël nën të njëjtat kushte, kjo nuk do të konsiderohet si e papërputhur me këtë kapitull.

KAPITULLI 3

Trajtim i barabartë për sa i përket punësimit, formimit profesional dhe kushteve të punës

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

1. Nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për sa i përket gjinisë në sektorët publik apo privat, duke përfshirë organet publike, në lidhje me;

(a) kushtet për hyrje në punë, vetëpunësim apo në punësim, duke përfshirë kriteret dhe kushtet e marrjes në punë, në cilëndo degë të aktivitetit dhe tek të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, duke përfshirë ngritjen në detyrë;

(b) mundësi hyrjeje tek të gjitha nivelet e drejtimeve profesionale, formimet profesionale, formime të avancuara profesionale dhe ri-formimin duke përfshirë eksperiencën e punës;

(c) punësimi dhe kushtet e punës, duke përfshirë largimet nga puna, si edhe pagesën, siç është parashikuar për Nenin 141 të Traktatit;

(d) anëtarësi dhe përfshirje në një organizatë të punëtorëve apo punëdhënësve, apo çdo organizatë, anëtarët e të cilës kanë një profesion të veçantë, duke përfshirë përfitimet e siguruar nga organizata të tilla.

2. Vendet Anëtare mund të sigurojnë, për sa i përket hyrjes në punë përfshirë edhe drejtimit e trajnimit për tu zënë me punë, që një ndryshim i trajtimit i bazuar në një karakteristikë që lidhet me gjininë, nuk do të përbëjë diskriminim kur, për arsye të natyrës të aktiviteteve të veçanta të punës apo të kontekstit që ato janë kryer, një karakteristikë e tillë përbën një kërkesë të vërtetë dhe të përcaktuar, duke siguruar që objektivi i saj të jetë i pranueshëm dhe kërkesa të jetë proporcionale.

Neni 15

Kthimi nga leja e lindjes

Një gruaje me leje lindjeje do t'i jepet e drejta, pas fundit të periudhës së lejes së lindjes, që të kthehet në vendin e saj të punës apo tek një vend i ngjashëm, lidhur me kushtet, të cilat nuk janë më pak të favorshme për të dhe, do të përfitojë çdo përmirësim në kushtet e punës që janë kryer gjatë periudhës së mungesës së saj.

Neni 16

Leja e atësisë dhe e adoptimit

Kjo Direktivë nuk cenon të drejtën e Vendeve Anëtare për të njohur të drejtat e veçanta për lejen e atësisë apo/ose të adoptimit.

Ato Vende Anëtare, të cilat njohin të drejta të tilla, duhet të marrin masa të nevojshme për të mbrojtur punëtorët burra e gra nga shkarkimi për shkak të ushtrimit të këtyre të drejtave dhe të sigurojnë që, në fund të

kësaj lejeje, ata të kenë të drejtë të kthehen në vendet e tyre të punës apo në vende të ngjashme, të cilat nuk janë më pak të favorshme për ta dhe, të përfitojnë çdo përmirësim në kushtet e punës të cilat janë dhënë gjatë mungesës së tyre.

Titulli III

Parashikime paralele

Kapitulli 1

Kompensimet dhe hyrja në fuqi

Seksioni 1

Kompensimet

Neni 17

Mbrojta e të drejtave

1. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që, pas mbështetjes në autoritetet e tjera kompetente, duke përfshirë ato që ata i mendojnë të duhura për procedurat e pajtimit, procedurat ligjore për hyrjen në fuqi të detyrimeve sipas kësaj Direktive janë të përshtatshme për të gjithë personat që e konsiderojnë veten e tyre të ofenduar nga dështimi i aplikimit të parimit të trajtimit të barabartë tek ta, edhe pasi ka përfunduar marrëdhënia në të cilën ka ndodhur diskriminimi i pretenduar.

2. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që bashkimet, organizatat apo njësi të tjera ligjore të cilat janë në përputhje me kriterin e vendosur nga ligji i vendit, dhe kanë interes ligjor për të siguruar që parashikimet e kësaj Direktive të jenë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave, mund të angazhohen, ose në emër të paditësit, ose me miratimin e tij apo saj, në çdo procedure ligjore dhe/ose administrative të nevojshme për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Direktive.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë rregullat e vendit për sa i përket limitit të kohës për të sjellë veprime në lidhje me trajtimin e barabartë.

Neni 18

Kompensimi apo rregullimi

Vendet Anëtare duhet të prezantojnë në sistemin e tyre ligjor masa të tilla që janë të nevojshme për të siguruar kompensim apo rregullim të vërtetë dhe efikas dhe, Vendet Anëtare kështu të përcaktojnë humbjen dhe dëmtimin e bërë nga një person i lënduar si rezultat i diskriminimit sipas gjinisë, në një mënyrë që të jetë bindëse dhe proporcionale me dëmin e bërë. Kompensimi i tillë apo rregullimi, mund të mos jetë i kufizuar nga vendosja e një limiti të lartë paraprak, përveç se në rastet kur punëdhënësi mund të provojë që i vetmi dëm i provuar nga paditësi si rezultat i diskriminimit brenda kuptimit të kësaj Direktive, ka qenë refuzimi i marrjes në konsideratë të aplikimit të tij apo saj.

Seksioni 2

Barra e së vërtetës

Neni 19

Barra e provës

1. Vendet Anëtare duhet të marrin masa të tilla të nevojshme në përputhje me sistemet e tyre ligjore, për të siguruar që, kur personat që e konsiderojnë veten e tyre të ofenduar sepse nuk është aplikuar tek ata parimi i trajtimit të barabartë, vendosin, përpara një gjyqi apo autoriteteve të tjera kompetente, fakte nga të cilat mund të provohet që ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, duhet të jetë i padituri që të provojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

2. Paragrafi 1 nuk dot'i ndalojë Vendet Anëtare për prezantimin e rregullave të provave të cilat janë më shumë të favorshme për paditësin.

3. Vendet Anëtare nuk kanë nevojë të aplikojnë paragrafin 1 për veprime në të cilat është detyrë e gjykatës apo e organit kompetent të shqyrtojë faktet për rastin.

4. Paragrafi 1, 2 dhe 3 duhet të aplikohet gjithashtu për:

(a) situatat e mbuluara nga Neni 141 i Traktatit dhe, për aq kohë sa diskriminimi me baze gjinie është shqetësues sipas Direktivës 92/85/EEC dhe 96/34/EC;

(b) çdo procedurë civile apo administrative në sektorin publik apo privat, të cilat parashikojnë mjete të korrigjimit sipas ligjit të vendit në vijim të masave të përmendura në (a), me përjashtim të procedurave jashtë gjykatës të një natyre vullnetare të kujdesura sipas ligjit të vendit.

5. Ky nen nuk do të aplikohet në procedurat penale, me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga Vendet Anëtare.

Kapitulli 2

Nxitja e trajtimit të barabartë-dialogu

Neni 20

Organet e barabarta

1. Vendet Anëtare do të caktojnë dhe do të bëjnë të mundur përgatitjen e një organi apo disa organeve për nxitjen, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të të gjithë personave pa diskriminim mbi bazë të gjinisë. Këto organe mund të jenë pjesë të agjencive me përgjegjësi në nivel kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut apo ruajtjen e të drejtave individuale.

2. Vendet Anëtare do të parashikojnë që kompetencat e këtyre organeve të përfshijnë:

(a) pa cenuar të drejtën e viktimës dhe të shoqatave, organizatave, apo njësisë të tjera ligjore të referuara në Nenin 17(2), duke u dhënë ndihmesë të pavarur viktimave të diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim;

(b) kryerjen e sondazheve të pavarura për sa i përket diskriminimit;

(c) botimin e raporteve të pavarura dhe bërjen e rekomandimeve për çdo çështje që i përket një diskriminimi të tillë;

(d) shkëmbimin e informacionit të duhur e në nivel të përshtatshëm, me organet përkatëse Evropiane, si për shembull ndonjë Institut i Ardhshëm Evropian për Barazinë Gjimore.

Neni 21
Dialogu social

1. Vendet Anëtare, në përputhje me traditat dhe praktikat e vendit, do të marrin masat e duhura për të nxitur dialogun social midis partnerëve socialë duke pasur parasysh kujdesen për trajtimin e barabartë, për shembull, përmes monitorimit të praktikave në vendet e punës, në marrjen në punë, formimin profesional dhe përkrahjen, si dhe nëpërmjet monitorimit të kontratat kolektive, kodeve të administrimit, kërkimin apo këmbimin e eksperiencës.

2. Në përputhje me traditat dhe praktikat e vendit, Vendet Anëtare do të inkurajojnë partneret socialë, pa cenuar autonominë e tyre, të nxisin barazinë midis burrave dhe grave dhe rregullime fleksibël të punës, me qëllim lehtësimin e bashkërendimit të punës dhe jetës private dhe për të përfunduar në nivelin e duhur, marrëveshje të cilat përcaktojnë rregulla mbi anti-diskriminimin në fushat e referuara në Nenin 1, të cilat janë sipas qëllimit të kontratës kolektive. Këto marrëveshje do të respektojnë parashikimet e kësaj Direktive dhe zbatimin e masave përkatëse të vendit.

3. Vendet Anëtare në përputhje me ligjin e vendit, kontratat kolektive apo praktikat, do të inkurajojnë punëtorët të nxisin trajtimin e barabartë midis burrit e gruas në mënyrë të planifikuar dhe sistematike në vendin e punës, për akses në punësim, në formimin profesional dhe ngritjen në detyrë.

4. Punëdhënësit duhet të inkurajohen të sigurojnë në intervale të rregullta e të përshtatshme punëtorët dhe/apo prezantuesit e tyre me informacionin e duhur mbi trajtimin e barabartë për burrin e gruan në sipërmarrje.

Informacion i tillë mund të përfshijë një përmbledhje të raportit të burrave dhe grave në nivele të ndryshme të organizimit, pagesa e tyre dhe ndryshimet e pagesës, masat e mundshme për të përmirësuar situatën me përfaqësuesit e punonjësve.

Neni 22

Dialogu me organizatat jo-qeveritare

Vendet Anëtare duhet të inkurajojnë dialogun me organizatat joqeveritare të përshtatshme të cilat kane në përputhje me ligjin e vendit, një interes ligjor në kontribiimin e luftës kundër diskriminimit për sa i përket gjinisë, duke pasur parasysh parimin e trajtimit të barabartë.

Kapitulli 3

Parashikime paralele të përgjithshme

Neni 23

Pajtimi

Vendet Anëtare do të marrin masa të nevojshme për të siguruar që:

- (a) do të shfuqizohet çdo ligj, rregull dhe parashikim ad ministrativ në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë;
- (b) parashikimet në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë në kontratat ose marrëveshjet individuale ose kolektive, rregullat e brendshme të sipërmarrjeve apo rregullat që drejtojnë punësimet e pavarura, profesionet dhe organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve apo ndonjë marrëveshje tjetër, duhet të jenë/ose mund të jenë, deklaruar të pafuqishme dhe të pavlefshme, ose të jene ndryshuar.
- (c) Skemat e sigurimeve shoqërore që mbajnë parashikime të tilla mund të mos aprovohen apo të zgjerohen nga masa administrative.

Neni 24

Përndjekja

Vendet Anëtare do të paraqesin në sistemet e tyre ligjore masa të tilla që janë të nevojshme për të mbrojtur punonjësit, përfshirë ata që janë përfaqësues të punonjësve, të parashikuara nga ligjet e vendit dhe/ose praktikat, kundër largimit nga puna apo trajtimit tjetër jo të favorshëm nga punëdhënësi, si reagim nga një ankesë brenda sipërmarrjes apo për ndonjë procedure ligjore, me qëllim zbatimin e ankesës mbi parimin e trajtimit të barabartë.

Neni 25

Gjobat

Vendet Anëtare do të vendosin rregullat për gjobat e aplikueshme në shkeljet e parashikimeve të adoptuara në vijim të kësaj Direktive dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që janë aplikuar. Gjobat, që mund të përfshijnë pagesën e kompensimit të viktimës, duhet të jenë efikase, të përpjesëtueshme dhe bindëse. Vendet Anëtare duhet t'i shpallin këto parashikime në Komisionin e 5 tetorit 2005 dhe duhet t'i shpallin ato pa vonesë të ndonjë amendamenti pasues, duke ndikuar tek ata.

Neni 26

Ndalimi i diskriminimit

Vendet Anëtare do të inkurajojnë, në përputhje me ligjin e vendit, marrëveshje të përbashkëta apo praktika me punëdhënësit dhe ata përgjegjës, për mundësi hyrjeje në trajnimin profesional, për të marrë masa efikase për ndalimin e të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë, në veçanti shqetësimet dhe ngacmimet seksuale në vendin e punës, në pranimet në punë, formimin profesional dhe ngritjen e detyre.

Neni 27

Kërkesat minimale

1. Vendet Anëtare mund të prezantojnë apo mbajnë parashikimet të cilat janë më të favorshme për mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë, sesa ato të përcaktuara në këtë Direktivë.
2. Zbatimi i kësaj Direktive do të jete i mjaftueshëm në rrethanat e reduktimit të nivelit të mbrojtjes së punëtorëve në zonat në të cilat aplikohet, pa ndonjë paragjykim në të drejtën e Vendeve Anëtare, për t'u përgjigjur ndryshimeve të situatave duke prezantuar ligje, rregulla dhe parashikime administrative të cilat ndryshojnë nga ato në fuqi për shkak të njohjes së kësaj Direktive, duke siguruar që parashikimet e kësaj Direktive të jenë në përputhje.

Neni 28

Marrëdhënia me Komitetin dhe parashikimet kombëtare

1. Kjo Direktivë nuk cenon parashikimet që i përkasin mbrojtjes së grave, veçanërisht përsa i përket shtatzënisë dhe lindjes.
2. Kjo Direktivë nuk cenon parashikimet e Direktivës 96/34 EC dhe Direktivës (92/85/EEC).

Neni 29

Rrymat kryesore të gjinive

Vendet Anëtare do të marrin në konsiderate objektivin e barazisë midis burrave dhe grave kur formulohen dhe zbatohen ligjet, rregullat, parashikimet administrative, politikat në zonat e referuara në këtë Direktivë.

Neni 30

Përhapje e informacionit

Vendet Anëtare duhet të sigurohen që masat e marra sipas kësaj Direktive, së bashku me parashikimet në fuqi, të jenë sjellë në vëmendjen e të gjithë personave të interesuar me të gjitha mënyrat e mundshme, dhe aty ku duhet, në vendin e punës.

Titulli IV

Parashikimet përfundimtare

Neni 31

Raportet

1. Në 15 Shkurt 2001, Vendet Anëtare duhet t'i transmetojnë Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm për Komisionin, për të hartuar një raport për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi aplikimin e kësaj Direktive.

2. Pa cenuar paragrafin 1, Vendet Anëtare duhet t'i komunikojnë Komisionit, çdo 4 vjet, tekstet e çdo mase të adoptuar sipas Nenit 141(4) të Traktatit si edhe raportet mbi këto masa dhe zbatimin e tyre. Mbi bazat e këtij informacioni, Komisioni do të adoptojë dhe botojë çdo katër vjet një raport duke vendosur një vlerësim të krahasueshëm për çdo masë duke marrë parasysh Deklaratën Nr. 28 e aneksuar në Aktin final të Traktatit të Amsterdimit.

3. Vendet Anëtare do të vlerësojnë aktivitetet profesionale të referuara në Nenin 14(2), me qëllim vendosjen duke pasur parasysh zhvillimet sociale, nëse ka justifikim për mbajtjen e përjashtimit në fjalë. Ata do të njoftojnë Komisionin për rezultatet e kësaj llogaritjeje në mënyrë periodike, por të paktën çdo 8 vjet.

Neni 32 **Rishikimi**

Deri 15 Shkurti 2011, Komisioni do të rishikojë funksionimin e kësaj Direktive dhe nëse është e nevojshme do të propozojë ndonjë amendament.

Neni 33 **Zbatimi**

Vendet Anëtare duhet të vënë në fuqi ligjet, rregullat dhe parashikimet administrative të nevojshme për t'u pajtuar me këtë Direktivë deri në 15 Gusht 2008, ose do të sigurojë deri në atë datë që drejtuesit dhe punonjësit të paraqesin parashikimet e kërkuara me marrëveshje. Vendet Anëtare, nëse është e nevojshme duke marrë parasysh vështirësi të ndryshme, mund të kenë një vit shtesë për t'u pajtuar me këtë Direktivë. Vendet Anëtare duhet të marrin të gjithë hapat e nevojshëm për të qenë në gjendje të garantojnë rezultatet e vëna nga kjo Direktivë. Ata duhet t'i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstet e këtyre masave.

Kur Vendet Anëtare t'i adoptojnë këto masa, ato duhet të mbajnë një reference për këtë Direktivë apo t'i shoqërojnë me një reference të tillë në publikimin e tyre zyrtar. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu, një deklaratë që referohet në ligjet ekzistuese, rregullat dhe parashikimet administrative, të shfuqizuara nga kjo Direktivë. Vendet Anëtare do të

përcaktojnë se si një reference i tillë do të përgatitet dhe se si do të formulohet deklarata. Detyrimi për të zhvendosur këtë Direktivë në ligj të vendit do të kufizohet tek ato parashikime që prezantojnë një ndryshim të pavarur, krahasuar me Direktivat e mëparshme. Detyrimi i zhvendosjes, parashikimet e të cilave janë të pandryshueshme ngrihen sipas Direktivës së mëparshme.

Neni 34
Shfuqizimi

1. Me efekt nga Direktivat 75/117/EEC, 76/207/EEC, 86/378/EEC e 15 Gushtit 2009 do të shfuqizohet pa cenuar detyrimet e Vendeve Anëtare duke pasur parasysh limitin e kohës për kthimin në ligj të vendit dhe aplikimin e Direktivës së vendosur në Aneksin 1, pjesa B.

2. Referencat e bëra për të shfuqizuar Direktivat duhet të interpretohen si të bëra tek kjo Direktivë dhe duhet të lexohen në përputhje me korrelacionin e tabelës në Aneksin II.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi pas 20 ditëve nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian

Neni 36
Adresimi

Kjo Direktivë i adresohet Vendeve Anëtare.

Hartuar në Strasburg, 5 Korrik 2006

Për Parlamentin Evropian
Presidenti
J. BORRELL FONTELLES

Për Këshillin
Presidenti
P. LEHTOMAKI

**JURISPRUDENCA
E GJYKATËS EVROPIANE
TË DREJTËSISË**

**RASTI OUMAR DABO AB-
DONLAY DHE TË TJERË
VERSUS NDËRMARRJES
KOMBËTARE TË
UZINAVE RENAULT SHA⁷⁵**

⁷⁵ Shih www.curia.europa.eu/en/actu/activities/act99/9915en.htm; Case C- 218/98

Gjykata e Drejtësisë, Luksemburg

Çështja C-218/98

**Oumar Dabo Abdoulaye dhe të
tjerë kundër Ndërmarrjes kom-
bëtare të uzinave Renault SHA**

Politika sociale

16 Shtator 1999

Vendimi paraprak

{Interpretimi i nenit 119 të Traktatit EC (nenet 117 deri në 120 i Traktatit EC janë zëvendësuar me nenet 136 EC deri në 143 EC) dhe Direktivës 75/117/EEC dhe 76/207/EEC marrëveshjes kolektive që siguron që gratë shtatzëna të marrin pagesë kur marrin lejen e lindjes)

(Dhoma e pestë)

Me vendimin e datës 24 Prill 1998, Këshilli i Prud'hommes (Gjykata Industriale), Havër, iu

referua gjykatës për rregullimin paraprak të një çështjeje mbi interpretimin e nenit 119 të Traktatit të EC (nenet 117 deri në 120 të Traktatit të EC janë shfuqizuar me nenet 136 EC dhe 143 EC) ; të Direktivës së Këshillit 75/117/EEC të 10 Shkurtit 1975 mbi përfrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat dhe gratë ; si dhe të Direktivës së Këshillit 76/207/EEC të 9 shkurtit 1976 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin në punësim, trajnim, promovim dhe kushtet e punës.

Çështja u ngrit në procedimin midis Oumar Dabo Abdoulaye e paditësve të tjerë nga njëra anë, ndaj Ndërmarrjes kombëtare të uzinave « Renault » SHA (më poshtë do t'i referohemi 'Renault').

Paditësit janë punëtorë meshkuj tek Renault. Ata pretendojnë se neni 18 i marrëveshjes mbi përfitimet sociale për punonjësit e Renault (më tej do t'i referohemi 'Marrëveshja') bien në kundërshtim me parimin e ndalimit të diskriminimit, deklaruar në nenin 119 të Traktatit, i cili ishte zbatuar nga neni L. 140-2 të Kodit Francez të Punës.

Neni 18 i marrëveshjes vendos që një punonjëseje femër, kur merr lejen e lindjes, i garantohet shuma prej 7 500 frangash franceze. Kurse, neni 19 i Marrëveshjes siguron që gjatë kohëzgjatjes së lejes së lindjes, paguar nga sigurimet shoqërore, një punonjëse femër merrte 100% të pagës së saj neto, jo më pak se pagesa ditore e paguar nga sigurimet shoqërore.

Përfundimisht, neni 20 i marrëveshjes siguron që me adoptimin e një fëmije, babai ose mamaja e punësuar nga ndërmarrja, marrin një shumë prej 2 000 frangash franceze. Nëse të dy bashkëshortët punojnë në këtë ndërmarrje, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm nga njëri prej tyre.

Gjykata kombëtare pohoi se Gjykata e Drejtësisë nuk ka vendosur kurrë mbi çështjen e pajtueshmërisë me nenin 119 të Traktatit të një leje të këtij lloji në procedimet kryesore, megjithëse në gjykimin e Çështjes C-342/93 *Gillespie dhe të tjerë*, ajo mori në konsideratë një çështje relativisht të ngjashme.

Në këto rrethana, ajo vendosi ta pezullojë procedurën dhe të referojë çështjen e mëposhtme në gjykatë për një vendim paraprak:

A e lejon parimi i pagës së barabartë për burrat dhe gratë (*i sanksionuar në nenin 119 të Traktatit të Romës dhe në aktet nënligjore*), **një pagesë prej 7 500 Frangash Franceze, vetëm për gruan shtatzënë kur ajo merr lejen e lindjes, dhe jo për babanë e fëmijës ?**

Një pagesë e tillë sigurohet nga pjesa e fundit e nenit 18 të marrëveshjes kolektive të datës 5 Korrik 1991, mbi përfitimet shoqërore për punonjësit e Renault.

A siguron neni 19(2) i marrëveshjes që pagat e punonjësve duhet të vazhdojnë t'u paguhen gjatë lejes së lindjes?

Nëpërmjet kësaj pyetjeje gjykata kombëtare shtron në mënyrë esenciale problemin nëse, parimi i pagës së barabartë deklaruar në nenin 119 të Traktatit e bën të pamundur kryerjen e pagesës së një shume të madhe, ekskluzivisht për punonjëset femra, që marrin lejen e lindjes?!

Termi 'paguaj' i përdorur në dispozitat e sipërpërmendura përfshin të gjitha shpërblimet, të cilat punonjësit i marrin drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga punëdhënësit në lidhje me punën e tyre. Natyra ligjore e shpërblimeve të tilla nuk është e rëndësishme për qëllimin e zbatimit të nenit 119 të Traktatit, duke siguruar që ai garantohej në lidhje me punësimin.

Shpërblimi i klasifikuar si pagesë përfshin ndër të tjera, shpërblimin e paguar nga punëdhënësi duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe në kontratën e punës. Qëllimi i saj është të sigurojë që punonjësit të marrin pagesë edhe në raste specifike të parashikuara nga ligji, kur ata nuk janë duke kryer punë të përfshira në kontratat e tyre të punësimit.

Sa kohë që përfitimi i paguar nga një punëdhënësi për një punonjëse femër, si në rastin kur ajo merr lejen e lindjes, bazohet në marrëdhënien e punës dhe përbën pagesë brenda kuptimit të nenit 119 të Traktatit, si dhe të Direktivës 75/117.

Pajtueshmëria e një pagese si kjo në procedimet kryesore, me nenin 119 të Traktatit, varet nga çështja nëse punonjëset femra janë në një situatë të krahasueshme me atë të punonjësve meshkuj, në lidhje me këtë pagesë.

Renault përmendi disa disavantazhe profesionale, të qenësishme në lejen e lindjes, të cilat krijohen për punonjëset femra, si rezultat i largimit të tyre nga puna për kohën e lejelindjes.

Së pari, një grua me leje lindjeje mund të mos propozohet për promovim. Me kthimin e saj, periudha e saj e shërbimit do të reduktohet nga kohëzgjatja e mungesës së saj, **së dyti**, një grua shtatzënë nuk mund të pretendojë rritjen e rrogës; **së treti**, një punonjëse femër mund të mos marrë pjesë në trajnim; **së fundi**, sa kohë që teknologjia e re është vazhdimisht duke ndryshuar natyrën e punëve, përshtatja e punonjësve femra me punën e tyre kur kthehen nga leja e lindjes, komplikohet.

Neni 119 i Traktatit nuk përjashton bërjen e një pagese të tillë si kjo në fjalë, ekskluzivisht për punonjëset femra, sa kohë që kjo është vendosur për të kompensuar disavantazhet profesionale, si ato të përmendura nga Renault. Në këtë çështje, punonjësit meshkuj dhe femra, janë në situata të ndryshme, gjë që përjashton çdo shkelje të parimit të pagës së barabartë të deklaruar në nenin 119 të Traktatit.

I takon gjykatës kombëtare të vendosë për këtë çështje.

Gjykata vendosi:

‘Parimi i pagës së barabartë i deklaruar në nenin 119 të Traktatit EC (Nenet 117 deri në 120 të Traktatit EC janë shfuqizuar me nenet 136 EC deri në 143 EC) nuk përjashton caktimin e një page të madhe, ekskluzivisht për punonjëset femra që marrin leje lindjeje, kur kjo pagë është vendosur për të kompensuar humbjet profesionale, të cilat lindin për këto punonjëse si rezultat i largimit të tyre nga puna.

Avokati General S. Alber dha mendimin e tij në dhomën e pestë në 3 Korrik 1999.

Ai propozoi që gjykata të përgjigjet si më poshtë:

‘Të dyja parimet, parimi i pagës së barabartë për burrat dhe gratë, si dhe ai i trajtimit të barabartë, lejojnë një përfitim prej 7500 Frangash franceze, siguruar në një marrëveshje kolektive për gratë shtatzëna që fillojnë lejen e lindjes, por jo për baballarët. Kjo pagesë qëndron edhe nëse e punësuara shtatzënë merr pagën e saj neto të plotë, përgjatë lejes.’

**JURISPRUDENCA E
GJYKATËS KUSHTETUESE
RASTI I PUNËS GJATË
NATËS (GJERMANI)**

**RASTI I PUNESIMIT
NATEN⁷⁶**

76 Ky rast botohet së bashku me komentet e parashtruara në tekstin “Comparative Constitutionalism”, Cases and Materials. (Norman Dorsen etc.), Thomson West, USA, 2003.

Gjkata Kushtetuese Federale e Gjermanisë
85 BverfGE 191 (1992)

Diskriminimi në bazë seksi ose gjinie

Ndërsa barazia midis anëtarëve të racave ose grupeve të ndryshme etnike kërkon trajtim të barabartë në pothuajse të gjitha rastet, barazia midis burrave dhe grave kërkon një qasje të shumëllojshme. Në disa raste është e qartë se barazia midis gjinive kërkon trajtim të barabartë. Kështu, burrat dhe gratë me kualifikim të njëjtë, duhet të gëzojnë trajtim të barabartë në punësim. Megjithatë, në disa raste të tjera, barazia midis gjinive mund të kërkojë trajtim të ndryshëm. Për shembull, nëse burrat dhe gratë janë të barabartë të kontrollojnë trupin e tyre, privimi i argumentuar i grave nga opsioni i kryerjes së një aborti, rezultoi në mohimin juridik të kësaj të drejte për gratë, ndërsa burrat ruajnë kontrollin e plotë mbi trupin e tyre. Pra, ndryshimet midis gjinive mund të jus-

tifikojnë ose të kërkojnë trajtim të ndryshëm. Por cilat janë këto ndryshime?

Historikisht, burrat dhe gratë kanë qenë dalluar nga njëri tjetri mbi bazë të diferencave të natyrës fizike, psikologjike dhe sociale (p.sh., ndryshimet në lidhje me rolet gjinore brenda shoqërisë). Ky fakt, ngre të paktën dy çështje të ndryshme me bazë gjinore, të cilave duhet t'u jepet përgjigje përpara përcaktimit nëse parimi i barazisë në Kushtetutë duhet të mandatojë trajtim të barabartë apo të ndryshëm.

Së pari, kjo diferencë e pretenduar është reale apo stereotipike? *Së dyti*, nëse diferenca është reale, a është ajo e parëndësishme për qëllimet e rastit që po trajtojmë? *Rasti Cf. Michael M.v. Superior Court, 450 U.S. 464 91981*, konsideroi krim, kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë me një vajzë nën 18 vjeç, në një rast që përfshinte të dy, burrë dhe grua nën moshën 18 vjeç. Gjykata arsyetoi se sa kohë që femrat mbeten shtatzënë, ato kanë një nxitje që burrave u mungon të mos përfshihen në marrëdhënie seksuale. Për drejtësinë në këtë rast, megjithë ndryshimet që ajo paraqet, shkaku i vërtetë për një trajtim të pabarabartë nuk ishte një ndryshim fizik, por një stereotip social mbi pastërtinë femërore dhe një stereotip psikologjik. Ky i fundit, drejtohet mbi supozimin e mungesës së aftësisë së vërtetë të një femre të re, për të dhënë pëlqimin për kryerjen e marrëdhënieve seksuale.

Rasti i punësimit gjatë natës

Një supervizore në një fabrikë ëmbëlsirash ishte gjobitur për punësimin e grave për ambalazhimin e mallit gjatë natës, pasi kishte dhunuar statusin, i cili ndalonte punësimin e grave si punëtoreshë krahu, gjatë natës. Pasi i ezauroi mjetet e zakonshme gjyqësore, supervizorja plotësoi një ankesë kushtetuese, duke argumentuar se ligji në fjalë shkelte dispozitat e barazisë të parashikuara në nenet 3(1) dhe (2) të Ligjit Themeltar. Kërkesa u pranua nga Gjykata Kushtetuese. Ajo vendosi se, ndalimi i punësimit të grave natën është i papajtueshëm me Artikullin 3 (1) dhe (2). Imponimi i një gjobe në bazë të këtij ligji jo kushtetues dhunonte lirinë e veprimit të ankuesit sipas nenit 2(1) të ligjit bazë.

Gjykata Kushtetuese gjermane e ka arsyetuar vendimin e saj si më poshtë:

I. Përjashtimi i punës së grave natën cenon nenin 3(3) të Kushtetutës

1. Sipas këtij neni, asnjë nuk mund të jetë në disavantazh ose të favorizohet për shkak të seksit. Ky paragraf përforcon dispozitën e barazisë së përgjithshme të nenit 3(1) duke imponuar kufizime më të ashpra mbi drejtësinë Kushtetuese. Ashtu sikurse karakteristikat e tjera të listuara në paragrafin 3, seksi nuk duhet të shihet si bazë për një trajtim të pabarabartë. Kjo është e vërtetë edhe nëse ligji në fjalë nuk synon të vendosë pabarazinë, të cilën ai e ndalon, por kërkon të ndjekë disa qëllime të pavarura.

Dispozita sipas së cilës “burrat dhe gratë duhet të kenë të drejta të barabarta” është dizenuar jo vetëm që t’iu largohet normave ligjore që bazojnë avantazhe ose disavantazhe në bazë të seksit, por gjithashtu, të zbatohen mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në të ardhmen. Qëllimi i saj është barazia e kushteve të jetesës. Kështu, gratë duhet të kenë të njëjtat mundësi fitimi si dhe burrat. Shteti nuk mund të ndërmarrë veprime që shpien në një forcim të koncepteve e roleve tradicionale që rrisin barrën për gratë. Gjithashtu, disavantazhet tipike që vuajnë gratë, mund të plotësohen nga rregullat që i favorizojnë ato.

Rasti konkret ka të bëjë jo me barazinë e kushteve, por me heqjen e pabarazisë së imponuar nga ligji. Statuti i trajton punëtorët gra në mënyrë të pabarabartë për shkak të gjinisë së tyre. Është e vërtetë që rregulli i adresohet punëdhënësve. Por pasojat e këtij rregulli ndihen menjëherë nga punëtorët femra. Në ndryshim nga burrat ato janë të privuara nga mundësia e punës natën. Kjo është një pabarazi gjinore, e imponuar nga ligji.

2. Jo çdo pabarazi e bazuar në gjini cenon nenin 3(3) të Ligjit Themelor të Shtetit. Dallimet gjinore mund të jenë të lejueshme deri në atë masë sa ato janë mjaft të rëndësishme për zgjidhjen e problemeve, të cilat për nga natyra e tyre mund të krijohen vetëm për gratë ose vetëm për burrat. Por, ky nuk është një rast i tillë.

a. Ndalimi i punës natën si fillim është bazuar në hipotezën se punëtorët gra ishin konstitucionalisht më të prekshme ndaj dëmit të shkaktuar nga puna natën,

se sa burrat. Studime mbi mjekësinë profesionale nuk ofrojnë argumente për këtë hipotezë. Puna natën është kryesisht e dëmshme për çdonjëri.

b. Fakti që hetimet tregojnë se gratë dëmtohen më seriozisht nga puna natën, përgjithësisht bazohet në argumentin se ato janë më të ngarkuara me punët e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve. Prandaj, gratë që kryejnë këto detyra, vuajnë pasojat e këqija ose të pavolitshme të punës natën në një shkallë më të lartë.

Por, ndalimi i punës natën për të gjitha punëtoret femra nuk mund të mbështetet mbi këtë bazë, sepse barra shtesë e punëve të shtëpisë dhe rritja e fëmijëve nuk është një karakteristikë gjinore specifike. Për gruan, mbajtja e shtëpisë dhe e fëmijëve korrespondon me ndarjen tradicionale të përgjegjësisë dhe roleve midis burrit dhe gruas, dhe nuk mund të mohohet fakti, që ajo shpesh e përmbush këtë rol edhe kur është e zënë me punën jashtë shtëpisë, po aq sa partneri i saj burrë. Kjo barrë e dyfishtë bie në peshën e plotë vetëm mbi ato gra me fëmijë që kërkojnë përkuqjesje të veçantë, që jetojnë vetëm, ose që partnerët burra ua lënë atyre kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë, pavarësisht nga punët e tyre natën. Kjo barrë bie në mënyrë të barabartë mbi burrat që rrisin vetëm fëmijët. Nevoja e pamohueshme e punëtorëve të natës për mbrojtje, burra dhe gra, që kanë fëmijë për të rritur dhe një shtëpi për të menaxhuar, mund të përmbushet më mirë nëpërmjet rregullave që fokusohen drejtpërdrejt në këto rrethana.

3. Në mbështetje të ndalimit të punës natën argumentohet gjithashtu që gratë janë subjekt i rreziqeve të veçanta kur shkojnë dhe kthehen nga puna natën. Në shumë raste nuk ka dyshim për këtë, por kjo nuk justifikon ndalimin e punës natën për të gjitha gratë. Shteti nuk mund ti shpëtojë përgjegjësisë së tij për të mbrojtur gratë nga sulmet në rrugët publike, duke e kufizuar lirinë e tyre profesionale me qëllim që t'i ndalojë ato nga largimi nga shtëpitë e tyre natën. Për më tepër, ky argument nuk është kaq i aplikueshëm për punëtoret gra si një grup, për të justifikuar disavantazhet e të gjitha grave. Rriske të veçanta mund të shmangen, duke siguruar një autobus të kompanisë për t'i marrë ato nga puna.

4. Shkelja e ndalimit të diskriminimit (neni 3/3) nuk justifikohet me mundësitë e barabarta që urdhërohen në nenin 3(2). Ndalimi i punës së natës nuk promovon qëllimet e kësaj dispozite. Është e vërtetë që ky ndalim mund të mbrojë një numër grash, nga puna e natës që rrezikon shëndetin e tyre. Por kjo mbrojtje është e shoqëruar me disavantazhe të rëndësishme. P.sh., në këtë mënyrë gratë paragjykohen kur kërkojnë punë. Në disa sektorë kjo ka çuar në një reduktim të qartë në trajnimin dhe punësimin e grave. Përveç kësaj, punëtoret gra nuk janë të lira të vendosin për të zgjedhur kohën e tyre të punës. Një nga rezultatet e kësaj, mund të jetë që gratë do të vazhdojnë të jenë më të ngarkuara se burrat me rritjen e fëmijëve dhe punëve të shtëpisë, përveç punës jashtë shtëpisë. Por, kështu, ndarja tradicionale e punëve midis gjinive mund të forcohet më tej. Prandaj, ndalimi i punës natën pengon eliminimin e disavantazheve sociale që vuajnë gratë.

ESEJA ME E MIRË E STUDENTIT

JONIDA LAMAJ

*(Studente e skuadrës pro bono
Fakultetit Drejtësisë
Universiteti Tiranë)*

**DHUNA NË FAMILJE, JO
VETËM FENOMEN, POR
EDHE FAKT**

Familja është njësi e organizimit të jetës shoqërore, që përbëhet kryesisht nga prindërit dhe fëmijët. Ajo është njësi më e vogël e shoqërisë dhe në të njëjtën kohë cilësohet si njësi bazë e saj. Por si mund të pretendosh, që anëtarët e një grupi kaq të afërt dhe me lidhje gjaku të kenë konflikt dhe ashpërsi mes tyre, dhe nga ana tjetër të mund të shpresosh për një shoqëri të shëndoshë? Kjo është disi kontradiktore!

Çdo veprim i një anëtari të një familjeje, që sjell si pasojë cenimin e integritetit fizik, moral dhe psikik të një apo disa personave në familje është një akt i shëmtuar, i dënueshëm, por mbi të gjitha, i dëmtueshëm për vetë familjen. Asnjëri nga anëtarët e kësaj familjeje s'mund të heshtë dhe të sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë, pasi ushtruesi i dhunës do të shihej gjithnjë me syrin e një të dyshuari; ai nga momenti në moment mund të riuhtrojë dhunë, ndërsa viktimat e kësaj dhune, ose më saktë viktimat, pasi për men-

dimin tim, të gjithë personat e pranishëm të një veprimi të dhunshëm, në cilëndo formë të shfaqjes së saj ndihen të prekur.

Dhuna është prezent. I gjithë sensibilizimi i shoqërisë, Aktet e ndryshme Ndërkombëtare, Deklaratat, Konventat dhe Rregulloret përkatëse, dispozitat që janë gjithnjë e më të shumta në numër, punonjësit e OJF-ve, si dhe miratimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, rezultat i një nisme qytetare, dëshmon që dhuna jo vetëm është e pranishme, por që ekzistojnë mjetet e posaçme që e parandalojnë e minimizojnë atë si dhe garantojnë mbrojtje ligjore për të gjithë anëtarët e familjes-viktima të dhunës.

Por sa njihet ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”? A është i përgatitur mentaliteti shqiptar për një ligj të tillë?

Edukimi ligjor i shtetasve është i vakët. Një pjesë dominuese e grave dhe vajzave në zonat rurale dhe ndërrurbane, të cilat janë dhe më shpesh viktima të dhunës në familje, nuk kanë informacionin e duhur mbi ekzistencën e një ligji që i mbron ato dhe parandalon pasoja të rënda në familje, ndërsa pjesa tjetër në minorancë, edhe pse është në dijeni, ngurron të marrë një hap të tillë, siç mund të jetë denoncimi i ushtrimit të dhunës. Këtu ka diskutime nga më të ndryshmet, sepse pikërisht kësaj kategorie i mungon “kultura e duhur”, për t’i thënë stop dhunës. Duhet domosdoshmërisht që ky edukim të jetë shumë më i fortë se vetë mentaliteti shqiptar. Parë nga ky këndvështrim, mendoj se paralelisht me miratimin e ligjit duhej të zhvillohej një fushatë “në front të gjerë” edukuese - sensibilizuese kundër dhunës në familje, ku media e shkruar dhe vizive t’i jepte hapësirat e nevojshme këtij fenomeni të shndërruar tashmë në një fakt.

Sot duhet të jemi më shumë optimistë apo realistë mbi ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”?

Në fakt duhet të na përshkojë një ndjenjë optimizmi kur shohim se ky ligj ka parandaluar situata të dhunshme. Të jemi optimistë për punën e pandërprerë të qendrave të ndryshme që ushtrojnë veprimtari në ndihmë të viktimave të dhunës, si dhe për punën e Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare, për hapin e rëndësishëm drejt këtij ligji, për trajtimin dhe ndihmën që i ofron të dhunuarve si dhe për ngritjen e skuadrave

Pro-Bono. Këto skuadra përbëhen nga studentë të Fakulteteve të ndryshme të Drejtësisë, të cilët trajnohen mbi ligjin dhe se si ata mund t'u ofrojnë ndihmesë viktimave të dhunës apo si mund t'u japin sugjerime ligjore familjeve me probleme.

Por duhet të jemi dhe realistë në të njëjtën kohë, se megjithëse ligji është miratuar, organet e qeverisë ende nuk kanë nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në funksion dhe në zbatim të ligjit.

A është ushtrimi i dhunës një arsye e fortë për të kërkuar divorcin?

Ushtrimi i dhunës nuk sjell ndarjen e një familjeje, por kur dhuna bëhet partnere e pandashme e saj dhe ka pasoja si fizike dhe psikike tek pjesëtarët e familjes, ajo detyrimisht duhet të çojë drejt një divorci. Plotësimi i një urdhri të menjëhershëm mbrojtës dhe largimi i dhunuesit nga banesa e përbashkët me të dhunuarit nuk sjell divorc. Urdhrat e mbrojtjes dhe të menjëhershëm të mbrojtjes garantojnë mbrojtjen më të madhe për të dhunuarit dhe shërbejnë që dhunuesi të reflektojë më gjatë mbi veprimet e tij.

Të gjithë shtetasit duhet të jenë kritikë ndaj dhunës, optimistë ndaj rregullave që parandalojnë dhunën dhe pro shoqërisë së shëndoshë.

.....

FOTO NGA AKTIVITETET E QNL-SË PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT DHE PËRGATITJEN E SKUADRAVE PRO BONO, PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE









VAQARR, TIRANË 2008



GJERGJOVINË, GRAMSH 2007

**VI. AKTIVITETE NË DITËT E AKTIVIZMIT
NDËRKOMBËTAR KUNDËR DHUNËS
NDAJ GRUAS**

LETËR E HAPUR

*Drejtuar popullit shqiptar nga
Kryetarja e Kuvendit të RSH-së,
Znj. Jozefina Topalli (Çoba),
me rastin e ditëve të
aktivizmit ndërkombëtar*

Tiranë, me 25 nëntor 2007

Sot merr udhë Java Ndërkombëtare kundër Dhunës në Familje. Parlamenti Shqiptar është angazhuar prej kohësh në një fushatë që unë e konsideroj aksion politik kundër këtij fenomeni që fatkeqësisht vazhdon të vrasë.

Ne do të koordinojmë çdo iniciativë kombëtare që fokusohet në këtë aksion.

Sigurisht, që mua nuk do të më pëlqente që këto fenomene, që vrasin gra dhe fëmijë të pafajshëm të luftohen në ditë, apo javë të caktuara, ja pse në axhendën politike të Parlamentit Shqiptar, lufta ndaj këtij fenomeni është një aksion i përditësuar, jo vetëm me miratimin e projektligjeve që e dënojnë atë, ku veçoj atë “Kundër Dhunës në Familje”, por edhe me angazhimin tonë qytetar në ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi efektet negative të këtij fenomeni dhe të heshtjes ndaj tij.

Por unë jam gjithashtu e ndërgjegjshme që fushata të për-

caktuara në kohë dhe të mirë organizuara ndërkombëtarisht rrisin intensitetin e ndërgjegjësimit të shoqërive në tranzicion dhe të shoqërive më të zhvilluara për t'u fokusuar në këtë luftë.

Siç e kam theksuar edhe më parë, familja është vatra e dashurisë dhe jo e abuzimit me të.

Në të duhet të edukohet dashuria dhe jo të rriten fëmijë me kompleksin e dhunës.

Besoj se ne kemi ende të mirëruajtur vlerën tradicionale të familjes dhe dashurisë në të.

Besoj në fuqinë edukuese dhe në përkushtimin e prindërve shqiptarë, unë besoj në fuqinë edukuese dhe në përkushtimin e mësuesve shqiptarë.

Besoj se shoqëria jonë nuk mund të pranojë integrimin e dhunës në të, sepse ne jemi një shoqëri tradicionalisht vlerësuese ndaj femrës, respektuese ndaj saj.

Ne, parlamentarët shqiptarë, do të përdorin të gjitha mjetet që kemi në dispozicion për të dënuar dhunën në familje, do të mobilizojmë të gjithë organizmat që të punojmë jo vetëm për sensibilizimin e shoqërisë, po edhe për të promovuar ndryshimet e nevojshme ligjore në përputhje me standardet e Këshillit të Europës.

Ndaj ju ftoj të gjithëve të reagojmë ndaj dhunës.

Dhuna vret, nëse ti hesht! Reago dhe ti, thuaj Ndal Dhunës në Familje!

Ju faleminderit!

**REFLEKSIONE MBI
LUFTËN KUNDËR DHUNËS
NË FAMILJE NË DITËT E
AKTIVIZMIT**

*(Fjala e Prof. Dr. Aurela Anastasit
në seancën e posaçme Plenare të
Kuvendit të Shqipërisë, dedikuar
luftës kundër dhunës në familje)*

ENDERUAR Znj. Kryetare e
Kuvendit!

I nderuar Z. Kryeministër!
Të nderuar Zonja e zotërinj!

Duke shprehur kënaqësinë e veçantë për pjesëmarrjen time këtu, dua të them paraprakisht se, kjo seancë është njëra prej simboleve që dëshmon se çështja e “jo dhunës ndaj grave” dhe lufta kundër kësaj, po shndërrohet gjithmonë e më tepër në një çështje të përgjegjësisë dhe angazhimit shtetëror. Ky fakt, i pranuar sot gjerësisht në gjithë botën demokratike, i dedikohet procesit të zhvillimit të idesë se, shkelja e të drejtave të grave është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut. Kështu, duket se po ndahemi përfundimisht, nga konceptimi i dhunës që ndodh në familje, si një çështje private. Në serinë e dokumenteve ndërkombëtare, shtetet rezultojnë përgjegjëse për dhunimin e të drejtave të Njeriut, pavarësisht nëse këto dhunime ushtrohen nga agjentë që veprojnë

në emër të tyre, apo nga të afërm në marrëdhëniet familjare. I gjithë ky përparim idesh e gjen mjaft mirë simbolikën e tij në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Këto ditë hyjnë më 25 Nëntor, ditën ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe, jo rastësisht, përfundojnë më 10 Dhjetor, përvjetorin e Ditës Ndërkombëtare të të drejtave të Njeriut dhe atë të shpalljes së Deklaratës Universale të të drejtave të Njeriut.

Të ndërgjegjshëm se lufta kundër dhunës ndaj gruas është një proces i vazhdueshëm dhe jo një proces që i përket vetëm ditëve të aktivizmit, jemi të bindur se ato shërbejnë si ditë intensive të analizave të punës dhe të rezultateve, të aktiviteteve e veprimtarive për ndërgjegjësimin e popullsisë së të gjitha moshave, si dhe për ndërmarrjen e angazhimeve të reja serioze kundër dhunës ndaj gruas.

Në një bilanc të kuadrit të ri ligjor shqiptar në këtë fushë, përveç konventave dhe akteve ndërkombëtare përkatëse, të cilat shteti shqiptar i ka ratifikuar duke i bërë pjesë të legjislacionit tonë të brendshëm, do të rendisim si aktet më të spikatura, Kodin e Familjes (2003), i cili për herë të parë adoptoi masat kundër dhunës, si dhe ligjin i ri “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili hyri në fuqi më 1 Qershor të këtij viti, si akt i posaçëm për parandalimin e dhunës në familje dhe luftën kundër saj. Këto akte shënuan hapa të sigurt për zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare veçanërisht, me “Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW), si dhe të një sërë akteve të miratuara rishtazi nga Këshilli i Evropës dhe Institucionet e Bashkimit Evropian.

Nisma ligjvënëse dhe paraqitja në Kuvend, nga më tepër se 20 mijë shtetas me të drejtë vote, e ligjit “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, dëshmoi qartë faktin se jo vetëm shoqëria civile, por e gjithë shoqëria shqiptare është e gatshme, të iniciojë nisma të tilla, të mëdha. Ky fakt, shërbeu si një sinjal i mirë edhe për zbatimin e këtij ligji, pasi ishte një fillim i mbarë i punës për ndërgjegjësimin e publikut mbi institutet dhe standardet e reja që ai solli. Megjithatë, zbatimi me efikasitet i tij, mbetet ende një çështje e ditës, gjë për të cilën, një rol mjaft i rëndësishëm i përket bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo, sepse si rrallë ndonjë ligj tjetër, ky ligj, është mbështetur në filozofinë e

bashkërendimit të veprimeve të organeve të gjitha pushteteve, të pushtetit qendror e vendor, ekzekutiv e gjyqësor, si dhe në harmonizimin e veprimtarisë së tyre me shoqërinë civile dhe shtetasit. Kështu, ligji është bërë pasqyrë e faktit se, lufta kundër dhunës në marrëdhëniet familjare nuk mund të kryhet nga një njësi e vetme shtetërore, por kërkon angazhim të përgjithshëm shoqëror. Sidoqoftë, përmbushja e kësaj filozofie, ka nevojë për më tepër shpejtësi e kompetencë nga të gjitha aktorët.

Njohja e ligjeve dhe ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e tyre, është një nga sfidat me të cilat po përballlet respektimi dhe zbatimi i tyre në jetën e përditshme. Por, jo më pak i rëndësishëm është edhe fakti se, kuadri ligjor shqiptar kundër dhunës në familje, ka ende nevojë për përmirësime, veçanërisht në legjislacionin penal. Disa qëndrime tradicionale që për fat të keq, shfaqen edhe në radhët e juristëve, kanë ndikuar në ngadalësimin e përmirësimeve të plota të legjislacionit shqiptar në përputhje me standardet më të reja ndërkombëtare, në këtë fushë. Ndërsa synojmë të mbrojmë sferën e jetës private e familjare nga ndërhyrjet e jashtme, apo parimet tradicionale të procedurave civile e penale, nuk mund të fshihemi pas tyre, për të anashkaluar goditjen e dhunës që ushtrohet brenda familjes. Për shkak të këtij mentaliteti të gabuar, dhuna në familje i ka shpëtuar shpesh dënimit penal, duke u dënuar vetëm në rastet ekstreme. Parashikimi nga legjislacioni ynë Penal i rrethanës rënduese në caktimin e dënimit, për vepra penale të kryera duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, është krejt e pamjaftueshme në bazë të standardeve ndërkombëtare. Dhuna në Familje, me të gjitha format e saj, duhet të ndëshkohet si vepër penale e shprehur qartë nga legjislacioni ynë. Edhe Kodi i Procedurës Penale ka nevojë për përmirësime, pasi në standardet që qëndron sot, nuk i ofron një mbështetje të mirë viktimave të dhunës në familje, duke i lënë ato vetëm në fatin e denoncimit të tyre. Në kuadër të përmirësimeve, mjaft e rëndësishme paraqitet edhe çështja e kompensimit të viktimave të dhunës.

Është e qartë se përmirësimet ligjore duhet të shoqërohen edhe me profesionalizmin dhe dedikimin nga ana e organeve të drejtësisë, të cilat kanë nevojë për zhduhje të zbatimit të ligjit. Kjo bëhet e mundur duke u shkëputur nga qëndrimet e ngurta të praktikave juridike kur ato nuk premtjnë efektivitetin e duhur, si dhe duke përqafuar mjetet e reja të akteve ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat në bazë të Kushtetutës sonë zbatohen drejtpërdrejt dhe kanë epërsi mbi të drejtën e brendshme,

në rast konflikti.

Në përfundim, do të doja të ritheksoja thirrjen se, vetëm një bashkërendim i harmonishëm i administratës publike me shoqërinë civile, do t'i shndërronte të gjitha hallkat institucionale shqiptare në mjete efektive kundër dhunës dhe formave të shtypjes së grave brenda familjes.

Ju faleminderit!